Lumo Skëndo
dhe themelimi i revistës *Diturija*

Aktet e Konferencës Shkencore
zhvilluar në Tiranë e Prishtinë - 2018,
në kremtimet e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit

&

Bibliografi e revistës *Diturija*

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE

Tiranë,

2019

ALSAR
FONDACION ARSIMOR KULTUROR HUMANITAR

BOTIM NË KUADËR TË 100-VJETORIT TË KONGRESIT TË MANASTIRIT

Titulli:
"Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës *Diturija*"

Botues:
ALSAR, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Përgatiti:
Prof. Dr. Persida Asllani

Këshilli botues – ALSAR:

Mehdi Gurra – Kryetar Bordi
Saimir Rusheku – Teolog
Prof. Dr. Zyhdi Dervishi – Sociolog
Prof. Dr. Luan Malltezi – Historian
Dr. Abaz Hado – Mjeshtër i Madh
Dr. Ardian Muhaj – Historian
Shaban Murati - Mjeshtër i Madh
Sherif Delvina – Historian

Këshilli botues – BKSH:

Prof. Dr. Persida Asllani
Prof. Dr. Nevila Nika
Prof. Dr. Ferid Hudhri
Prof. Dr. Saverina Pasho
Prof. Dr. Dhurata Shehri
Prof. Dr. Dhimitri Bello
Dr. Etleva Domi
Msc. Brunilda Tahiri

Redaktore:
Loreta Loli

Dizajn:
Rudina Dahri

Dizajn:
zejtar & dizajn

ISBN BKSH : 978-9928-4494-6-7
ISBN ALSAR : 978-9928-243-50-8

Në kuadër të kremtimeve mbarëkombëtare kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Fondacioni ALSAR, ndërmorën gjatë vitit 2018, përmes një bashkëpunimi të suksesshëm, botimin anastatik të revistës së mirënjohur Diturija*, themeluar më 1909, drejtuar e botuar deri në vitin 1929, pikërisht nga kryetari i këtij kongresi, intelektuali i shquar Lumo Skëndo.*

Kësaj nisme iu bashkua më tej edhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Për të sjellë në dritën e leximeve e studimeve të sotme vlerat e çmuara të kësaj reviste si dhe kontributin e jashtëzakonshëm të themeluesit të saj, prezantimi i botimit të ri u pasurua nga punimet e Konferencës Shkencore "Lumo Skendo dhe themelimi i revistës Diturija*", zhvilluar në dy edicione të suksesshme: 10 tetor në Tiranë, 6 nëntor në Prishtinë.*

Përmes kontributit shkencor të studiuesve tashmë të njohur të veprës së Mid'hat Frashërit, si Luan Malltezi, Sabri Hamiti e Uran Butka, por edhe të studimeve të tjera të rëndësishme të paraqitura në konferencë nga studiuesit Xhevat Lloshi, Dhurata Shehri, Persida Asllani, Agron Gjekmarkaj, David Hosaflook dhe Mark Marku, doli në pah vlera dhe roli i papërsëritshëm i revistës Diturija *si një monument i mirëfilltë kulturor e dituror në zhvillimet e kulturës dhe dijes kombëtare. E vështruar nga perspektiva të larmishme, figura e Lumo Skendos u shfaq në plotërinë e saj përmes leximesh kulturologjike, historike, gjuhësore, imagologjike etj., duke rikthyer në bashkëkohësinë tonë profilin e një intelektuali të shkëlqyer të botës shqiptare.*

Botimi i akteve të kësaj konference synon të plotësojë leximin e revistës Diturija *në mënyrë specifike, por edhe të veprës së gjerë e mbresëlënëse të Mid'hat Frashërit.*

Përmbledhja pasurohet gjithashtu me botimin e "Bibliografisë së revistës Diturija", përgatitur posaçërisht nga specialistët e Bibliotekës Kombëtare si një ndihmesë e vlefshme për kërkuesit në thellimin e njohjes së kësaj enciklopedie të mirëfilltë albanologjike.

Falë vijimit të bashkëpunimit me Fondacionin ALSAR, aktet e konferencës sonë dhe kjo bibliografi botohen sot si plotësim i dy vëllimeve të hijshme të Diturisë.

In the framework of the nationwide celebrations dedicated to the 100th anniversary of the Congress of Manastir, the National Library of Albania and the ALSAR Foundation undertook during 2018 through a successful cooperation the anastatic edition of the well-known journal Diturija, *founded in 1909, led and printed until 1929, precisely by the chairman of this Congress, the prominent intellectual Lumo Skëndo.*

The national Library of Kosovo also joined this iniciative. In order of casting some light in today's readings and studies the precious values of this journal as well as the extraordinary contribution of its founder, the introduction of the new edition was also enriched by the works of the Scientific Conference "Lumo Skendo and the founding of Diturija*" which was held in two successful editions:*
10 October in Tirana, 6 November in Prishtinë.

Through the scientific contribution of different scholars highly familiar with the work of Mid'hat Frashëri, scholars such as Luan Malltezi, Sabri Hamiti and Uran Butka, as well as other important studies presented at the conference by scholars like Xhevat Lloshi, Dhurata Shehri, Persida Asllani, Agron Gjekmarkaj, David Hosaflook and Mark Marku, all highlighted the values and the important role of Diturija *as a genuine national cultural monument in the development of the national culture and knowledge. Seen from diverse perspectives, Lumo Skendo's figure appeared in its entirety through cultural, historical, linguistic, imagological readings. by bringing into our present context the profile of an excellent intellectual of the Albanian world.*

The publication of the acts of this conference aims to complete not only the reading of Diturija *specifically, but also the wide and impressive work of Mid'hat Frashër.*

*The collection is also enriched with the publication of "*Diturija Bibliography*", specially prepared by the National Library specialists as a valuable contribution to the researchers in deepening their knowledge in this authentic albanological encyclopedia.*

Thanks to the cooperation with the ALSAR Foundation, the acts of the conference and this bibliography are published today as a fulfillment of the two grace volumes of Diturija.

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie 9

Fjalë përshëndetëse nga z. Mehdi Gurra 13

Aktet e Konferencës Shkencore
"Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës *Diturija*"

Prof. Dr. **Luan Malltezi**
DITURIJA - Revista "letrare diturake" për Shqiptarët 19

Akademik Prof. Dr. **Sabri Hamiti**
DITURIJA: LUMO SKENDO 27

Prof. Dr. **Xhevat Lloshi**
Çështje gjuhësore në revistën *Diturija* pas Kongresit të Manastirit 33

Prof. Dr. **Persida Asllani**
Lumo Skëndo, revista *Diturija* dhe misioni i dijes 39

Dr. **Uran Butka**
Bashkëpunimi i Lumo Skëndos me Kristo Luarasin për botimin e revistës *Diturija* dhe veprave të tjera të tij 53

Prof. Assoc. Dr. **Mark Marku**
Revista *Diturija* në historinë e shtypit dhe shoqërisë shqiptare 61

Dr. **Agron Gjekmarkaj**
Revista *Diturija* - kryqëzime imagologjike nga Mid'hat Frashëri 67

Prof. Dr. **Dhurata Shehri**
BIBLIOGRAFITË e Lumo Skëndos 71

Dr. **David Hosaflook**
Kristoforidhi dhe shkrimet e Mid'hat Frashërit për Shoqërinë Biblike 79

Bibliografi e revistës *DITURIJA*
Brunilda Tahiri dhe **Eni Kaçi**

Parathënie 89
BIBLIOGRAFI 93

Parathënie

Revistat kulturore si *Albania, Diturija, Hylli i Dritës, Zani i Naltë, Leka, Përpjekja Shqiptare, Shkëndija, Shejzat etj*., përbëjnë në thesarin e dijes dhe kulturës së Kombit monumente kulture unike prej të cilave kemi ende shumë për të kuptuar, për të mësuar e për të shijuar. Përmes tyre gjuha dhe kultura jonë sfiduan tema, debate e perspektiva nga më të larmishmet në qindra shkrime dhe rubrika të dedikuara, u dëshmua e u dokumentua historia e popullit dhe jeta e kombit, si dhe u shpreh një vetëdije identitare gjithnjë e më e artikuluar.

Ndër më mbresëlënëset mes tyre, revista *Diturija* ka mbërritur në 110-vjetorin e themelimit. Botimi anastatik i saj falë bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Fondacionit "Alsar", nismës së të cilëve iu bashkua më tej edhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës, u shndërrua në pragun e kremtimeve tona të përbashkëta për 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit, duke çmuar këtë revistë që lind pikërisht nën shenjën e tij, dhe duke nderuar themeluesin e autorin e saj qendror, zgjedhur njëzëri nga Gjergj Fishta, Ndre Mjedja, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi, Refik Toptani, Mihal Grameno, Feim Zavalani e të tjerë emra të shquar të Rilindjes kulturore shqiptare si kryetar i këtij Kongresi. Kjo zgjedhje ngjan sot profetike. Djaloshi 28-vjeçar e fisnik Mid'hat Frashëri, biri i denjë i Abdylit dhe nipi i dashur i Naimit dhe Samiut, vetëm një muaj më pas do të niste botimin e *Diturisë* si sprovë e nivelit të lartë të dijes shqiptare.

Nën emrin letrar Lumo Skëndo, ai i dha asaj frymëzimin iluminist dhe ADN-në e tij frashërore: talenti, inteligjenca, erudicioni, moraliteti, atdhedashuria, mprehtësia, kërshëria dhe entuziazmi shkencor i një dijetari gjithnjë në kërkim, përpikmëria e zeja e hollë e një botuesi të rafinuar, u endën së bashku me informacionin marramendës që revista përcolli bujarisht për "këndonjësit" e saj.

Konferenca shkencore "Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës *Diturija*" synoi të hedhë dritë mbi vlerat ende të paçmuara apo të panjohura të *Diturisë* dhe të autorit të saj. Ajo u zhvillua në dy edicione të suksesshme, në Tiranë më 10 tetor dhe në Prishtinë më 6 nëntor, 2018, edhe si homazh i atij momenti historik kur më 28 nëntor të vitit 1912, Mid'hat Frashërit i qe besuar jo vetëm përfaqësimi i Elbasanit e Përmetit, por edhe ai i Gjakovës, Pejës, Plavës e Gucisë, në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe firmosja e aktit të Shpalljes së Pavarësisë!

Bashkëpunimi e përkushtimi i studiuesve të mirënjohur si dhe atyre më të rinj në shqyrtimin dhe paraqitjen e vlerave unike të revistës *Diturija* dhe të personalitetit poliedrik të Lumo Skëndos i solli konferencës pasurinë e perspektivave të larmishme, prej të cilave figura e Lumo Skëndos u shfaq në plotërinë e saj përmes leximesh kulturologjike, historike, gjuhësore, imagologjike etj., duke rikthyer në bashkëkohësinë tonë profilin e një intelektuali të shkëlqyer të botës shqiptare.

Tashmë, në traditën shumëvjeçare të bashkëpunimeve mes Bibliotekave tona Kombëtare po theksohet gjithnjë e më tepër rëndësia e përfshirjes reale të akademikëve, të studiuesve dhe kërkuesve shkencorë në evidentimin e dukurive dhe personaliteteve të kulturës kombëtare. Aleanca të tilla na mundësojnë veç të tjerash, që të identifikojmë e zbulojnë pista të rëndësishme kërkimi për autorë, protagonistë ngjarjesh e dijesh, prej nga studiuesit do të kenë mundësinë të ofrojnë ndihmë specifike intelektuale për të lehtësuar hulumtimin, gjetjen, grumbullimin e ruajtjen e materialeve me vlerë kombëtare në bibliotekat tona. Ne besojmë se kjo formë e organizimit shkencor do të nxisë partneritete ambicioze të mëtejshme mes bibliotekave dhe studiuesve.

Gjithashtu përmes bashkëpunimesh të tilla, edhe bibliotekat nxiten të punojnë në pista të reja e të përpunojnë informacione shkencore e profesionale në ndihmë e mbështetje të studiuesve të sotëm e të ardhshëm.

Në rastin e konferencës "Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës *Diturija*", kumtimet e së cilës po i botojmë në këtë vëllim, dhe në nderim të Kongresit të Manastirit, specialistët e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës ndërtuan ekspozitën "Abetarja shqipe: 1906-2018", me koleksione të kësaj biblioteke, si një shembull i mirë për të nxjerrë në pah edhe një informacion të vlefshëm bibliografik që rizbulon traditën e dijes për shkrim-leximin dhe kulturën e shtypit e të botimit.

E vetëdijshme për misionin e saj, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ndërmori përgatitjen e botimit anastatik të *Diturisë*, me qëllim rikthimin e kësaj vepre në duart e studiuesve, studentëve dhe lexuesve shqiptarë. Specialistët e saj hartuan edhe "Bibliografinë e revistës *Diturija*", një kontribut i çmuar shkencor përmes të cilit vjen një ndihmesë e vlefshme për kërkuesit në thellimin e njohjes së kësaj vepre monumentale të kulturës shqiptare. Falë vijimit të bashkëpunimit me Fondacionin "Alsar", kjo bibliografi po botohet sot së bashku me aktet e konferencës sonë si vijim i dy vëllimeve të hijshme të *Diturisë*.

I shprehim mirënjohje në emër të të dyja Bibliotekave Kombëtare zotit Mehdi Gurra dhe Fondacionit "Alsar" për mbështetjen e botimit cilësor anastatik të *Diturisë*, si dhe për bashkëorganizimin e kësaj Konference dhe botimin e akteve të saj.

Një falënderim të veçantë i shprehim profesorit të nderuar Luan Malltezi, i cili është ideatori i këtij bashkëpunimi në nderim të revistës *Diturija* dhe Lumo Skëndos.

Mirënjohje studiuesve pjesëmarrës në këtë konferencë për kontributin e çmuar dhe përkushtimin e tyre në studimin e *Diturisë* dhe figurës së themeluesit të saj. Jemi të bindur se ky është vetëm fillimi i një vargu studimesh që do ta thellojnë më tej këtë iniciativë dhe nuk do të jetë e largët dita kur të rimblidhemi sërish për të folur për Lumo Skëndon dhe veprën e tij. Në çdo rast, fjalët naimjane që ai shkroi për ikjen nga jeta të mikut dhe bashkëpunëtorit Kristo Luarasi do të vijojnë të vlejnë po aq fort edhe për vetë atë që i shkroi:

E Ç'ka të bëjë zhdukja e trupit, në qoftë se ideja rron, kur ajo ide ngjall një mijë shpresa dhe entuziazëm? Dhe bash këto janë jetë e vërtetë!

Persida Asllani dhe **Fazli Gajraku**

Fjalë përshëndetëse

nga

Z. Mehdi Gurra

Kryetar i Fondacionit ALSAR

Tradita e krijuar përgjatë viteve nga Fondacioni ALSAR me botimin e veprave me vlerë kombëtare dhe më gjerë u pasurua në 2018-n me një thesar të çmuar. "Diturija", revista e mirënjohur e fillimshekullit të shkuar, iu bashkua korpusit të këtyre botimeve. Një botim anastatik, ridalja e përmbledhur tashmë në dy vëllime e revistës "Diturija" ishte pa diskutim një sukses i jashtëzakonshëm.

Në fakt, 2018-ta ka qenë viti i Mid'hat Frashërit, aq shumë është folur për të. Dhe në këtë ndriçim nga e para të kësaj figure të shumëdebatuar, "ALSAR" mori një pozitë qendrore me botimin anastatik të revistës, me konferencën e organizuar në Tiranë për të dhe botuesin e saj, e me një tjetër konferencë të ngjashme në Prishtinë, si bashkorganizator.

Ky botim ishte rizbulim i një reviste që jo vetëm nuk i rri ngushtë kohës së sotme, më tepër se njëqind vite pas daljes së parë, por i bën nder, teksa i rrëfen përmes rreshtave për nivelin e lartë të një klase intelektuale gati të papërsëritshme; ishte rizbulim i një reviste përmes leximit të së cilës kuptohet se në ç'shtrat të pasur kulturor rridhnin ujërat asokohe, e se në çfarë mishmashi janë sot kultura dhe idetë.

"Diturija" ishte një produkt i angazhimit intelektual të Mid'hat Frashërit. Gjenet nuk e kishin tradhtuar atë, si bir e nip i tre vëllezërve Frashëri, Abdylit, Samiut e Naimit. Në vatrën e tyre do të lindte e do të rritej, për të mos qëndruar më tej nën hijen që lëshonin ata, por për të krijuar individualitetin e tij.

Mid'hat Frashëri zgjodhi të shkruante si Lumo Skëndo; i identifikuar kështu, ai për njëzet vite do të bënte të pamundurën për të mbajtur në këmbë një revistë si "Diturija". E bëri këtë, sigurisht, krahas shumë punëve të tjera, në një garë me kohën dhe veten. Dhe, pas një shekulli, ne sot lexojmë, mbase dhe me zili, por të prekur nga një tingëllim mjaft melodik, në krye të revistës: *Drejtonjës: Lumo Skëndo.*

Drejtonjësi i asaj reviste shkriu tërë talentin e tij, u dha me gjithçka, për të mos e lënë pjellën e tij intelektuale në mes të rrugës. Dhe deri diku ia doli, rezistoi për shumë kohë, herë duke e nxjerrë revistën muaj pas muaji, herë duke krijuar pauza të gjata të detyruara. Lexuesit e tij, lexuesit e "Diturisë", patën fat ta lexojnë revistën për dy dhjetëvjeçarë, nga viti 1909 në 1929-n. "ALSAR" ua dha këtë mundësi dhe lexuesve të sotëm!

Lumo Skëndo dhe "Diturija" u bënë një. Njeriu i Kongresit të Manastirit, shkruesi i pashoq, i shtoi vetes një tjetër meritë me botimin e revistës. Polemika e zjarrtë dhe shpesh inatçore që e përfshin sot e kësaj dite figurën e tij prek aspektin politik të saj, aspak atë të letrave.

Dituritë, idetë, vizionet dhe shpresat e Lumo Skëndos zunë vend te "Diturija". Mendja i punoi për shqiptarinë, dora i shkroi për të.

"Kur t'arrijmë të mbledhim fuqinë dhe të kemi shoqëri të forta, dhe të përdorim gjithë virtytet dhe fuqinë që na ka dhënë Zoti për fitim dhe për punë, aherë ta dimë mirë se me të vërtet vendi ynë do të jetë më i lumturi dhe emri ynë më i nderuari se nga të tërë," shkruante Lumo Skëndo në numrin e tretë të revistës.

Atëbotë flitej për atdhetari, por dhe për fetari. Te "Diturija" mund të lexoje fjalën *Bismilah* në krye të një vargu, ndërsa në një tjetër faqe, në një tjetër varg, i thureshin lavde shqiptarit trim. Ja ç'frymë përcillte revista atë kohë: "Pa dyshim s'do të më thotë njeri se librat fetarë shtojnë fanatizmin e verbër dhe pakësojnë ndjenjën kombiare. Përkundrazi, libra të shkruar mirë dhe me dituri të vërtetë shtojnë ndjenjën fetare të vërtetë, që forcojnë patriotizmën dhe prapsin fanatizmën."

Është viti 1916 dhe në revistën e një prej më përparimtarëve, më atdhetarëve mes shqiptarëve, lexohet: "Salutojmë me një simpati të posaçme botimin e librave fetarë të tillë, se jemi bindur që, për të krijuar dhe për të formuar një qytetërim kombiar shqiptar, s'duhet harruar kurrë ana frymore, ana fetare e punës: nevoja për të tillë libra është pra aq e madhe sa dhe për librat shkollorë dhe mësimi. Sa për ata të vetëthënët nacionalistë që

kujtojnë se mbarohen punët vetëm me fjalë dhe me këngë, për ata do të kisha një përçmim të thellë, sikur të mos ndjenja një mëshirë dhe një të ardhur keq kur kujtoj se mituri e tyre do ndjerë nga shkaku që s'kanë për gjithë kapital veç se një padije të gjerë, në të cilët ka humbur dhe është mbytur një patriotizëm i dobët."

Te "Diturija" gjen shumë gjëra; revista flet për shpresën, për punën, për të ardhmen e shqiptarëve, shkruan për figura të njohura, për çështje gjuhësore, ka fjalorë të vegjël, vjersha, poezi, sjell rrëfime për udhëtarë të huaj në Shqipëri, përshkruan historinë dhe aktivitetin e shqiptarëve në vende të tjera, u bën vend kurioziteteve, letrave. Kuriozitete filologjie mund të lexosh te revista e Lumo Skëndos, por dhe këshilla, si, për shembull, për shtëpinë dhe qetësinë e saj: "Mos shkoni mysafir te tjetri që me natë. Lëreni të birin e botës të shikojë punën, të rregullojë banesën, të merret me fëmijën...". Pos të tjerash, "Diturija" ka fituar dhe vlerësimin si një katedër e mirëfilltë albanologjike.

"ALSAR"-in e tërhoqi kjo përmbajtje jashtëzakonisht e pasur e revistës kur vendosi t'i hynte punës për botimin anastatik të saj. Siç e tërhoqi njëkohësisht dhe qasja jopërjashtuese, mençuria në thirrjen për një përpjekje kombëtare gjithëpërfshirëse, me ndjenjën fetare dhe atdhetare krah për krah.

Kyç në suksesin e botimit anastatik të revistës "Diturija" ka qenë bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, veçanërisht me drejtoreshën, zonjën Persida ASLLANI, të cilën gjej rastin ta falenderoj për bashkëpunimin. Fondacioni "ALSAR" u tregua i hapur të bashkëpunojë dhe e bëri këtë me shumë dëshirë, në funksion të synimit për të nxjerrë një botim të patëmetë. Rezultati i dha të drejtë "ALSAR"-it, duke shtruar dhe rrugën për bashkëpunim të mëtejshëm me këtë institucion apo me institucione të tjera shtetërore.

Mund të thuhet pa hezitim se botimi anastatik i revistës "Diturija" përbën një kulm në veprimtarinë botuese të Fondacionit "ALSAR".

Aktet e Konferencës Shkencore

Lumo Skëndo
dhe themelimi i revistës *Diturija*

Prof. Dr. Luan Malltezi

DITURIJA - Revista "letrare diturake" për Shqiptarët

Sot mund të flasim me krenari për rikthimin në Shqipëri të dy botimeve të mëdha të Lumo Skëndos: të revistës *Diturija*, (që autori nisi në Selanik më 1909 dhe e vazhdoi deri në dhjetor të vitin 1929 në Tiranë) dhe të *Kalendarit Kombiar,* ku Lumo punoi si bashkëpunëtor kryesor nga viti 1887 deri në vitin 1928. Gjithashtu, botime të tjera të rëndësishme të Lumo Skëndos në gjuhë të huaj, botime monografike me vlerë të rëndësishme për historiografinë shqiptare, janë ribotur në përkthim shqip pas viteve '90 nga autorë të ndryshëm shqiptarë. Me këtë angazhim serioz të studiuesve rreth krijimtarisë së tij, mund të themi se shkrimtari dhe publicisti i shquar Lumo Skëndo i është kthyer tashmë, me dinjitet të plotë lexuesit shqiptar, nxënësve të shkollave, mësuesve dhe elitës së vendit, si personalitet i shquar i letrave dhe kulturës shqiptare. Ai zë një vend të rëndësishëm në historinë politike të Shqipërisë, në letërsinë dhe kulturën shqiptare; ai hyn në radhët e rilindasve të mëdhenj që kanë kontribut të veçantë në krijimin e shtetit shqiptar, zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare. Mid'hat Frashëri (Lumo Skëndo) lindi dhe u formua si personalitet me përmasa të mëdha intelektuale në familjen e Frashëllinjve të mëdhenj; ishte biri i Abdyl Frashërit dhe nip i Sami dhe Naim Frashërit. Ai u angazhua që herët me botime të rëndësishme për shqiptarët, ku më të rëndësishmet ndër ato të hershmet, janë tekstet për shkollat shqipe që botoheshin në Rumani.

Një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e tij zë dhe botimi i revistës *Diturija*. Numri i parë i saj doli në Selanik më 1 janar 1909; në këtë kohë Lumo Skëndo ishte angazhuar edhe në botimin e *Kalendarit Kombiar* që botohej nga Kristo Luarasi në shtypshkronjën e tij "Mbrothësia" në Sofje që nga vitin 1896. Ai ishte i angazhuar ndërkohë edhe në botimin e gazetës *Lirija* që Lumo nisi më 1908 në Selanik pas shpalljes së konstitucionit në Perandorinë osmane[1].

Diturija doli si revistë "letrare dhe diturake" siç shkruan Lumo Skëndo "një herë në muaj". Ajo u botua me ndërprerje nga viti 1909 deri në vitin 1929. Në vitin 1909 u botua në 10 numra. Lumo botoi në numrin 1 të vitit 1909 studimin "Istori e shkrimit shqip"[2]; si dhe shkrime të tjera të karakterit politik "Shqiptarët gjer më tani dhe paskëtaj"; "A do të kemi një të vetëm gjuhë literare shqip?"; "Na duhenë libra". "Të dimë të sillemi"; "Kongres' i Manastirit[3]; "Shqiptarët e Italisë"[4]; "Të mësojmë gjuhënë"; "Duhet të punojmë". Revista botoi gjatë vitit 1909 artikuj të shumtë të karakterit shkencor - popullor rreth fenomeneve të natyrës.

Lumo Skëndo botoi në çdo numër të revistës *Diturija* rubrikën "Bibliografi", ku botonte recensione të shkurtra rreth botimeve më të rëndësishme të veprave albanologjike[5]. Njoftimin e parë bibliografik revista e dha për botimin gjermanisht të veprës "Gramatikë e gjuhës shqipe"[6], botuar në Vjenë në vitin 1908 nga Gjergj Pekmezi[7]. Autori vlerëson botimin e Pekmezit dhe e krahason atë profesionalisht me albanologun e shquar Mayer. Revista e këtij viti shoqërohej me vjersha dhe poezi të autorëve të ndryshëm kushtuar atdheut, fshatit, dashurisë, miqësisë, gjuhës shqipe si dhe me fotografi të qyteteve të ndryshme të vendit, foto të malësorëve shqiptarë veshur me kostume popullore etj.

---

1. Numri i parë i gazetës "Lirija" doli në Sofje më 14 korrik 1908 me kryeartikullin "Ç'na panë sytë më 10 të korrikut 1908". Pas nëntë numrash, "Lirija" vijoi të botohej në Selanik ku ishte vendosur ndërkaq shtypshkronja "Mbrothësia" e Kristo Luarasit. Lumo e shfrytëzoi botimin e gazetës "Lirija" për ngritjen e klubeve shqiptare, ngritjen e shkollave dhe mësimin e gjuhës shqipe në Shqipëri. Botoi tek "Lirija" njoftime të rëndësishme të klubit të Selanikut, pasqyroi në gazetë punimet e Kongresit të Manastirit, të Kongresit të Elbasanit, të Kuvendit të Dibrës si dhe në disa numura shkrimin letrar "Gjashtë javë në Shqipëri".

2. SKËNDO, Lumo, "Istori e shkrimit shqip", *Diturija*, 1909, Nr.1, ff.1-6; cituar përgjatë këtij artikulli sipas botimit anastatik të revistës *Diturija,* BKSH, Alsar. Vëllimi 1 dhe Vëllimi 2, Tiranë, 2018

3. "Kongres' i Manastirit", *Diturija*, 1909, Nr.3, f. 41

4. "Shqiptarët e Italisë", *Diturija*, Nr.6, f. 83-84

5. Shih: "Bibliografi", *Diturija*, Nr.1, f.16; *Diturija*, Nr.2, f. 32; *Diturija*, Nr. 3, f. 4; *Diturija*, Nr. 4 f.63; *Diturija*, Nr. 6, f. 96 etj.

6. Shih "Bibliografi", *Diturija*, Nr. 1, 1 janar 1909, f. 16

7. PEKMEZI, Gjergj, *Grammatik der albanesischen sprache,* Wien, 1908

Me ngjarjet që ndodhën në Shqipëri më 1909, me ndalimin e shkrimit të shqipes nga Turqit e Rinj, përndjekjen dhe burgimin e mësuesve shqiptarë nga pushteti osman, Lumo Skëndo u detyrua të ndërpriste botimin e *Diturisë* dhe të vazhdonte punë të tjera të rëndësishme botuese[8]. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Fuqitë e huaja gjatë Luftës I Botërore, ai shkoi në Rumani ku rinisi në Bukuresht botimin e revistës më 1916, për periudhën qershor-gusht. Në këtë periudhë botoi artikuj të rëndësishëm, si: "Shpresa dhe puna"; "Miqtë dhe armiqt'e Shqipërisë"; "Kufit e Shqiptarëvet", "Më të vjetrët shkrime shqip"; "Gjendja në Shqipëri"; "Për shkrime të harruarë dhe të pa-diturë"; "Peshkupija (Peshkopata-L.M) dhe Kollegji i Shqipëtarëvët në Kalabri", "Dora d'Istria". Duke filluar nga viti 1916 Lumo botoi në disa numra me radhë tek *Diturija* studimet e tij "Shqiptarët në Greqi"; "Aktiviteti i shqiptarëve në Rumani" si dhe shkrime interesante me titull "Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit 19-të". Autori botoi gjithashtu shkrime me njoftime interesante për Shqipërinë dhe shqiptarët, gjuhën dhe kulturën e tyre, qytetet dhe kështjellat e vendit etj., të nxjerra këto nga veprat e personaliteteve të shquar evropianë për Perandorinë Otomane që ata kishin vizituar nga afër me udhëtimet e tyre si F. Pouqueville, Byron H.Holland, L.S. Bartholdy, S. Hughes, J. Hobhouse, A. Boue, E. Lear, E. Brown, etj. Duke shkruar për pelegrinazhin që bëri më 1496 në vendet e lindjes kalorësi Arnold von Harff nga Këlni, Lumo përkthen për shqiptarët çfarë shkruan ky udhëtar i huaj gjatë kalimit në Ulqin, Durrës, Sazan duke ngjallur shumë kuriozitet tek lexuesi.[9]

---

8. Në vitin 1910, Lumo Skëndo botoi në shtypshkronjën "Mbrothësia" të Kristo Luarasit në Selanik librin "Këndime për shkollat shqipe", një përmbledhje me vjersha dhe poezi të rilindasve të mëdhenj shqiptarë, të Naim Frashërit ("Dimri", "Varfëria", "Qeni dhe hija e tij", "Qeni dhe besa e tij"); Papa Kristo Negovanit ("Ora e Skolisë"); Kostandin Kristoforidhit ("Ylli lart në qiell"; "Qeni"; "Aleksandr'i Madh dhe Maqedoina", "Kunadhja veshur si këndez"); A.Z. Çajupit ("Fyell'i bariut"); Jani Vretos ("Të rrimë të pastrë"); Asdrenit ("Punëtori i mirë"); Vaso pashë Shkodranit ("Luftëtë e Persisë n'Epir") etj. Në vitet 1910-1912, shqiptarët zhvilluan kryengritje të mëdha antiosmane që çuan në shpalljen e pavarësisë në Kuvendin e Vlorës dhe lindjen e shtetit të pavarur shqiptar. Në këtë Kuvend të madh historik, Mid'hat Frashëri, delegat i Pejës, Gjakovës, Elbasanit, u zgjodh Ministër i Punëve Botore në qeverinë e Ismail Qemalit. Më 1913 M. Frashëri ishte prefekt në Berat.

9. "Ja këtu - shkruan Lumo, përkthimin e gjithë tekstit që na prek : "Nga Raguza në Dulcina / largësia është/ një qind mile. Ky është një qytet i bukur i vogël në pronë të venecianëvet, dhe është në tokët shqipëtare". Nga Dulcina në Duratzo 70 mile, vamë me erë të keqe; ky është një qytet i madh i shkretuar prej turqet, tani në dorë të venecianëve. Edhe ky qytet është në Shqipëri; shqipëtarët kanë një gjuhë të tyre, që nuk mund të shkruhet mirë, me qënë se nuk' kanë shkronja të tyre.Vura në dorë disa fjalë shqipe që po i shkronj me letrat /germat/ tona tona". Autori i jep këtu lexuesit 33 fjalë dhe 12 numra shqip. Autori flet më poshtë për ishullin e Sazanit (Saseno - siç shkruan ai)."Nga Duratzo në Saseno 70 mile që e bëmë për pesë orë; ky është një liman deti i mirë. Sasenua është një nisi /ishull/ i vogël i Turqisë; këtu janë dy kapela (kisha të vogla) greke, njëra me emër të shën Mërisë dhe tjetra në emër të shën Nikollit.

Për studiuesin bie në sy se *Diturija* e vitit 1916 nuk ka fotografi qytetesh dhe malësorësh si ajo e vitit 1909, dhe as ka më vjersha të karakterit propagandistik. *Diturija* e këtij viti është në nivel më të lartë shkencor, më e thellë dhe më interesante në trajtimin e çështjeve. Në të nuk botohen më shkrime për fenomenet e natyrës, por zgjerohet informacioni me shkrime bibliografike për vepra albanologjike të botuara ndërkohë.[10] Këto shkrime sinjalizohen me titullin me gërma të mëdha të rubrikës BIBLIOGRAFI dhe nën të, në *bold*, "Gjykime dhe kritikë". Komentet e autorit për vepra bibliografike vazhdojnë në çdo numër të revistës deri në vitin 1929, ku autori paraqet para lexuesit të tij me qindra botime të rëndësishme për historinë e Shqipërisë.

Në rubrikën "Bibliografi" ai sjell informacion edhe rreth botimit të librit "Naim Frashëri, vjershëtorit dh'edukatorit Kombiar, kushtuar me rasjen e mbushjes së 25 vjetve pas vdekjes së tija (20-X-1900)"[11] nga "një grup studentësh (shqiptarë) t'Austrisë". Lumo Skendo e vlerëson botimin e këtij libri si "monument i mallëngyshmë, /shkruar/ me devocion, si një premtim të vullnetit për të marrë dritë dhe shëmbllë nga Mësonjësi, për të mbajtur gjallë frymën e tij në mes të djelmërisë, si një kandil për pritmin" (d.m.th të ardhmen-L.M). Ai komenton shkrimet e studentëve shqiptarë në Grac të Austrisë, si Safet Butka[12], Terenc Toci[13], Asdreni[14], Zoi Xoxa[15], Vangjel Karjani[16] etj, dhe vetë shkrimin e tij, ku vlerëson lart si "shekull të madh të Shqipërisë atë periudhë që nxorri plejadën e pavdekshme (të rilindasve shqiptarë-L.M). Ai paraqet në këtë shkrim shënimin mjaft domethënës për lexuesit: "Nukë do të jetë mbase pa interes historik të zë ngojë këtu që autori i këtyre radhëve (d.m.th Lumo Skëndo) në qershor të motit 1925 i dërgoi Senatit nga Athina (ku Lumo ishte "Ministër Fuqi-Plotë i Shtetit Shqiptar"-L.M) një raport në të cilën parashtronte /nevojën për të orgnizuar /një festim kombiar për Naimin, një festim patriotik simplë dhe me dinjitet, në shkollat dhe bashkitë e Shqipërisë.

Në këtë kohë mbreti i Turqisë /sulltani/ ka shumë hamëshorë (atllarë) të bukur, që kullosin në këtë nisi. Në anë të mëngjer të këtij limani është një katund i madh me dy mijë zjarre, i quajtur Velona /Vlonë/. Ky katund mund t'i japë mbretit të Turqisë, në kohë lufte, shtatë qint kuaj. Mbi këtë katund është një kështjellë mali e bukur e quajtur Kano/Kaninë/ në të cilin mbreti i Turqisë ka një nëpunës…"

10. Shih "Bibliografi", *Diturija*, Vol. i dytë, Nr. 1, f.16; "Bibliografi", *Diturija,* Nr. 2, f. 32; "Bibliografi", *Diturija,* Nr. 3, f. 42

11. Shih "Bibliografi", *Diturija*,Volum i dytë ,1 dhjetor 1926, Nr. 2, ff.76-78

12. "Naim Be Frashëri, një shëmbëll, një udhëheqës e nj'ideal për Djalërinë Shqipëtare. Jeta dhe veprat et tija"

13. "Për Naim Frashërin"

14. "Naim Frashëri si idealist Shqipëtar"

15. "Naim Frashëri"

16. "Verset e parë shqip"

Më 20 tetor do të këndoheshe në të gjithë shkollat poemi alegorik i Naimit *Manushaqja*, dhe mësuesit do të mbanin një fjalë të vogël mbi jetëshkrimin e tij. Ky raport - shkruan Lumo - u përsërit në shtator të atij moti pastaj edhe me anë të një telegrafi në Kryesitë e dy dhomavet. Mjerisht as parlamenti as Senati nuk e panë të udhësë këtë manifestim"[17].

Ai bën një koment edhe për botimin e librit "Skanderbegu mbas gojëdhanash" të M. Sirdanit, botuar më 1926, si dhe shpreh gjykimin e tij si historian për poemën "Istori e Skënderbeut" (1891) të Naim Frashërit. Sipas tij kjo poemë ndjek "gjykimin pakë prrallor të Barletit, të Fan Nolit që ka përdorur një mënyrë kritike më profit (në mbështetje-L.M) të Piskos, të Xhevat Korçës". Lumo shkruan se titulli "Skënderbeu mbas gojëdhanash" na jep të drejtë të dëshërojmë që të shohim një ditë të mblidhenë, në një mënyrë të kthjelltë dhe krejt dokumentare, të gjithë çë kallxon goja e popullit tënë mbi Skënderbenë dhe shokët e tij, gjithë legjendat mbi shkëmbënj, kronje, livadhe, male ku përmendet emri i heroit tënë, që nga Petrela e gjer në malësitë e Dibrësë, duke pyeturë dhe kërkuarë me kujdes dhe ndërgjegje, në një mënyrë anektotike, me gjithë variantët që mund të paraqitenë. Jemi sigur se kështu do të bëhëtë një veprë magjistrale; *do të dalë në sheh shpirti i kombit*". Ai përfiton nga ky rast të shprehë "një dëshirë, një lutje": "Të përkthehetë shqip një orë dhe më parë vepra e Barletit, e cila, me tërë të metat dhe lajthimet e saj ka më teprë se një vlerë për neve, si e shkruarë prej një kontemporani shqipëtar, të fatosit tënë, si një burim ku kanë marrë lëndë gjth'autorët e tjerë", si dhe shtron me këtë rast nevojën e kërkimeve në arkiva të ndryshme të dokumenteve për Skënderbeun.[18]

Autori i bën të ditur lexuesit tek Diturija "Katedrat e gjuhës shqipe në vënde të huaj dhe albanologjija". Jep një informacion të pasur për albanologë të shquar gjermanë, dhe veprat e tyre për Shqipërinë, duke filluar me profesorin e Universitetit Halle, Johann Thumanne; oficerin bavarez Xylander; konsullin e Austrisë në Shqipëri Dr. Johann Georg von Hahn; studiuesin Franz Bopp; albanalogun Gustav Mayer. Lumo Skëndo jep për lexuesit një informacion të plotë për katedrat e gjuhës shqipe. Shkruan se "më e vjetra" nga këto fillon me Institutin Oriental të Napolit (Instituto Oreintale di Napoli) më 1900; më 1904- vijon autori hapet në Vjenë, në Institutin e Gjuhëve të Lindjes, kursi i shqipes me dr. Gjergj Pekmezin, i cili dha mësim deri në vitin 1914 duke i lënë vendin prof. Kol Rotës që vazhdoi deri më 1923. Prof. Mark Roques, mësues në Sorbonë dhe në shkollën e gjuhëve të Lindjes (Ecole des Langues Orientales Vivantes) - vijon autori, "çeli më 1921 kursin e gjuhës shqipe dy

17. Shih "Bibliografi", *Diturija*, Volum i dytë, 1 dhjetor 1926, Nr. 2, ff. 76-78
18. Po aty, ff. 78-79

here në javë". Lumo bën të ditur se këto mësime motin e parë u dhanë prej tij, Lumo Skëndos, kur ishte "Delegat i Shqipërisë në kryeqytetin francez", dhe më pas, nga z. Dhimitër Beratti, sekretar i Delegatës në Paris. Motin e dytë – shkruan Lumo - mësimet u dhanë prej z. Stavre Stavro". Lumo Skëndo bën të ditur se në Paris, në motin 1921, ishte çelur një Qendër e Studimeve Shqiptare (Centre d'Etudes Albanais); më 1923 fillojnë të mbahen kurse në gjuhën shqipe në Romë dhe në Beograd, i pari në "Istituto delle lingue slavi e orientali", i dyti në Beograd - Seminari i gjuhës shqipe (Seminar za arbanasku filologiu); kursi i fundit ishte themeluar nga prof. Gustav Weigand më 1925, në Leipcig, me ngritjen e një seminari shqiptar "Albaniche Seminar". Weigand botonte një herë në vit revistën shkencore ballkanike "Balkan-Archiv".

Duke bërë fjalë për studimet albanologjike Lumo shkruan e shpreson: "Për neve shqipëtarët – rëndësia e këtyre studimeve është akoma më e madhe … Do të doja që studentët tanë në Vjenë dhe në Paris të afrohen te kurset e profesor Joklit dhe te shkolla e gjuhëve të Lindjes, të familjarizohen me metodat shkencore të gjuhësisë. Nga ana tjatër dhe student të posacëm mund të dërgohen në Leipcig për të vazhduar mësimet e të tre seminarëvët të Ballkanit, dituri e cila na prek jo vetëm nga pikëpamja shkencore po edhe për politikën tonë kombiare, për mbrojtjen dhe lartësimin e shqipëtarizmës". Ai i bën të ditur lexuesit shqiptar, se sipas një letre që kishte marrë nga prof. Veigand, jeta e një student në Leipzig mund të sigurohej me një shumë prej 150-200 markash dhe se studenti shqiptar që do të dëshëronte të ndiqte këtë kurs duhet të kishte mbaruar një gjimnaz të Shqipërisë, të Korçës ose të Shkodrës.

Tek *Diturija* u botuan edhe shkrimet "Jeta ekonomike shqiptare" nga Mehdi Frashëri; "Bujqësija dhe plehëtë kimike" nga Mustafa Villa; "Industria e djathit në Gjirokastër" nga Grigor Vavako; "Djathë i butë i bardhë" nga Grigor Vavako; "Vreshtatë në Shqipëri" nga Mustafa Villa; autori botoi në revistë shkrimin "Fruthi" nga dr. Bedri. "Vdekja në kalamajtë – shkrun – autori - duhet të na bëjë të mejtohemi se… çdo përparim dhe naltësin i Kombit …është i varurë në pritmi i racës numuri i shqiptarëvet shendeti dhe forca e bijve të Shqipërisë". Botuesi i *Diturisë* përfshiu në botim shkrime për zakonet e popullit si "Zakonet e Popullit të Shkodrës" nga Hamdi Bushati; "Zakonet e Popullit në Labëri" nga Kolë Kamsi; "Zakonet e Popullit" nga Hafiz Ibrahim Dalliu[19]; "Zakonet e dasmës në Tiranë" nga Ramazan Dema; "Besime të popullit të katundit Urashtrenjtë, në krahinë të Postripës" nga Hashim Kopliku; "Besime të popullit" (Lugati,Vampiri, Kuçedra, Dragoj)

19. *Diturija.* Volum i tretë, janar 1928, Nr. 3, ff. 105-112.

nga Lumo Skëndo; "Magjitë dhe praktikat e tjera" nga Lumo Skëndo; "Goja e kombit t'onë" (Gruaja dhe martesa etj.) nga Kol Kamsi.

Tek *Diturija* u botuan edhe shkrimet interesante "Shkolla shqipe në Korçë" nga Nuçi Naçi; artikullin "Ujrat" dhe "Udhët, rrugët, pyjet, lumejtë e Shqipërisë së Siperme" nga Eshref Frashëri; "Kënga e sprapsme e Ballës" nga Aleksandër Xhuvani[20]; "Berati Plak", studimi me karakter historik nga Gjergj Haxhi Mihali[21]; "Rnimet mbi Akropoline Feniqit" nga L. Ugolini (Kryetar i Misionit Arkeologjik Italian); "Shënime mbi punimet arkeologjikë të Misionit francës në Shqipëri" nga Leon Rei; shkrime me karakter gjuhesor si "Miscellanea" nga A.Xhvani; shkrimet e Fulvio Cordignanos "Franceskanët në Shqipëri"; "Veprat e Etënvet Jezuitë në Shqipërin e veriut (1841-1928)"; "Mbi rrënimet e Manastirëve benediktinë në Shqipëri"; shkrimet me karakter historik "Kara-Mahmud Pasha" dhe "Copa historije. Oso Kuka"; "Lufta nërmjet Shqiptarë dhe Malazevet" nga Hamdi Bushati; artikull nga dr. Milan Sufflay "Burimetë të historisë Shqiptare"; "Dy shëkëll e gjysmë nga histori e Shqipërisë (1204-1443); "Princërit e Janinës" nga Th. Ippen; "A janë shqiptarët zbritësit e Ilyrianëvet apo Thrakasvet" nga dr. G. Weigand. Ai vetë botoi tek *Diturija* studimet e tij me karakter historik "Luftët e Cesarit dhe Pompe në Shqipëri"; "Një kaptinë nga historia e Lekës së Math"; "Problemet e Shqipërisë independente"; "Javët e fundit të sun(d)imit tyrk në Shqipëri", "Lidhja e Prizrenit". Madje, në një shënim tek ky shkrim i fundit, marrim vesh nga autori edhe humbjen që ai kishte pësuar në Fier më 1915 ose 1916 (gjatë luftimeve mes austriakëve dhe italianëve), "të disa dorëshkrimeve të Abdyl Frashërit (në gjuhë tyrqisht, greqisht dhe shqip) mbi gjithë ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit".

Lumo Skëndo e ka shprehur disa herë vetë mendimin e tij për vlerën dhe rëndësinë e botimit të rivistës *Diturija* në Shqipëri. "Me shkrimet e saj rivista jonë, nga më i gjati gjer në më i shkurtrë artikull - shkruan ai - ka për qok shërbimin e Shqipërisë dhe të shqiptarisë. Ky program zhvillohetë në tema historike, filologjike si dhe në shënime të vogla bibliografike: t'i bëjmë këndonjësit tanë të shohin të kaluarën dhe të mejtohën mbi pritmin (d.m.th të ardhmen -L.M), të kuptojnë detyratë që i bienë kolektivitetit dhe çdo individi, të mund të marrë një formë të caktuar përgjegjësira dhe aspirate t'ona, të mësojmë çë duamë dhe çë lipset të duam." […] "Me këtë mënyrë përpiqemi që botimi ynë të jet' aq' i dobishëm për njërinë privat, për nëpunësin si dhe për mësonjësin ose profesorin… në Shqipëri".

20. *Diturija*, 1928, Nr.8, ff. 309-313

21. *Diturija* 1927, Nr.9,10,11, ff. 329-340

Në fund të botimit të numrit 3, dhjetor 1929, ai tërheq vëmendjen e lexuesit për abonuesit e paktë të revistës për volumin e ardhshëm. "Diturija" shkruan autori ka, gjer më sot, vetëm 52 pajtimtarë që kanë paguar të hollat: 36 brënda në Shqipëri, 16 jashtë Shqipërisë (më të shumët në Amerikë)". Përballë kësaj situate autori shkruan për lexuesit e tij: "botimi i një reviste dhe sidomos i një së përkohëshmeje kombiare si jona, nuk është një interprizë thjesht tregtare. Për neve kjo është një gjë intelektuale, kulturale, patriotike. Në qoftë se kemi nevojë për pajtimin dhe ndihmën monetare të miqvet t'ënë, kemi edhe më tepër akoma nevojë për ndihmën dhe bashkëpunimin moral dhe intelektual të tyre. Kjo ndihmë e fundit do të na jetë fort më e vlefshme se nga e para, më e dobishme për punmi t'ënë"[22].

Me gjithë këtë ndërhyrje numri i abonentëve të nevojshëm nuk u rrit; shoqëria e kohës ishte mjaft e prapambetur për ta ndjekur atë në fushën e dijes dhe kulturës. Për Lumo Skëndon kjo ishte një goditje e rëndë; duke filluar nga kjo kohë deri në periudhën e fillimit të Luftës së Dytë Botërore, ai do të angazhohet si "librar" i librarisë "Lumo Skëndo". Libraria në fjalë u bë pikë takimi e elitës së kohës. Puna si "librar" për të fituar bukën e gojës e detyroi këtë njeri të madh të shpenzonte kohën e tij prej krijuesi dijetar thjesht si librar për të mos thënë librashitës. Por, gjithsesi, ai shkëlqeu edhe në këtë punë duke plotësuar çdo kërkesë të lexuesit të tij për libra që botoheshin kudo në Europë.

22. SKËNDO, Lumo, "Diturija", *Gazeta Shqiptare*, Bari, 1930, kallënuër 23

Akademik Prof. Dr. Sabri Hamiti

DITURIJA: LUMO SKENDO

1. Numri i parë

Numri i parë i revistës *Diturija*; E përkohshme shqip literare dhe diturake; Del një herë në muaj; e themeluar nga Lumo Skendo (Mid'hat Frashëri) del më 1 janar 1909 në Selanik. Revista ka 16 faqe dhe mban lëndën e strukturuar në rubrika: 1) studimin e Lumo Skendos "Istori e shkrimit shqip"; 2. Poezi shqipe nga Ndre Mjedja "Andrë" e nga Gjergj Fishta "Tingllim"; 3. Poezi popullore nga Kalavria, Kolonja e Përmeti; 4. Artikulli i Lumo Skendos "Midhat Pasha", babain e Konstitucionit të Turqisë, burrin e ditur e të drejtë; 5. Andej-Këtej, njohje e kuriozitete nga bota; 6. Pjesa shtëpiake; 7. Bibliografi e 8. Fotografi të Shkupit, të Elbasanit e të Beratit.

Struktura e paraqitjes shfaq orientimin për dëshminë, themelin e njohjen e kulturës identitare shqiptare, duke pasur parasysh raportin e saj me botën. Duke çmuar thelbin e revistës "literare dhe diturake" po shfletojmë studimin për shkrimin shqip, poezitë origjinale dhe njësinë Bibliografi, pa lënë manash vlerën e këtyre shkrimeve në shfaqjen e parë publike dhe rëndësinë e tyre në rrjedha të krijimeve e të dijeve shqiptare.

2. Histori

"Istorinë e shkrimit shqip" Lumo Skendo e nis me shekullin shtatëmbëdhjetë me Pjetër Budin e veprat e tij *Doktrinë e krishtenë* e *Pasqyra e të rrëfyemit*, e vijon me *Fjalorin latinisht-shqip* të Frang Bardhit; e kurorëzon me *Çetën e Profetëve* të

Pjetër Bogdanit. Kjo është shqipja e përdorur dhe e shkruar në dialektin gegë nga priftërinjtë katolikë veriakë. Shekullin e tetëmbëdhjetë e kujton shekull të humbur për shqipen e shkruar. Lumo Skendo rënkon pse shqiptarët shkruajnë në gjuhë të huaja: latinisht shqiptarët e veriut, greqisht shqiptarët e jugut; e turqisht si gjuhë oficiele. Vetëm në shekullin nëntëmbëdhjetë, si shekull të kombësive, shqipja bëhet gjuhë e gjallë dhe e përdorur. Përpara ishte "gjuhë e egër" pa shkronja, pa libra, pa literaturë.

Te shqiptarët e Italisë, Jeronim de Rada shkroi vjersha historike, këngë popullore e bëri kërkime shkronjëtoreje në shqip, duke zgjuar interesin e të huajve për të njohur shqipen.

Kristoforidhi nga Elbasani, duke studiuar shqipen e duke përkthyer shkrimet biblike në dialektin toskë e në dialektin gegë tregoi që shqipja qenka e volitshme për t'u përdorur edhe si "gjuhë e gjallë".

Konceptin "gjuhë e gjallë" (përkundrejt "gjuhë e egër") Skendo e përkufizon kështu:

Një gjuhë bëhet e gjallë kur përdoretë pej popullit, kur përdoretë çdo ditë, kur përdoretë në shkollë, në letrëkëmbim, pej djemet dhe pej pleqet.[1]

Ai e sheh Shoqërinë e Stambollit, të formuar në nëntor 1879, në funksion historik kombëtar e në funksion të kulturës identitare. Pas traktateve të Shën Stefanit e të Berlinit, shqipja e shqiptarët nuk po rrezikoheshin vetëm prej grekëve, por edhe prej serbëve me Rusinë mbas. Lufta identitare tashi nuk bëhej vetëm me zjarr, po me libra, me shkolla, me gjuhë. Shoqëria krijoi alfabetin, hartoi gramatikë, botoi libra, jo vetëm për themelim të gjuhës së gjallë, por edhe përhapjen e kësaj gjuhe. Për këtë detyrë e këtë ngrehinë, për të pushtuar zemrat, shqipes i duhej një shkronjës, rojë vjershëtar. Dhe ky qe Naim Frashëri.

Shërbimet që i ka bërë Naim Beu gjuhës' s'janë për literaturëtë sa janë me të përhapurë të kesaj gjuhe.[2]

Letërsia e Naimit, me temat popullore, për djem, për pleq, për fe, për moral, për trimëri, doli përtej njerëzve të ditur dhe hyri "në kasolle të bujkut; në stan të bariut". Pra një literaturë misionare nacionale.

Lumo Skendo në artikullin "Istori e shkrimit shqip", duke karakterizuar shkrimin letrar shqip në Verí, te Arbneshët në Itali, në Elbasan e në Jug, skicon

1. SKENDO, Lumo, *Diturija*, Selanik, 1909, Nr. 1, f. 4
2. Ibid, f. 5

në zanafillë (pa i emërtuar konceptualisht) qerthujt kulturo-letrarë të shqipes. Kjo ide u mor e u shtrua nga Maksimilian Lamberci më 1922 (te parathënia e *Përrallave*); u saktësua nga Çabej më 1938 (te *Gjeneza*…). Namik Resuli e pranon vetë që këtë klasifikim e kishte adoptuar më 1941 (te *Shkrimtarët shqiptarë*). Ndërsa, Lamberci për herë të dytë, më 1943 te artikulli *Gjeneza dhe zhvillimi i letërsisë shqipe*, këtë karakterizim letrar e shtrin edhe në paraqitjen e letërsisë shqipe të shekullit të njëzetë. Ja pse ideja e këtij artikulli në numrin e parë të *Diturisë* ka krijuar një trashëgimi të pasur letraro-historike në shqip.

3. Poezi

Dëshmia tjetër kulturore identitare, që kthehet në trashëgimi kulturore, janë poezitë okazionale të Ndre Mjedjes e të Gjergj Fishtës, të botuara në faqet 7 dhe 8 të revistës. Vjersha të hartuara nga poetët me kërkesë të vetë Mid'hat Frashërit, në valën e entuziazmit të alfabetit latin të shqipes pranuar më 20 nëntor 1908 në Manastir.

NDRE MJEDJA

ANDRË

Pezull prej qiellit fluturote e shkreta.
E si dielli në mjesdite rreze shpërdake.
Engjëll ndër cuca, o nji çikë gjake
Qi veç qielli nnuron ndër valle të veta.

Arit i kishte flokët, e kish si zhgjeta
Dritën e syve e mollzat rrumbullake,
E buzët e voçra me të njyeme gjake,
Qi kur më behi prej mahnimit heta.

Mandej si nieri, qi prej gjumit ngrihet,
Mora zémrë e e pvëta me trimnië:
Engjell a vajzë je tinë o bukurija?

Qeshi goca nji herë; si vashë që pihët,
Uli krynin të poshtë, e me dashtnië
"Motrë e Nanë, tha, më ke: jam Shqyptarija"

GJERGJ FISHTA

TINGLLIM

Qen i bardhë e qen'i larmë
T'dy jan t'bijt e bushtrës zezë
Populli

Jo, thonë nji palë, t'tânë gjindja e huej n'Shqypni,
Si ban nnokush, për t'kqi s'janë për t'u-sha:
Por gjinnen t'mirë e gjinnen edhe t'këqi.
Përse as n'këtë shekull grûn pa egjër s'ka.

Lum kush beson; por un për vedi e di,
Qi shoqi shojt t'tânë i kan përgja,
Si përgjütet lejthija me lejthi,
E se për ne jânë t'gjithë mollë e pá dá.

Shka thom s'kam mâ, veç po maroj me 'i prrallë
Duel nji me shitun djemën[3] *nëpër dhé*
E mushi 'i thes me djem t'ri e pleq.

Kur hasi m'nji qi thote: Mà shit nji djallë,
Por sgjith-mà t'mirë; i thotë – Nevoj nuk ke
M'e sgjedhë, pse dreq â n'kryet e n'funn â dreq.

Lakimi i gjuhës e i shprehjes shqipe, i kaluar nëpër krahasime të ndjeshme e finoke në kërkim të nuancave të ndjeshmërisë e të mendimit, duke e kërkuar bukurinë e formës krijon kurorën e veprës si metaforë të domethënies identitare shqiptare. Kjo është *shqyptarija*, si formë, si trajtë e kërkimit dhe si rezultat. Këto janë karakteristika të shkrimit poetik të Mjedjes në tingëllimën *Andrë.* Bëhet kjo veçori e formave tingëllimore poetike e këtij autori edhe në vepra të mëhershme edhe në vepra të mëvonshme.

Në *Tingllim* të Gjergj Fishtës, të përsosur formalisht, zotëron fraza fluide e ligjërimit. Fraza iniciale zbërthehet në të dhënën që sprovon situatat kundërshtuese, duke marrë ngjyrimin përqeshës e satirik, si trajtë e vlerësimit përfundimtar.

3. Djaj, shumës i djall

Ligjërimi poetik nuk miklon por sëmbon e gjykon, duke nisur nga figurat e ngurtësuara elementare, për të arritur shkallë-shkallë te një gjuhë e defiguruar si gjuhë në veprim. Edhe më tepër mbasi ky kërkim zhvillohet si shkallëzim i metonimisë duke u ngritur në tërësinë e vjershës për të artikuluar përftimin përfundimtar, *dreqninë*. Ky procedim do të jetë karakteristik për veprën poetike të Fishtës në satirikë, por jo edhe në epikë e në lirikë.

Këto dy vepra të Mjedjes e të Fishtës janë në pozita antitetike, qoftë si kërkim formal apo si domen i domethënies. Mjedja *ëndërron* bukurinë e naltësinë (shqiptare), Fishta *dëshmon* shëmtinë e vogëlsinë (shqiptare). Morali i veprës do të rikrijohet gjithmonë nga lexuesi, nga perceptimi e rezistenca e tij. Dikush e do përmirësimin nëpërmjet lavdit. Dikush e do mësimin nëpërmjet kritikës.

4. Bibliografi

Dëshmia e tretë kulturore del në rubrikën Bibliografi, paraqitja e parë e *Gramatikës së gjuhës shqipe* të Gjergj Pekmezit, Vjenë, 1908. Kjo paraqitje del në faqen 16 të revistës. Ne tashti e rimarrim, si shembull, për të parë shkrimin substancial, të qartë e të saktë, të një njoftimi në stilin enciklopedik të epokës.

> *Bibliografi. Grammatik der albanesischen sprache* (shkronjetor' e gjuhësë shqip) prej D. Pekmezi, Wien 1908, 429 faqe.
>
> "Shkronjëtoreja që patmë fatin të kemi ne dorë s'ësht' e një të huaji, po e një Shqiptari, se zoti Pekmezi është djal' i Shqipërisë që ka bërë mësimet e tij në Vjenë, dhe kështu në një njohje të thellë të gjuhësë shqipe bashkon një thellësi në dituri të gjuhësisë, një thellësi aqë të gjerë sa e G. Majerit.
>
> Kjo libr' është jo vetëm m'e mbaruar e shkronjëtorevet që kanë dalë gjer më tani, po është dhe si nje veprë që duhet të konsultohetë për çdo hollësi dhe rëndësi që takohen në gjuhët, se shkronjësi ka diturë të përmbledhë gjithë ndryshimetë që jan në foljet tënë (toskërisht, gegënisht dhe nënëfoljet e dyta).
>
> Urojmë pra bërësin për librën' e tij dhe vetëm na vjen liksht që një vepër e tillë do të jet'e dobishme vetëm për atá të pakë Shqiptarë që dinë gjermanishtenë".[4]

4. *Diturija*, Selanik, Nr. 1, 1909, f. 16

5. Mid'hat Frashëri

Mid'hat Frashëri e kishte fatin e parathënë të bëhej i njohur qysh i ri e mbante peshën e trashëgimisë.

Bir i Abdyl Frashërit ai ka trashëgimi kombëtariste; pastaj trashëgiminë poetike të Naim Frashërit e trashëgiminë diturake të Sami Frashërit. Edhe më tepër: ai sprovon idenë dhe idealin e rilindasve për Shqipërinë etnike të përthyer në Shqipërinë integrale të kohëve të pritshme.

Protagonist në krijimtari kulturore e në veprimtari kombëtare, u dallua në brezin e vet. Kjo qe shenjuar që herët.

Faik Konica, te *Parashtresë për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare* (1899) e njeh ndër 50 më të shquarit e kësaj Lëvizjeje.

Át Justin Rrota, te *Letratyra shqipe* (1925) ia njeh vlerat letrare e përkthyese, veçanërisht jetëshkrimin e Naimit.

Gaetano Petrota, te *Populli, Gjuha dhe Letërsia shqiptare* (1932) bën një vlerësim të lartë e të gjerë të veprës së tij.

Eqrem Çabej, te *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe* (1936) vlerëson veprimtaritë dhe botimet letrare të tij deri atëherë.

Karl Gurakuqi, te *Shkrimtarët shqiptarë II* (1941) krijon portretin e tij: me jetëshkrim, veprimtari letrare, duke bërë dhe një zgjedhje të shkrimeve të tij.

Pas fitores së Komunizmit në Shqipëri, Mid'hat Frashëri e vepra e tij u ndalua, për pasojë nuk u qarkullua as u mësua në mënyrë institucionale, si dhe shumë të tjerë, të prirë nga poeti kombëtar Gjergj Fishta. Porse, trajtohej nga autorë të huaj e në botën e jashtme.

U kthye në programe e nisi të botohej, pas rënies së Komunizmit, më parë në Prishtinë (1993) e pastaj në Tiranë. Një botim i tij doli në Prishtinë (1996) e tjetri në Tiranë (1999). Botimi i veprave të tij, sidomos në dy vjetët e fundit zgjojnë interesin e madh për rivlerësimin e një krijuesi e mendimtari ekselent.

Kur themeloi revistën *Diturija*, në kallnor 1909, Mid'hat Frashëri nuk i kishte 29 vjet, po kishte një përvojë krijimtarie të botuar te *Kalendari kombiar* për dhjetë vjet rresht te rubrikat (Pjesat) *kombiare*, *diturake*, *letrarishte* etj.

Vihet re që kultura e shkruar te *Kalendari* e kultura e fituar aty janë bazë për programin e revistës *Diturija*, që do të bëhet e krahasueshme me *Albaninë* e Konicës, *Hyllin e Dritës* të Fishtës, *Përpjekjen shqiptare* të Merxhanit apo edhe *Kritikën* e Pipës e *Shêjzat* e Koliqit.

Prof. Dr. Xhevat Lloshi

Çështje gjuhësore në revistën *Diturija* pas Kongresit të Manastirit

Përndjekja e pandërprerë e kulturës dhe gjuhës shqipe nga sunduesit osmanë deri në fillim të shek. XX, duke pasur edhe mbështetjen e shovinizmit fanatik grek, e bënte të pamundur zhvillimin e gjuhësisë shqiptare në rrugët dhe format normale. Në këto rrethana shtypi shqiptar, që mori vrull në fund të shek. XIX, u bë mjedisi, ku mund të shtroheshin çështjet më të rëndësishme dhe më të ngutshme të lëvrimit të shqipes dhe të studimeve gjuhësore. Për pasojë, edhe një revistë e tillë, e cila aq sa i përket shtypit, i përket edhe historisë e gjuhësisë shqiptare, ka qenë *Diturija*. Për shkaqe të rrjedhës së kohës, ajo është botuar gjatë 20 vjetëve, por ka dalë për gjashtë vjet si numra të shtypur.

Gjuhësia jonë tashti e pret me përgëzime të veçanta përmbledhjen e këtyre numrave në dy vëllime të shkëlqyera, të përgatitura nga Biblioteka Kombëtare nën kujdesin e Fondacionit ALSAR, domethënë të prof. dr. Persida Asllanit dhe z. Mehdi Gurra. Urimet tona shtohen edhe për një arsye tjetër. Tashmë kemi 11 vëllime, që riprodhojnë të plotë revistën *Albania* të Faik Konicës, si edhe po nga ALSAR-i katër vëllime të *Kalendarit kombiar*. Na është lehtësuar ndjeshëm puna jonë, mund të japim më shumë duke kursyer kohë të çmueshme, na është krijuar mundësia për ta rrokur menjëherë në pamje të plotë një degë të rrjedhës së kulturës sonë dhe jo vetëm t'i kemi edhe më të dokumentuara kërkimet tona, por po ta thosha me fjalë të tjera, na është pakësuar padituria jonë për trashëgiminë e së kaluarës. Për dobinë e veçantë të këtyre ribotimeve të përmbledhura, dëshiroj

të vë në dukje, se ato na mundësojnë edhe të bëjmë gjetje të reja. Po sjell vetëm një shembull. Kohët e fundit, duke punuar për Gjergj Qiriazin, kam zbuluar te *Kalendari kombiar* një shkrim të tij të panjohur deri më sot. E pranoj me kënaqësi, se pa këtë ribotim as që do ta kisha gjetur kurrë. Pa e nënçmuar dobinë e madhe të zgjidhjeve të sotme elektronike, domethënë digjitalizimin e botimeve, e quaj të padyshimtë, se kur është fjala për gazeta dhe periodikë, shfrytëzimi i po atij burimi në trajtën e letrës së shtypur është pa krahasim më i frytshëm sesa në trajtën elektronike.

Viti i parë i *Diturisë* është menjëherë pas Kongresit të Manastirit. Ajo ishte një ngjarje, e cila e kishte pushtuar gjithë atmosferën shoqërore e kulturore kombëtare. Mid'hat Frashëri kishte qenë edhe kryetar i Kongresit. Dhe prandaj i pari shkrim i të parit numër të revistës është "Istori e shkrimit shqip"[1]. Dituria shqiptare niste me historinë e shkrimit shqip, sepse historiografia në kuptimin e ngushte për cilindo popull nis pikërisht me shkrimin e tij. Kam një vëzhgim për këtë artikull. Infomacioni i tij është i ngjeshur, por nuk përmendet Kongresi. Ka shumë të ngjarë që të ketë qenë përgatitur pikërisht përpara Kongresit dhe me këtë bagazh autori do të shkonte atje. Nga ana tjetër, gjatë atij viti revista ka dalë me alfabetin e Stambollit. Ne e dimë se Kongresi mori një vendim kompromisi. Kjo ndodhi sepse M. Frashëri deri në fund iu përmbajt alfabetit të Stambollit dhe e vazhdoi këtë edhe më pas. Një muaj më parë ai kishte botuar te *Lirija* një shkrim me titullin domethënës: "Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit?"[2] Ai kishte fituar të drejtën të vazhdonte botimet me alfabetin e Stambollit. Natyrisht, kjo e drejtë kishte rënë më 1916, kur rinisi botimi i së përkohshmes dhe ajo më tej doli me alfabetin e sotëm.

Sidoqoftë, edhe numri i dytë hapet me një vërejtje për kulturën e shkrimit, ndiqet nga një fjalorth e po ashtu nr. 11-12 hapet me "Të mësojmë gjuhën"[3], ndërsa fjalorthi ka vijuar në disa numra. Shkurt, *Diturija* numër pas numri bëhej një dije për gjuhën. Për këtë dije dalin edhe emrat përkatës përveç të botuesit: A. Xhuvani, M. Logoreci, K. Gurakuqi etj. Ka edhe përkthime nga G. Weigand-i, P. Skoku.

Prej fillimit janë përvijuar tri drejtimet kryesore të interesimit të së përkohshmes në lëmin e gjuhës: historia e shkrimit shqip; lëvrimi i shqipes së shkruar dhe leksikologjia e leksikografia.

Ndonëse Kongresi i Manastirit ishte çështje e atyre ditëve, redaksia është interesuar për ta ngulitur si ngjarje historike. Prandaj në numrin e tretë janë botuar

1. *Diturija*, Selanik, Nr. 1, 1909, f. 1
2. *Lirija*, Selanik, 1908
3. *Diturija*, Selanik, Nr. 11-12, 1909, f.145

dy fotografi të çmueshme të pjesëmarrësve, shoqëruar edhe me një shkrim të shkurtër; ndërsa është edhe një riprodhim i Vendimeve të Komisionit. Këto janë rimarrë pa fund që nga ajo kohë, pa e vënë në dukje se ky ka qenë burimi i tyre i parë. Rifillimi i botimi më 1916 gjithashtu është hapur me artikullin për shkrimet më të vjetra shqip, duke veçuar njohjen tashmë edhe të *Formulës së pagëzimit*, të fjalorthit të A. Von Harfit dhe Katekizmit të L. Matrëngës. *Formulës së pagëzimit* do t'i vinte radha edhe të riprodhohej më 1927[4] si edhe fjalorthit të Harfit[5].

Një mbështetje e vyeshme për historinë janë të gjitha burimet bibliografike, të cilat nganjëherë shoqërohen edhe me shpjegime e vërejtje. Ndonëse kalojnë 10 vjet, numri i parë i vitit 1926 çelet me shënimet, që e plotësojnë bibliografinë e E. Legrandit. Edhe sot lexohet me kureshti artikulli "Katedrat e gjuhëse shqip në vënde të huaja dhe albanologjia", duke shënuar se vetë termi për albanologjinë është përdorur për herë të parë nja 50 vjet më parë, domethënë rreth vitit 1880. Ndërsa shkrimi për Dhiatën shqip[6] të vitit 1927 nuk është thjesht një artikull, por një fillesë për studimin krahasimtar të teksteve. Artikullin "Disa doreshkrime shqip me germa tyrqishte"[7] më del se nuk e ka përmendur as O. Myderrizi, që u ka kushtuar këtyre një varg punimesh.

Pas alfabetit, vëmendja u drejtua te trajta më e përgjithshme që do të merrte shqipja, për këtë arsye artikulli i parë te numri 4 është "A do të kemi një të vetëm gjuhë literare shqip?"[8] Nuk është rasti për ta vështruar këtë problematikë brenda rrethit të gjerë të shkrimeve nga autorë të tjerë, por autori i përgjigjet qartë pyetjes së titullit: është nevojë që të kemi një të vetme gjuhë letrare, ndërsa i është drejtuar edhe Gjergj Pekmezit për mendimin e tij. Kujdesi për gjuhën e shkruar është shoqëruar rregullisht me vërejtje të ndryshme për atë, që sot e quajmë kultura e gjuhës. Numri 11-12 hapet pikërisht me një shkrim të tillë[9]. Ndër ndihmesat e tjera do të vija në pah vështrimin mbi prapashtesat e emrave[10], një shkrim jo shumë i gjerë, por nga të parët për këto ndajshtesa të shqipes; lakimi i emrave femërorë[11], duke çelur qysh prej nr. 3 një Tribunë gramatike dhe gjuhësie. Te nr. 6 i vitit 1927 botohen shënimet e njohura gjuhësore të A. Xhuvanit nën titullin *Selectae*, të cilat do të dalin edhe në organe

4. *Diturija*, Tiranë, Nr. 6, 1927
5. *Diturija*, Tiranë, Nr. 7, 1927
6. "Një qindvjetore që ka rëndësi për ne", *Diturija*, Tiranë, Nr. 7, 1927, ff. 250-259
7. *Diturija*, Tiranë, Nr. 8, 1927, ff. 288-299
8. *Diturija*, Selanik, Nr. 4, 1909, f. 49
9. "Të mësojmë gjuhënë", *Diturija*, Selanik, Nr. 11-12, 1909, f.145
10. "Fundoretë në emrat shqipe", *Diturija*, Bukuresht, Nr. 3, f. 36
11. "Tribuna" nis me letrën e Karl Gurakuqit "Mbi skajimet e emnavet fêmnorë në veçuer" dhe "Përgjigjen" e L. Skendos, *Diturija*, Tiranë, 1927, Nr. 3, f. 107

të tjera. Për Dorëshkrimin e Grottaferratës ka shkruar i pari Nilo Borxha pikërisht në këtë revistë në nr. 9-11, 1927.

Drejtimi i tretë zë fill që në numrin 2, siç e thashë, me "Fjalëtore e vogëlë"[12]. Nuk e di a e kanë vënë re hulumtuesit e veprës së M. Frashërit, por edhe në 'Kalendarin kombiar" të vitit 1909, domethënë njëkohësisht është botuar po kjo "Fjalëtore e vogëlë". Pavarësisht se nuk është nënshkruar nga ndonjë emër, kemi të njëjtën mundësi të re për të përcaktuar autorësinë pikërisht tashti me ribotimin e këtyre përmbledhjeve. Vijimin e gjejmë te numrin 4 krahas artikullit për "Fjalëtoretë shqip" për të vazhduar në disa numra të tjerë. Rubrika "Fjalëtore e vogëlë" në thelb nuk është thjesht, siç e ka paraqitur autori, 'për ca fjalë që s'para u dihenë dëftesat', por është një fjalorth në katër gjuhë, ku vendin e parë e zë shqipja dhe përkthimi i parë është turqisht. Vetëkuptohet, që nuk mund të ishin fjalë të cilave nuk u dihej kuptimi: *anëtar, kryetar, dobi* etj. Ndonëse nuk janë shumë njësi, kemi mirëfilli dromcat e para të shtypura të një fjalori shqip-turqisht, sepse nuk kishte pasur asnjë rast të tillë deri atëherë.

Më 1927 jepen disa "Vërejtje psikologjike mbi Fjalorin e Marko Boçarit"[13]. Autori është nisur nga mendimi i gabuar, se ky ishte fjalori i heroit suljot. Në të vërtetë është një lëndë leksikore të cilën vetëm sa e ka shkruar Markoja që nuk i kishte mbushur 19 vjeç, por e mbledhur nga Pukëvili për librin e vet. Përkthimin e greqishtes 'parthenos' Mid'hati nuk ka guxuar ta jepte, sepse ishte në shqipen vulgare dhe po kështu kanë bërë edhe të tjerë më vonë. Mirëpo ajo përbën vërtetimin më përshtypjelënës, se atë fjalë e kishin shqiptuar me të tallur burrat Boçarë rrotull sofrës me mikun francez dhe ishin të dehur. Unë do ta përfytyroja skenën kështu rreth sofrës: Pukëvili i pyet greqisht se si do ta thoshin 'shën Mëria e Virgjër' dhe ata kanë qesëndisur: "E mo, çish t'ia themi këtij? Shkruaje more aty . . ." Kjo fjalë e vetme, një blasfemi e padëgjuar, mjafton për të rrëzuar gjithçka është sajuar për këtë dorëshkrim, që nuk ka qenë asnjë lloj fjalori i Marko Boçarit.

Vërejtje gjuhësore ka edhe nëpër recensionet e gjera, të përfshira në rubrikën e librave të udhëtarëve të huaj për Shqipërinë. Po të shihen me vëmendje disa rubrika, janë në të vërtetë libra të dhënë me përkthim pjesë-pjesë në numrat e revistës. Prej këndej rrjedh, që numrat e saj kanë një lidhje, një vazhdimësi të dukshme të përmbajtjes, duke siguruar kështu edhe të njëjtin qëndrim, jo me kundërthënie.

Së fundi, nuk mund të lihet jashtë vëmendjes kujdesi për t'u hapur faqet polemikave ndërmjet autorëve për anë të ndryshme drejtshkrimore e gramatikore

12. *Diturija*, Selanik, Nr. 2, 1909, f. 20

13. *Diturija*, Tiranë, 1927, Nr. 12, ff. 387-393

të fjalëve në gjuhën e shkruar. Me rëndësi është, që në këto diskutime pranohet nevoja për të ndjekur evoluimin e gjuhës dhe dokumentimin e saj, që të mos mbetemi te mendimet vetjake të gjuhëtarëve, sepse do ta pranojmë, që edhe gjuhëtarët kanë parapëlqimet e tyre si përdorues të zakonshëm të gjuhës, ndonëse kërkojnë argumente për t'i mbështetur shkencërisht. Shija për gjuhën është gjithashtu faktor objektiv, pavarësisht se nuk ka gjetur ose nuk e gjen dot trajtimin e rreptë me terma shkencorë.

Dëshiroj ta mbyll këtë fjalë me përfundimin e arritur, pas shqyrtimit të gjurmëve të vjetra të shqipes në artikullin "Për shkrime të haruarë dhe të paditurë" të numrit 2 të vitit 1916, domethënë të një viti të errët të Luftës I Botërore, ku tingëllon i qartë besimi te fuqia e shqipes:

Këto që rrëfeva më lart më bëjnë të besoj se të folët e Arbërisë ka qënë dhe duhet të ketë qënë kurdoherë, në mos dhe prej shumë shekujsh, të pakën që katrë a pesë qint vjet e tëhu – si një gjuhë e gjallë dhe praktike.[14]

14. *Diturija*, Bukuresht, 1916, Nr. 2, f. 23

Prof. Dr. Persida Asllani

Lumo Skëndo, revista *Diturija* dhe misioni i dijes

Revistat kulturore janë një nga kapitujt më interesantë e domethënës të historisë së kulturës shqiptare. Ato lidhin emra të mëdhenj me momente të mprehta historike, me dije e shkrime specifike kombëtare dhe me potenciale të fuqishme leximi. *Albania*, *Diturija*, *Hylli i Dritës*, *Zani i Naltë*, *Leka*, *Shkëndija*, *Përpjekja shqiptare*, *Minerva* etj., janë vetëm pjesa më e dukshme dhe më e shkëlqyer e një rrjetëzimi të papërsëritshëm kulturor përmes të cilit gjuha dhe kultura shqiptare sfiduan tema, debate e perspektiva nga më të larmishmet, në të cilin u dëshmua e u dokumentua historia e popullit dhe jeta e kombit, e sidomos, u shpreh një vetëdije identitare e gjithnjë e më e artikuluar.

E themeluar prej Lumo Skëndos rreth 110-vjet më parë, revista *Diturija* profilohet si një nga zërat më specifikë të shkrimit dhe propagandimit të dijes elitare mbi kombin: gjuhë, histori, mënyrë e shprehi jetese, mendësi e tradita, dije e thellë dhe e dokumentuar, e sprovuar në qindra tituj bibliografikë e mijëra citime, në kërkime e referenca marramendëse arkivore dhe në lexime kritike të një shprehie të rrallë shkencore e diturore.

Duke lidhur në mënyrë të pandashme nevojën për kujtesën me shkrimin, me mendimin dhe me historinë, themeluesi i kësaj reviste e përkufizoi dikur shkrimin

e Historisë si "thesari intelektual dhe kombiar i një populli, [...] monumenti i jetes' së shkuarë që vepron mbi ditët e sotme dhe kohën e arthme."[1]

Këtë monumentalitet e rrokim sot thuajse në çdo numër e faqe të revistës së tij. E themeluar në Selanik më 1909 ajo u shndërrua në ngrehinën e dijes dhe "bujarisë së dijes" gjatë viteve 1926-1929, një monument kulture. Bashkë me *Albaninë* e Konicës dhe me plejadën e simotrave të saj gjatë viteve '30-'40 të shekullit të kaluar, këto revista përbëjnë një nga entitetet themelore të kulturës së shkruar shqipe.

Pjesa më thelbësore e veprës së Mid'hat Frashërit në shqip u karakterizua nga pasioni i dijes dhe i përcjelljes së saj sa më cilësisht te lexuesi shqiptar. Ende djalosh 17-vjeçar, por me cilësi intelektuale të jashtëzakonshme, ai e nisi bashkëbisedimin me bashkëkombasit e tij në tribunën më të mirë kulturore të kohës, te *Albania* e Konicës, me pseudonimin fillestar Skëndo Frashëri[2], pikërisht me një shkrim kushtuar Skënderbeut më 1897. Ndërsa po atë vit, pseudonimi "Lumo Skëndo", që do të shndërrohet në emblemën e jetës së tij krijuese e intelektuale, shenjon themelimin e bibliotekës së tij personale[3], e cila do të shndërrohet nga ana e saj në emblemën e fondit albanologjik mbarëshqiptar e ballkanik. Bashkëpunimi i gjatë me Kristo Luarasin për *Kalendarin Kombiar* qysh në vitin 1898, e më pas botimi i një vargu veprash me natyrë eseistike, historike e politike si: *Pritmi i Shqipërisë*[4], *Çështja e Epirit*[5], *Shqipëria dhe Shqiptarët*[6], udhëpërshkrimi *Letra mi një udhëtim në Svicrë*[7], përmbledhja *Plagët tona*[8] e sidomos vëllimi letrar *Hi dhe shpuzë*[9], i japin këtij pseudonimi identitetin e plotë të qenies krijuese e diturore.

Mid'hat Frashëri e kish kuptuar qysh herët se dinjiteti i njeriut dhe i kombit, ëndrra e lirisë lidhej tashmë pazgjidhshmërisht me diturinë prej së cilës do të mbruhej vetëdija identitare. Ndaj çështja e dijes dhe e njohjes është realisht trokitja e tij e parë në botën e kulturës kombëtare. Shkrimin e parë të 25 marsit

1. SKENDO, Lumo, "Burimet e historisë Shqipëtare", *Diturija*, 1928, Nr. 12, (vol III), f. 361
2. Me këtë pseudonim ai boton shkrimet e para te Albania: "Skander bégu", Albania, Nr. 3, Viti I, Bruksel, 1897, f. 33; "Fé c'është, komp c'është", Albania, Nr. 4, Viti I, Bruksel, 1897, f. 49; "Bertim", Albania, Nr. 5, Viti I, Bruksel, 1897, f. 67
3. SKENDO, Lumo, "Testament", cituar sipas "Mid'had Frashëri - *Vepra të zgjedhura 1*", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo", Tiranë, 2017, f. 636, referuar AQSH, F.35, d.41: Testamenti i Mid'hat Frashërit, Tiranë 1929
4. SKENDO, Lumo, *Pritmi i Shqipërisë*, Sofje, Shtypshkronja "Mbrothësia", 1915
5. SKENDO, Lumo, *Affaire de l'Epire: le martyre d'un peuple*, Sophia, Indépendance Albanaise, 1915
6. SKENDO, Lumo, *Albanie et les albanais*, Annales des nationalités, Nr. 8-9, Lausanne 1918
7. SKENDO, Lumo, *Letra mi një udhëtim në Svicrë*, Sofje, Shtypshkronja «Mbrothësia», 1915
8. SKENDO, Lumo, *Plagët tona, çë na mungon?çë duhet të kemi*, Tiranë, Shtypshkronja «Mbrothësia», 1924
9. SKENDO, Lumo, *Hi dhe shpuzë : frymëzime, novela, kujtime*, Tiranë, Shtypshkronja «Mbrothësia», 1915

te *Albania*, me titull "Skënder Beu" ai e çel me pyetjen: "SHQIPTARË! A e njihni këtë emër?"[10]

E gjithë vepra e jetës së tij rreket të përmbushë këtë mision të dijes, të shpjerë te përgjigjet e të shtrojë pyetje të reja. "Shqiptarit aq sa i duhet buka i duhet dituria dhe nazionalizma. Për të rrojtur si komb, duhet të luftojmë për t'u bërë e për t'u njohur si komb"[11] – shkruan ai më 1899 te *Kalendari Kombiar*, vepra që mori gjithnjë e më shumë gjatë viteve fizionominë e penës e dijes së tij. Me një frymë naimjane, misionin e *Ditërrëfenjësit* do ta përshkruante gjithnjë si "kujdesje për të ndriçuar udhën", si përpjekje për të ndezur, së bashku me Kristo Luarasin e miq të tjerë, "një qiri të vogël, një dritë" e të ftonin "shqiptarët të mblidheshin përqark."[12]

Lexuesi i vëmendshëm i Lumo Skëndos mund ta verë re se si misioni i natyrës iluministe, shpjeguese, te shkrimet e hershme të *Ditërrëfenjësit* shndërrohet gjatë viteve në një rrugëtim plot pasion për dijen e specializuar në histori, gjuhësi, udhëpërshkrime, libërpërshkrime, dëshmi e dokumenta, një dije-pasion që mund të jetohej e tillë vetëm duke e ndarë bujarisht me të tjerë e duke grishur elitën e re të bëhej pjesë e këtij rrugëtimi. Në letërkëmbimin me Kostë Çekrezin (21 shtator 1922) gjejmë madje të shprehur misionin që ai i jepte vetes e miqve të tij të penës për të zgjuar " në disa qarqe një jetë intelektuale, një rrojtje me ide të ra, një jetë mendore."[13] Ndërsa, duke shpallur misionin e *Diturisë* ai theksonte se "në shkrimet e saj rivista jonë, nga më i gjati gjer ne më i shkurtrë artikull, ka për qok shërbimin e Shqipërisë dhe të shqiptarizmësë. [...] T'i bëjmë këndonjësit tanë të shohin të shkuarën dhe të mejtohen mbi pritmin, të kuptojnë detyratë që i bienë kolektivitetit dhe çdo individi, të mund të marrë një formë të caktuarë përgjegjësia dhe aspiratat t'ona, të mësojmë çë duamë dhe çë lipset të duamë."[14] Ndërsa disa vite me vonë, ai e përkufizon dijen dhe diturinë në faqet e "Përpjekjes Shqiptare" si " një tryez' e çuditëshme , i zoti (i së cilës) kërkon që çdo njeri të vij' e të marrë pjesë në atë gosti të shkëlqyshme"[15].

---

10. FRASHËRI, Skëndo, "Skander bégu", *Albania*, Nr. 3, Viti I, Bruksel, 1897, f. 33
11. Cituar sipas BUTKA, Uran, "Vepra madhore e Mid'hat Frashërit", *Mid'had Frashëri - Vepra të zgjedhura 1*", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo", Tiranë, 2017, f. 16, referuar *Kalendarit Kombiar* të vitit 1899
12. "Parathënëje", *Kalendari Kombiar për vitin 1926*, Tiranë, f. 28
13. NURO, Kujtim, "Ndihmesa e Mithat Frashërit në lëmin e arkivistikës dhe të bibliotekës", *Studime Historike*, 1995, Nr. 1-4, botim i Institutit të Historisë, ASHR, Tiranë, 1997, f. 85
14. SKENDO, Lumo, shënim në rubrikën "Këndonjësit" që mban datën 31 gusht 1928, botuar në *Diturija*, Nr.12, Tiranë, 1928
15. SKENDO, Lumo, "Për historin e Shqipërisë", *Përpjekja shqiptare*, Nr. 4-5-6, Tiranë 1937, f. 230

Nuk gabojmë nëse e përfytyrojmë Lumo Skëndon të përfshirë nga ndjesia e kësaj "gostie të jashtëzakonshme" çdo herë, çdo ditë që ai mendoi e punoi për projektin e themelimit dhe botimit të revistës *Diturija*. Ashtu siç nuk gabojmë edhe nëse mbas fjalës "Diturija" të shqiptonim me mend, atë "kombiare". Sepse i tillë ishte misioni i kësaj reviste, e cila, teksa zuri fill më 1909 në Selanik me përcaktimin "E përkoshme shqip literare dhe diturake" do të vijonte nga 1926 më 1929 në Tiranë (mbas daljes 3 mujore në Bukuresht më 1916) me formulimin "E përkohëshme shqipëtare". Thelbi i saj ishte pikërisht kjo dije mbi kombin, e mbrujtur me dashurinë e pakushtëzuar për "dijen" po aq sa me dashurinë e pakushtëzuar për atdheun. *Diturija* e Lumo Skëndos shfaq simbiozën e rrallë të nocionit të dijes, diturimit, dhe atij universal të atdheut. Ajo e lidh njeriun individual me tërësinë e entitetit kombëtar, përmes të cilit ai shndërrohet në "njeriun në botë", në qenien universale.

Këtë bindje Mid'hat Frashëri e shpreh madje edhe në Testamentin e tij, ku në mbështetje të domosdoshmërisë së themelimit të Institutit të Albanologjisë, për të cilin dhuronte gjithçka që zotëronte, shpreson "që çdokush të kuptojë se e mira e Kombit është e mira jonë private, se nderi dhe lavdi i shqiptarëvet të gjithë, është edhe nderi dhe lavdi ynë personal."[16] Çdo përpjekje për të siguruar këtë lidhje përmes dijes, kërkimit shkencor e botimit, përbënte një gjest fisnik e patriotik, te i cili ai besoi edhe mbas mbylljes së revistës së tij. "Lithka, interesi që kemi për të shkuarën t' ënë janë rrënjët që ushqejnë trupin e një kombi. Sa me tepr' andë dhe dashuri të kemi për 'të, aqë më shumë të shëndoshë do të jemi si trup" – përmbyll ai artikullin "Për historinë e Shqipërisë"[17] më 1937.

Revista *Diturija* është shprehja më e plotë e profilit intelektual të Lumo Skëndos. Duke pasqyruar hulumtimet dhe leximet e tij të thelluara nga më të larmishmet, ai zhvilloi linja të gjera studimore që i lejuan të ndërtonte e të sistemonte një korpus të mirëfilltë albanologjik në çështje të historisë, të udhëpërshkrimeve, të dëshmive, të gjuhësisë shqipe e drejtshkrimit, të bibliografisë etj. Ndër to spikasin cikli "Udhëtarët e huaj në Shqipëri", rubrikat "Shtim në rradhojtë e Legrandit", "Duke lexuar një libër", "Tribuna gramatike dhe gjuhësijë", biografi të shumta, vëzhgime zakonore, dëshmi historike si dhe shkrime me interes të veçantë mbi historinë e besimeve dhe kultit ndër shqiptarë etj.

Madje, për këto të fundit ai na dëshmohet edhe një promotor i kërkimit dhe mbledhjes së informacionit e dokumentacionit përmes të cilit

16. SKENDO, Lumo, "Testament", cituar sipas "Mid'had Frashëri - *Vepra të zgjedhura 1*", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo", Tiranë, 2017, f. 637, referuar AQSH, F.35, d.41: Testamenti i Mid'hat Frashërit, Tiranë 1929

17. SKENDO, Lumo, "Për historin e Shqipërisë", *Përpjekja shqiptare*, Nr. 4-5-6, Tiranë 1937, f. 231

do të mund të ndërtohej një histori e besimeve, objekteve të kultit dhe institucioneve fetare më të rëndësishme të vendit: "Duke dashur të çel një faqe në këto kërkime – shpalos ai projektin e vet më 1927 -, kam dëshiruar që «Diturija » të mund të botojë dokumente mbi historinë e faltoreve të Shqipërisë, të kemi ose të përpiqemi të bëjmë disa monografi për urdhrat dhe tempujt e feve që frymëzojnë popullin tonë. Si për kishat, manastiret, xhamitë, ashtu edhe për teqetë do të jetë mirë të ngjallim ditët e fikura, duke prapsur pakëz pluhurin e viteve. Nevoja e kësaj po ndjehet më tepër akoma kur vërejmë mungesën e çdo informate të kthjellët, e çdo dokumenti të shkruar. Jemi të shtrënguar që të rëmihim në kujtimet dhe të përpiqemi të zbulojmë burimet e paditura gjer më sot. […] Me këtë qëllim – pohon ai -, « Diturija » bëri një letër drejtuar krerëve të teqeve të Shqipërisë, duke lypur shënime historike mbi cilëndo faltore."[18]

Në vijim të këtij vullneti, gjatë viteve 1927-1929 në faqet e *Diturisë* do të botohen shkrime me natyrë studimore, dokumentuese dhe historike mbi "Bektashinjtë në Shqipëri"[19] (pjesë e rubrikës "Duke kënduar një librë" të vetë Lumo Skëndos si një refleksion mbi librin e At Ali Tyrabiut *Literatura e Bektashinjvet, a vjersha të përkthyera prej shkrimtarëve Bektashinj të vjetër*); mbi "Franciskanët në Shqipëri"[20] (nga Karl Gurakuqi); mbi "Veprat e Etënvet Jezuitë në Shqipnin e Veriut 1841-1928"[21] (nga At Fulvio Cordignano, i cili e shkruan posaçërisht për *Diturinë* me kërkesë të Lumo Skëndos); si edhe "Mbi rrënimet e Manastirëvet benediktinë në Shqipëri"[22] (po nga At Fulvio Cordignano), shkrime të shtrira në disa numra dhe që u ndërprenë për shkak të ndërprerjes së botimit të revistës. Po t'i shtonim edhe artikullin më të hershëm të vitit 1916 mbi botën arbëreshe, historinë e episkopatit të tyre ortodoks "Peshkupija dhe Kollegji i Shqipëtarëvet në Kalabri"[23] (bazuar mbi artikullin e Luigji Albertit), mund të hamendësohet se autori i kësaj ideje po synonte maketin e një Historie të religjioneve, kulteve dhe rolit të tyre shpirtëror e kulturor ndër shqiptarë.

18. SKENDO, Lumo, "Bektashinjë në Shqipëri", rubrika "Duke kënduar një librë", *Diturija*, Tiranë 1927, Nr.2, (viti III), f. 69-70

19. Po aty, ff, 69-72

20. GURAKUQI, Karl, "Franciskanët në Shqipëri", *Diturija*, Tiranë 1927, (viti III), Nr.2, , ff. 88-95

21. CORDIGNANO, Fulv, "Veprat e Etënvet Jezuitë në Shqipnin e Veriut 1841-1928", *Diturija*, Tiranë 1928, (viti III), Nr.6, ff. 218- 226 dhe Nr. 7, ff. 248-252

22. CORDIGNANO, Fulv, "Mbi rrënimet e Manastirëvet benediktinë në Shqipëri", *Diturija*, Tiranë 1929, (viti IV), Nr.1, ff. 9-19; Nr. 2, ff. 50-57 dhe Nr. 3, ff. 85-91

23. SKENDO, Lumo, "Peshkupija dhe Kollegji i Shqipëtarëvet në Kalabri", *Diturija*, Bukuresht, 1916, Nr. 2, ff. 27-29

Mbresëlënëse janë leximet erudite të Lumo Skëndos në ciklin "Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit 19-të" ku paraqiten udhëpërshkrimet e Lorenzo Bernardo-s, Arnold Von Harff-it, Pouqueville-it, Lord Byron-it, Bartholdy-t, Ami Boué-s, Edward Lear-it, Hann-it etj., duke sjellë një korpus prej 26 dëshmish unike mbi Shqipërinë dhe hapësirën ballkanike. Të pajisura me shënime të shumta plotësuese, skica, fotografi, harta e grafika, ato përbënin një enciklopedi më vete albanologjike. Studiuesi Luan Malltezi, në përmbledhjen që ai dhe kolegu i tij, studiuesi Sherif Delvina, kanë përgatitur po me titullin e rubrikës "Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit 19-të" e cilësojnë këtë cikël shkrimesh "me karakter krejt të veçantë", si mundësinë e vetme ku së pari, bashkëkohësit e Lumo Skëndos "në kushtet e prapambetjes së përgjithshme të vendit, të mungesës së kërkimeve arkivore dhe të studimeve historike, të njihnin sadopak nëpërmjet këtyre shkrimeve historinë e kaluar të vendit".[24] Me të drejtë ata i njohin vlerën tashmë dokumentuese kësaj rubrike edhe në ditët e sotme, në kushtet kur ky "informacion krejt specifik për natyrën e tij, [...] nuk sigurohet dot nga burimet arkivore të kohës të kryera tashmë nga studiuesit tanë në biblioteka dhe arkiva të huaja."[25]

Por kthjelltësia e Lumo Skëndos në misionin dituror të veprës së vet e shtyn atë të pajisë me shqisën kritike edhe lexuesin e "udhëpërshkrimeve", të cilit "i edukon" shprehitë e leximit kritik mbi tekstin dhe informacionin që përcjell, qoftë kur synon të korrigjojë ndonjë "lajthitje" në perceptim të vetë udhëtarëve të huaj, si për shembull në rastin e pasaktësisë së Von Harff-it me emrin e Vjosës duke theksuar se "është çudi qysh udhëtari ynë flet në Vlorë për Bojanën! Padyshim ka dashurë të bëjë fjalë për Vjosën dhe shëmbëllimi i emrit e ka shtyturë në konfondim"[26], por edhe me rastin flagrant të qëndrimit tepër subjektiv të Pouqueville-it ndaj Ali Pashë Tepelenës, duke komentuar se "konsulli melankolik na lajmëron sakaqë se do të bëjë fort pakë fjalë nga vetëhe e tij. Po aqë sa na tha janë mjaft të na dëftejnë dispozitat në të cilat ndodhesh, prirjen' e pakët që ndjen për një vent ku qeveri e tij e kishte ngarkuarë me mbarimin e një misioni delikat. Dhe në çdo send shohim një kontrast midis ndjenjavet dhe fjalëvet të Pouqueville-it dhe udhëtarëvet të tjerë, që i janë afruar' Ali pashësë, sidomos të Englezvet, veprat e të cilëvet i kemi analizuarë më parë."[27]

24. MALLTEZI, Luan, DELVINA, Sherif, "Parathënie", Lumo Skëndo - *Udhëtarët e Huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX*, Shtëpia botuese "Via Egnatia" dhe ALSAR, Tiranë, 2012, f. 8

25. Po aty

26. SKENDO, Lumo, "Udhëtarët e Huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX", *Diturija*, Tiranë, 1927, Nr. 7 (viti II), f. 244

27. SKENDO, Lumo, "Udhëtarët e Huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX", *Diturija*, Tiranë, 1927, Nr. 1 (viti III), f. 4

Siç mund të shihet edhe nga ky fragment simbolik, krahas informacionit gjithnjë kërshëritës, lexuesi mund të shijojë penën elegante prej shkrimtari të sprovuar herët në proza poetike të publikuara në përmbledhjen *Hi dhe shpuzë* (1915) si dhe finesat e përkthyesit të dikurshëm të Lamartinit (1898), Defosë (1909), Hofmanit (1900) etj[28].

Lumo Skëndo e pati konceptuar qysh në zanafillë *Diturinë* si një hapësirë shkëmbimi të intelektualëve shqiptarë dhe albanologëve më të njohur të kohës duke shpalosur kontributet e tyre të çmuara. Emra si Pedersen, Jokl, Borgia, Weigand, Roques, Pop, Šufflay, Pekmezi, K. Gurakuqi, A. Xhuvani, M. Logoreci, P. Ikonomi etj., i dhanë *Diturisë* dinjitetin e një katedre albanologjike të mirëfilltë. Me vetëdijen e kthjellët të dokumentit, ai nuk rreshti së sjelluri në vëmendjen e studiuesve të rinj shqiptarë pasurinë ende të pashfrytëzuar dokumentare të arkivave të Turqisë, Greqisë e Spanjës, të Romës, Vatikanit, Venedikut, Raguzës, Bonit, Vienës, Sofjes, Londrës, Peterburgut, Beogradit etj.

Një prej shkrimeve që reflekton më së miri dijen e tij të gjerë mbi burimet arkivore, njohjen e thellë të veprave albanologjike, e sidomos konceptin filozofik mbi Historinë është ai me titull "Burimetë të historisë Shqipëtare", të cilin e sjell si një kryeartikull në numrin e tetorit të 1928-ës. Së pari, vetë shkrimi i Historisë konceptohet si akt i një domosdoshmërie të dyfishtë, nevojë e inteligjencës dhe e ndjenjës, me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e kombit që e prodhon dhe e jeton atë. Për rrjedhojë, mungesa e shkrimit të Historisë, këtij "monumenti të jetës së shkruar" të kombit, prej të cilit vuan bota shqiptare, projektohet drejtpërsëdrejti në problematikat e së tashmes dhe sidomos në konceptimin e së ardhmes. Nga ana tjetër, shkrimi i Historisë bazohet ekskluzivisht mbi dëshminë, mbi tekstin e shkruar, mbi dokumentin. Prandaj çështja e burimeve të historisë është thelbësore për Lumo Skëndon dhe mungesa e tyre thuajse "një fatkeqësi" e parikuperueshme qytetërimore: "Kanë rrojturë dhe vdekurë [parardhësit tanë], kanë vuajturë dhe janë gëzuarë, përpjekurë dhe luftuarë pa ndjerë nevojën të rregullësojnë marredhanëjet e tyre, të ngrehin një bilancë për aktet' e tyre, dhe asoj të lajmërojn' edhe brezat e pastajmë. Kështu që, të mos ishin ca të paka zënë ngoje nga ana e të huajvet, gjithë jeta e shkuar' e Shqipërsië do të formonte një errësirë të trashë për ne. Dhe këtë fatkeqësi e ndjejmë kaqë më teprë kur aspirojmë në një rrojtje me përgjegjësi dhe me dignjitet, kur fillojmë të ndjejmë se lipse të kemi dritë rreth nesh."[29]

---

28. Është fjala për përkthime të hershme kryesisht për të rinj e fëmijë: *Gyjom Telli*, Alphonse De Lamartine, Sofje, Shtypshkronja "Mbrothësia", 1898; *Robenson*, Daniel Defoe, Selanik, Shtypshkronja "Mbrothësia", 1909 ; *Bëje të mirën pa hidhe në det,* Franc Hofman, Sofje, Mbrothësia e Kristo Luarasit, 1900.

29. SKENDO, Lumo, "Burimetë të historisë Shqipëtare", *Diturija*, Tiranë, 1928, Nr. 12, f. 361

Tashmë, historianëve dhe studiuesve shqiptarë u duhej një strategji e qartë për të rrugëtuar drejt dëshmisë dhe dokumentit, vetëdije e kthjellët për misionin që ndërmerrnin dhe përkushtim:

"Çdo i interesuarë për kësi farë studimesh duhet të jetë i bindur se, për çështjenë që na prek, çdo arhivë, çdo bibliotekë, munt të mbajë një xhevahir. A s'është në bibliotekë të Vatikanit libra e Buzukut, më i vjetri monument i shtypurë i gjuhësë shqipe, dhe Jorga a nukë gjeti në bibliotekë të Laurentianësë, në Firenze, gjurmënë më të vjetrë të gjuhës s'ënë, të njohurë gjerm më sot? Nukë do neglizhuarë mbi këtë, as një bibliotekë, as një arkivë, sidomos thesarët intelektual të Italisë, të Vjenës, të Parisit, Të Londrës, të Oksfordit... Mos harrojmë në këtë mes kanceleritë e Shtetevet të ndryshme, korrespondencat zyrtare mes dy qeverive ose raportet e Ambasadorëve e kosujvet të tyre: Vjena, Petersburgu, Londra, Parisi, Stambolli, Athina... kanë fatë të tëra të historis' sonë së re, sa edhe gjer Korfuzi."[30] Si apogjeun e kërkimit arkvior albanologjik ai cilëson bashkëpunimin frytdhënës të të mirënjohurve Thallozcy, Jireçek dhe Šufflay me botimin e vëllimit të parë të *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetates ilustrantia*, përkufizuar prej tij si "monument".

I përfshirë qysh në rininë e hershme në çështjet e mprehta të Rilindjes Kombëtare, i vetëdijshëm për vlerën dhe rolin e patjetërsueshëm të dëshmisë dhe dokumentit në shkrimin e historisë, autori i këtyre këshillave dhe grishjeve ndaj historianëve të ardhshëm të kombit u përfshi edhe vetë personalisht në shkrimin e atyre faqeve të historisë së shqiptarëve, të cilat ende prisnin të shkruheshin e të dëshmoheshin. Ky shkrim cilësor zë fill qysh me numrat e parë të *Diturisë* (Selanik, 1909), me dokumentin e "Vendimit të komisionit mbi çështjen e abecesë" si dhe me dy fotografitë e mirënjohura të anëtarëve të Kongresit dhe të Komisionit të Alfabetit, të cilat i pajis me shënime të holla për identitetin, rolet dhe kontributet e secilit[31]. Gjatë trazirave të vitit 1916, në tri numrat e vetëm të *Diturisë* (Bukuresht) ai sjell në seri shkrimin dokumentues "Shqiptarët në Greqi"[32], ku përmbledh të dhëna historike, statistikore, vendbanime dhe referenca arkivore përmes studiuesve më të njohur mbi temën. Ndërsa shkrimin "Aktiviteti i Shqiptarëvet në Rumani"[33] i nisur qysh më 1916 do ta rimarrë dhe plotësojë në disa numra të *Diturisë* në Tiranë, gjatë viteve 1926-1927.

30. Po aty, f. 370
31. SKENDO, Lumo, "Kongres' i Manastirit", *Diturija*, Selanik, Nr. 3, 1909
32. SKENDO, Lumo, "Shqiptarët në Greqi", *Diturija*, Tiranë, 1916
33. SKENDO, Lumo, "Aktiviteti i Shqiptarëvet në Rumani", *Diturija*, Tiranë, 1916

Në këtë periudhë vjen edhe shkrimi dëshmues "Shoqëri e Stambollit"[34], me të dhëna të hollësishme mbi veprimtarinë dhe statutet e saj, si edhe shkrimi erudit "Luftët e Cesarit dhe Pompe në Shqipëri."[35]

Viti 1928 mendojmë se paraqet edhe periudhën e një pjekurie në shkrimin e dëshmisë historike të Lumo Skëndos, veçanërisht përmes botimit në disa numra të "Problemet e Shqipërisë Indipendente – shkruarë pas kujtimevet personale"[36], si dhe shkrimin kushtuar 50-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit (edhe ai në disa numra). "Mungesa e botimeve në gjuhën shqipe – arsyeton ai -, si edhe të mos pasurit sot në dorët t'ënë kujtime dhe shënime të shkruarë nga ajo kohë – si edhe akoma fakti që Shqipëria atëhere ishte e vizituarë dhe e vizituarshme prej të huajvet – na bëjnë të mos kemi sot në duart t'ona lëndën e plotë për rikonstituimin e atyre ngjarjeve. Për çdo studim historik mbi këtë pikë jemi pra të shtrënguarë të bazohemi mbi kujtimet personale dhe mbi të paka ndihma që na japin do botime fort të kufizuarë"[37]. Ai u qe drejtuar prej kohësh personaliteteve të njohura që kishin qenë pjesëmarrës aktivë të Lidhjes. Letra drejtuar At Gjergj Fishtës më 25 tetor, 1922 sugjeron madje krijimin e një shoqërie për mbledhjen e dokumenteve: "ju lutem me përkrah formimin e asaj shoqërie për të mbledhur dokumentet relatife mbi historien e Lidhjes së Prizrenit, zotëria jote me atë aktivitet dhe zotësi që të karakterizon mund me i ndihmue fort shum kësaj çështjeje [...] I juaji M. Frashëri." [38]

I vetëdijshëm se këto dëshmi do të ishin vendimtare për fatin e shkrimit të historisë së kësaj epoke ai, veç kujtimeve personale që ofron në faqet e *Diturisë*, u bën thirrje për mbledhjen e dëshmive të natyrave të ndryshme pa humbur më kohë të çmuar: "të përpiqemi me ngutësi të mbledhim kujtimet e atyreve që kanë arrië ato kohë (1878-1882) dhe që akoma gjendenë gjallë. Këta njerës janë fort të rallë, dhe çdo ditë po bëhen akoma më të pakë. Çdo kujtim i tyre relatif me ngjarjet e asaj periode do të pritetë me kënaqësi dhe mirënjohje të madhe. Letratë, shënimetë, copë gazeta të vjetra, gravura dhe estampate, fotografi dhe portrete, të drejtohen n'adresë të *Diturisë*"- shënon ai në footnotën e shkrimit "Lidhja e Prizrenit", në të cilën shpreh edhe hidhërimin për humbjen e "disa dorëshkrimeve të Abdyl Frashërit mbi gjithë ngjarjet e Lidhjes' së Prizrenit" të cilat ai vetë i kish humbur gjatë luftës[39].

34. SKENDO, Lumo, "Shoqëri e Stambollit", *Diturija*, Tiranë, 1927, Nr. 2
35. SKENDO, Lumo, "Luftët e Çesarit dhe Pompe në Shqipëri", *Diturija*, Tiranë, 1927, Nr. 4
36. SKENDO, Lumo, "Problemet e Shqipërisë Indipendente", *Diturija*, Tiranë, 1928, Nr. 6 -8
37. SKENDO, Lumo, "Lidhja e Prizrenit", *Diturija*, Tiranë 1928, Nr. 9,10,11, f. 321
38. Cituar sipas NURO, Kujtim, "Ndihmesa e Mithat Frashërit në lëmin e arkivistikës dhe të bibliotekës", *Studime Historike*, 1995, Nr. 1-4, botim i Institutit të Historisë, ASHR, Tiranë, 1997, f. 84; referuar AQSH, Fondi 35, viti 1922, dos. 138, fl. 59
39. SKENDO, Lumo, "Lidhja e Prizrenit", *Diturija*, Tiranë 1928, Nr. 9,10,11, f. 321

Kjo thirrje (gati në dëshpërim) përmbyll edhe dëshminë e tij të fundit në faqet e *Diturisë* me titull "Javët e fundit të sundimit tyrk në Shqipëri", teksa pohon se vetëm shënimet e tij nuk mjaftonin dhe se ende "kujtime, botime na mungojnë. Do të kenë kurajon, prej atyre që njohin gjë dhe që akoma janë gjallë, të flasin, të na kallzojnë të vërtetën, apo Shqiptari do të jetë kurdoherë i pushuarë, i heshturë bash atëherë kur të folët e tij munt të hyjnë në punë, munt të bëjë një shërbim atyre të brezit të arthmë?"[40] – pyet për herë të fundit Lumo Skëndo në revistën që pati për mision dijen albanologjike, gjuhësore, historike, antropologjike etj., akumulimin dhe qarkullimin e saj përmes parimit të *dijes në shërbim të kombit*, dije që ai e mblodhi dhe dhuroi bujarisht në revistën e tij unike për botën kulturore shqiptare.

Ndërsa kontributi i tij në pasurimin e veprës bibliografike të Emil Legrandit, përmes rubrikës "Shtim në radhonj të Emile Legrandit" e plotësoi numrin prej 724 titujt librash të kataloguar prej dijetarit francez (deri në vitin 1900) me rreth 100 botime të tjera të rëndësishme që ai i shtoi në botimin e *Diturisë* në Tiranë (1926-1929). Sidoqoftë, qysh më parë, konkretisht te *Diturija* e vitit 1916, ai e ka parashtruar mundësinë e pasurimit të kësaj bibliografie tejet të rëndësishme me titujt të rinj, të panjohur nga bibliografi francez. Me saktësinë shembullore të bibliografit, ai sjell në footnotë faktin se titujt e shtuar jo vetëm ishin parë e punuar prej tij por edhe se shpesh ato gjendeshin në bibliotekën tashmë legjendare "Lumo Skëndo".

Kjo bibliotekë personale, e ushqyer edhe nga libraria po me këtë emër, do të shërbejë jo vetëm për ndërtimin e një prej koleksioneve më të pasura albanologjike në Shqipëri e Ballkan, që ai ia dhuron plot shpresë "Institutit të Albanologjisë", objekt dëshire i testamentit[41] të tij, por do të shërbejë bujarisht në formimin e shumë intelektualëve të rinj që gjenin te pronari i saj bibliotekarin *par excellence*. Studiuesi Kujtim Nuro na sjell faktin interesant se libraria e tij e pasur furnizonte me libra edhe Bibliotekën Kombëtare: "në vitet 1929-1930 Biblioteka mori prej saj 1127 libra"[42] – njofton ai.

---

40. SKENDO, Lumo, "Javët e fundit të sundimit tyrk në Shqipëri", *Diturija*, Tiranë, 1929, Nr. 3 f. 84

41. Pika 1: "Ç'kam pasuri të tundshme ose të patundshme, libra, mobila, karta, plaçka etj, i lë për krijimin e një "INSTITUTI ALBANOLOGJIE" që të jetë një qendër e studimeve shqiptare, të mbrojë, të zhvillojë, të qendërsojë dhe të udhëheqë studimet që përkasin Shqipërinë dhe shqiptarëvet." dhe Pika 2: "Dua që nga biblioteka ime private të mos çkëputet gjë; të gjitha librat të rrinë tok.", SKENDO, Lumo, "Testament", cituar sipas "Mid'had Frashëri - *Vepra të zgjedhura 1*", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo", Tiranë, 2017, f. 636, referuar AQSH, F.35, d.41: Testamenti i Mid'hat Frashërit, Tiranë 1929

42. NURO, Kujtim, "Ndihmesa e Mithat Frashërit në lëmin e arkivistikës dhe të bibliotekës", *Studime Historike*, 1995, Nr. 1-4, botim i Institutit të Historisë, ASHR, Tiranë, 1997, f. 86; referuar AQSH, Fondi 54, viti 1930, dos. 4, fl. 6

E ndonëse zotëruesi i një biblioteke të rrallë, ai ëndërronte për një "bibliotekë të vërtetë". Ideja e tij për Bibliotekën ideale do të duhet të na lejojë sot të përfytyrojmë, krahas dëshmive të bashkëkohësve, frymën e jetës së asaj reales, themeluar prej tij. Për Lumo Skëndon biblioteka duhej të ishte "një gjë e gjallë, që rron, që do ushqyer, që do shikuar [...] Të jet e zonja, duke i tërhequr miqt e studimit, të zgjojë merakun e tyre, t'i udhëheqnjë, t'i shtyjë në studim. T'u jetë e dobishme dhe këshilltare, dhe, e gjallë vetë, të muntnjë të komunikojë këtë gjallëri edhe atyreve që e frekventojnë."[43] Disa vjet mbas mbylljes së revistës, ai do të vijojë të këmbëngulë me përkufizimin ideal por edhe me domosdoshmërinë e themelimit dhe zhvillimit të bibliotekave në të mirë të formimit intelektual dhe kërkimit shkencor albanologjik[44]. Pa "bibliotekën e vërtetë" formimi i elitave mbetet mision i pamundur.

Biblioteka dhe libraria "Lumo Skëndo" u bënë pjesë thelbësore e revistës *Diturija* jo vetëm përmes informacionit libror sistematik që përcillnin rubrikat e saj, por edhe si hapësirë alternative e promovimit të kulturës së librit, të koleksionimit, të dokumentimit. Me bindjen se elitat formohen doemos përmes librit, ai e shndërroi edhe librarinë në pikëtakimin intelektual, në vend formimi, informimi dhe ekspozimi, ku spikatën ekspozitat për botimet e Kristoforidhit dhe librave të hershëm shqip, për antikuaret mbi Skënderbeun etj. Kështu për shembull, redaksia e *Diturisë* u drejtohet "këndonjësve" se: "me rastin e fillimit të volumit të tretë të saj, Diturija do të organizojë në Librarit Lumo Skëndo, një ekspozitë, 10-14 dhjetor 1927, të libravet shqip të vjetra, për ato që janë botuar më parë motit 1897"[45]; apo i grish që "me rasjen e festës së Shën Gjergjit revista *Diturija* do të organizojë, më 23 të prillit, një ekspozitë për Skënderbenë, me libra të botuarë mbi heronë t'ënë, estampa dhe figura" duke bërë të ditur njëkohësisht

43. SKENDO, Lumo, "Për historin e Shqipërisë", *Përpjekja shqiptare*, Nr. 4-5-6, Tiranë 1937, f. 230

44. "Bibliotekat me materialin e tyre, dhe më tepr' akoma me ekspozitat e tyre në vitrinat, munt të bëhen një prej veprimtarët me aktif për të zgjuar merakun dhe dashurin' e vëndit, për të frymëzuar një respekt dhe një adhurim për çdo send që i përket shqiptarizmës, racës, vëndit, së shkuarës dhe së arthmes s' ënë. Më donte shpirti që një bibliotekë e vërtetë (*) të muntte të mbushnjë dhe një shërbim tjatrë, dua të them të bëhetë një katedrë e historia s' ënjë me një seri mësime, me konferenca. Pa dyshim që munt të ftojmë albanologë dhe balkanologë, t' u lutemi të vijnë një a dy muaj në Shqipëri, për të vazhduar kërkimet e tyre, dhe, në kohën e qënëjes së tyre këtu të na japin disa kurse mbi subjektet që na prekin në zëmrë. [...] Një bibliotekë pra e vërtetë (e përsërit këtë fjalë që t' a kuptojmë mirë) jo vetëm të formohet me dashurin e libravet (se ka edhe zyrtarë që jan' armiq të libravet), me amor intelektual, po edhe të jetë për neve si një vatrë mësimesh historike të lartë, për neve që s' kemi veç se shkolla të mesme, për neve që edhe profesorët e këtyre shkollave po presin kohën dhe rasjen të specializohen në lëmën që na intereson.", Po aty

45. "Këndonjësvet", *Diturija*, Nr. 1, Tiranë, 1927, f. 40

se objektet ishin "pronë e drejtorit të Diturisë"[46]; apo njoftimin se "me rasjen e pesëdhjetëvjetorës së Ligës së Prizrenit dhe Shoqëris së Stambollit, Diturija do të organizojë një ekspozitë historike, në të cilën do të dëftehenë dokumente relatifë me të dy lëvizjetë kombiare"[47] etj.

Por le të mos harrojmë se bota e librit është për Lumo Skëndon edhe një botë miqësie e mirësie, e ngjashme me një limb të qetë e të ngadalshëm në gjirin e zhurmës e të nxitimit. Ndaj krijuesi i saj e përshkroi "përpara kopshtit të voglë, pranë xhamisë dhe tyrbesë, në rrugën e qetë, nga e cila nuk shkonte njeri, ku çdo tingllim hapi nuk munt të lajmëronte veç se një vizitues"...[48]

Kjo qetësi nuk do të vazhdonte gjatë për Lumo Skëndon e as për librat e tij të dashur. Si fillim, shtrëngesa financiare në botimin e revistës, financimi i së cilës mbështetej kryesisht te pajtimet vjetore, shpie në mbylljen e "vitit IV" të botimit në dhjetor të 1929 me vetëm 3 numra nga 12 të mëparshmit në një vit, me një vëllim të përgjithshëm prej rreth 120 faqesh, krahasuar me rreth 400 faqe të secilit prej dy Volumeve të mëparshme. Në shënimin autorial të datës 4 dhjetor 1929, me titull "Këndonjësvet", Lumo Skëndo sqaron se shkaqet e parregullsisë dhe vonesës ishin të natyrës materiale, si pasojë e rënies së numrit të "pajtimtarëve" të cilët për këtë vit ishin vetëm 52, me specifikimin se prej tyre "36 brënda në Shqipëri, 16 jashtë Shqipërisë (më të shumtët në Amerikë)". Në parantezë "Për historinë e literaturës sonë, kur të bëhetë një herë histori e saj – vijon ai -, si një dokumentë, dua akoma të shtonj: Për volumin e dytë, motin e parë këtu në Tiranë, "Diturija" ka pasur 700 pajtimtarë; për volumin e tretë 300"[49].

E megjithatë nuk ishte vetëm ana fianciare që vështirësonte tashmë vijimin e punës për botimin e *Diturisë*. Lumo Skëndo është i vetëdijshëm dhe fjalitë përmbyllëse të shënimit të tij tingëllojnë aq sa një thirrje po aq edhe si një qortim: "Kam uzdajë se miqt e mij kuptojnë që botimi i një reviste, dhe sidomos i një së përkohshmeje kombiare si jona, nuk është një interprizë fjeshtë tregtare. Për neve kjo është një gjë intelektuale, kulturale, patriotike. Në qoftë, me këtë mënyrë se kemi nevojë për pajtimin dhe ndihmën monetare të miqve t'ënë, kemi edhe më tepër akoma nevojë për ndihmën dhe bashkëpunimin moral dhe intelektual të tyre. Kjo ndihmë e fundit do të na jetë fort më e vlefshme se nga e para, më e dobishme për punimin t'ënë."[50]

---

46. "Grishje", *Diturija*, Nr. 6, Tiranë, 1928
47. "Grishje", *Diturija*, Nr. 9-10-11, Tiranë, 1928
48. SKENDO, Lumo, "Kujtimet e një librari", *Minerva*, Viti I, Nr. 12-13, Tiranë, 1933, f. 31
49. SKENDO, Lumo, shënim në rubrikën "Këndonjësit" që mban datën 4 dhjetor 1929, botuar në *Diturija*, Nr.3, 1929
50. Po aty

Nëse *Diturija* u mbyll në fund të vitit 1929 për arsye sa materiale aq edhe bashkëpunimi intelektual të munguar, libraria dhe biblioteka do të jetojnë me pasojat e luftës qysh me zhvillimet e Luftës II Botërore, kohë kur Lumo Skëndo, Mid'hat Frashëri, e kuptoi se nuk mund të jetonte më vetëm me librat e për librat e tij. Atdheu e kërkonte sërish, ashtu siç kish ndodhur më 28 nëntor të 1912 kur ai përfaqësonte Gjakovën, Pejën, Plavën e Gucinë, Elbasanin e Përmetin në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe firmoste aktin e Shpalljes së Pavarësisë! Mbas përfshirjes aktive në luftën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit e saj, Ministria e Arsimit më 1943, duke ditur e çmuar vlerën e thesarit të bibliotekës "Lumo Skëndo", e mori atë nën kujdestari me qëllimin që të mos dëmtohej e humbiste asgjë prej asaj pasurie me peshë kombëtare[51]. Ndërsa pushteti komunist sekuestroi bibliotekën dhe librarinë duke i vendosur librat në Bibliotekën Kombëtare. Ende sot është e vështirë të dilet me një shifër të saktë të numrit të librave që u depozituan në këtë institucion. Por, pa asnjë mëdyshje, ata vijojnë të jenë pjesa më e rëndësishme e madje krenaria e fondit antikuar albano-balkanologjik të tij. Ndër ta shkëlqen *incunabula* e Papa Piut II "De Conventv Mantvano" e vitit 1473, në epistolat e të cilit përmendet qëndresa e Arbërisë dhe e Skënderbeut.

Rikthimi te vepra e Lumo Skëndos, ribotimi i sistemuar e cilësor i saj, janë sot një domosdoshmëri e kulturës dhe jetës sonë intelektuale kombëtare. Përmes tyre vetëdijësohemi së pari për mungesën e madhe që shkaktoi mosleximi i gjatë dhe errësira informative mbi gjithçka që ai krijoi, shkroi e botoi. Në një nga përpjekjet e para të rikthimit te vepra e tij letrare, studiuesi Sabri Hamiti shkruante në Prishtinën e vitit 1995 se "Plotësimi, përkthimi dhe ribotimi i veprës së Midhat Frashërit do të nxjerrë në shesh një dijetar të botës shqiptare që del te kulmet e rendit të vlerave sidomos në historinë e ideve në kulturën tonë. Atëherë del e plotë figura krijuese e intelektuale e tij"[52].

Studimi i veprës së Mid'hat Frashërit është ende në proces. Botimi i saj gjithashtu. Spikasin kontributet themelore të studiuesve Uran Butka e Sabri Hamiti, si dhe botimet e përmbledhjeve specifike nga vepra e tij e me vëzhgime të holla nga Luan Malltezi, Sherif Delvina e Nasho Jorgaqi, që me punën dhe përkushtimin e tyre kanë risjellë për lexuesin e sotëm një pjesë të rëndësishme të pasurisë që na la trashëgim ky personalitet poliedrik.

---

51. NURO, Kujtim, "Ndihmesa e Mithat Frashërit në lëmin e arkivistikës dhe të bibliotekës", *Studime Historike*, 1995, Nr. 1-4, botim i Institutit të Historisë, ASHR, Tiranë, 1997, f. 86

52. HAMITI, Sabri, "Midhat Frashëri (1880-1949)" *Midhat Frashëri*, Vepra, Rilindja, Prishtinë, 1996, f. 42

Çdo botim e ribotim që është ndërmarrë deri më sot, përfshi edhe ribotimin anastatik të *Diturisë*, na rikthen te monumentaliteti i kësaj vepre të jashtëzakonshme, shtrirë në pesë dekadat më të qenësishme të kombit. Ajo merr sot një funksion të dyfishtë: na tregon rrugën për nga shkohet te dija e njëkohësisht rrugën për nga shkohet, përulësisht te autori i saj i lënë në harresë. Ky rikthim te Mit'hat Frashëri është në thelb, përfundimisht, një rikthim i yni te vetja jonë.

Nga ideja e projektit të Mid'hat Frashërit për themelimin e botimin e *Diturisë* kanë kaluar 110 vjet, po aq sa daton tashmë Kongresi i Manastirit, ngjarja më e rëndësishme në zhvillimin modern të shkrimit shqip. Nga vdekja e tij, na ndajnë thuajse 70 vjet. Fjalët naimjane që ai shkroi për ikjen nga jeta të mikut dhe bashkëpunëtorit Kristo Luarasi sot vlejnë po aq fort për të:

Ç'ka të bëjë zhdukja e trupit, në qoftë se ideja rron, kur ajo ide ngjall një mijë shpresa dhe entuziazëm? Dhe bash këto janë jetë e vërtetë.

Dr. Uran Butka

Bashkëpunimi i Lumo Skëndos me Kristo Luarasin për botimin e revistës *Diturija* dhe veprave të tjera të tij

Mid'hat Frashëri dhe Kristo Luarasi janë dy kollosë të Rilindjes dhe Pavarësisë shqiptare.

Çështja shqiptare që kërkonte zgjidhje dhe rreziku i pandarë i saj, i bashkoi këto dy figura madhore në përpjekjen e tyre për liri, dituri, kulturë, ndërgjegjësim kombëtar, indipendencë dhe përparim njerëzor e shtetëror. Të dy iu përveshën kësaj përpjekjeje kombiare, herë larg njëri-tjetrit, por afër idealisht e shpirtërisht, herë bashkë brenda dhe jashtë vendit të tyre, në vështirësi e rreziqe të panumërta, por të pathyer dhe mbrothëtarë.

Në vitin 1896, me nismën e Kristo Luarasit dhe ndihmesën e Shoqatës Patriotike e Kulturore Shqiptare "Dëshira" e Sofjes, e cila ndoqi udhën e Shoqatës të të Shtypurit Shkronja Shqipe të Stambollit, u themelua në Sofje shtypshkronja "Mbrothësia", e para shtypshkronjë shqiptare, që u drejtua nga Kristo Luarasi. Kjo shtypshkronjë luajti një rol të jashtëzakonshëm në botimin e veprave të rilindësve tanë si edhe për mësimin e përhapjen e gjuhës e të literaturës shqipe nëpër shkollat, klubet, shoqëritë dhe individët shqiptarë, brenda e jashtë Shqipërisë. Ajo botoi dhe shpërndau mbi 115 tituj librash, revistash, gazetash, kalendarësh, 10.000 abetare etj., duke u bërë kështu shpirti i lëvizjes sonë kulturore dhe kombëtare.

Në vitin 1897 doli në dritë numri i parë i *Kalendarit Kombiar* (Ditërrëfenjësi Kombiar), me botues Kristo P. Luarasi dhe Kostë J. Trebicka, më pas me botues të vetëm Kristo Luarasin. Kjo enciklopedi e jetës, historisë dhe kulturës shqiptare, vijoi deri në motin 1928, me ndonjë ndërprerje. Ishte një botim tejet cilësor, nga përmbajtja dhe forma, i ilustruar dhe i përdorshëm si libër xhepi, një nga botimet më të mira shqiptare nga pikëpamja bibliofilike.

Mid'hat Frashëri rrëfen për mbresat dhe shpresat që zgjoi botimi i *Kalendarit Kombiar* dhe i veprave të tjera të rilindësve, të botuara nga Kristo Luarasi: "Një mbrëmje, duke u kthyer në shtëpi me vapor, Sami Frashëri më rrëfeu se kishte parë te Naimi një libër të ri, që rrëfente ditët e muajt, artikuj dhe vjersha, një botim shqip i shtypur në Sofie të Bullgarisë. Një libër shqip i ri?! Për ne, për shqiptarët e asaj kohe, ishte një ngjarje pa shembull, një eveniment shpirtëror, shoqëror dhe politik. Pastaj, për ne ishte habi e re e një qyteti të ri, ku botohej një libër shqip i ri... Që nga dalja e atij kalendari, që nga ai mot, them, filloi jeta aktive e qendrës së Sofjes, ku përqendroheshin gjithë shpresat, gjithë aspiratat e Shqiptarëve dhe aq më tepër pas mërgimit të Jani Vretos, shoqëri e Bukureshtit bije në apati të agonisë edhe çdo mot, disa herë në mot, me duart e tij Kristoja përgatit bukën e shpirtit dhe të mendjes, gjellën e dritës, në formë librash të vogla, në formë zëdhëniesh, në formë grishimesh, se në atë periudhë, çdo e shtypur me "abece"-në, makar edhe një fletë sa pëllëmba, dukej një gjë me rëndësi fort të madhe, duhet të mbajnë mend akoma entuziazmin e atyre viteve, moshë dashurie mistike, e qendërzuar në një ideal. Jam i sigurt se edhe sot akoma në kujtim të atyre ditëve të ndritshme zemra e tyre u rreh në kraharor dhe sytë u gjejnë shkëlqimin e njëzet vjetëve. Ç'gëzim, ç'shpresa, ç'ekstazë, kur duart preknin të shtypurën e re, "Fletoren e bektashinjve", "biblën" e ardhur në mënyrë misterioze. Ah, duhet të ketë pasur fatin e rrallë dhe të lartë të një dashnori adhurimtar, që të mund të kuptojë gëzimin e ndjerë në ato kohë".[1]

Djaloshi gjenial, atëherë 18-vjeçar, Lumo Skendo u bë bashkëpunëtori i ngushtë i Kristo Luarasit dhe mendja e shpirti i *Kalendarit Kombiar*, me shkrime të karakterit diturak, etiko-moral, patriotik, historik, politik, social, ekonomik, shkencor, letrar etj. Ai shkruan: "Dymbëdhjetë vjet me radhë, nga moti 1897 gjer më 1908, Kristoja përhapi fjalën e drejtë, mbolli farën e mirë, jo vetëm në Shqipëri, po tekdo që gjendej një Shqiptar, në gjithë qytetet e së gjerës Perandori Otomane, në vise të largëta të dy Amerikave, gjer në çipat e ngrirë të Siberisë e në shkretinat e përvëluara të Afrikës. Edhe ky punim bëhej me një durim plot fisnikëri, me një ide plot çinteresim, me një ëmbëlsi karakteri të rrallë. I theksoj

1. SKENDO, Lumo, *Vepra të zgjedhura 1*", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo", Tiranë, 2017

këto cilësi të rralla të Kristos, se më duket që askush nuk e ka njohur atë më mirë nga unë. Korrespondenca ime, sikur të gjendej do t'ishte një provë për karakterin e tij të mirë. Ata të dymbëdhjetë vitet e parë formojnë epopenë më të bukur të punës dhe të punimit të tij. Dhe, në qoftë se mirësia m'e madhe në jetë është t'i japësh tjetrit kënaqësi, gëzim dhe kandje, padyshim që Kristoja duhet të shikohet si një mirëbërës fort i madh, një mirëbërës për mijëra dhe mijëra lëçitës të librave dhe gazetave, që dilnin nga duart e Kristos, një mirëbërës më i vlefshëm akoma për bashkëpunëtorët e tij".

"E gjithë vepra e jetës së Lumo Skëndos rreket të përmbushë këtë mision të dijes, të shpjerë tek përgjigjet e të shtrojë pyetje të reja", - thekson studiuesja Persida Asllani. "Shqiptarit aq sa i duhet buka, i duhet diturija dhe nacionalizma. Për të rrojtur si komb, duhet të luftojmë për t'u bërë e për t'u njohur si komb"- shkruan Lumo Skëndo më 1899 te *Kalendari Kombiar*, vepra që mori gjithnjë e më shumë gjatë viteve fizionominë e penës dhe dijes së tij. Me një frymë naimjane, misionin e *Ditërrëfenjësit* do ta përshkruante gjithnjë si "kujdesje për të ndriçuar udhën", si përpjekje për të ndezur, së bashku me Kristo Luarasin e miq të tjerë, "një qiri të vogël, një dritë" dhe të ftonin "shqiptarët të mblidheshin përqark".[2]

Kalendari Kombiar i lidhi edhe me ngushtë këta dishepuj të dijes, kulturës dhe kombit në punën e tyre titanike në shërbim të çështjes shqiptare. "Mora *Kalendarin kombiar*, që zotnia jote ma çoi. Pas disa vjetësh pata gëzimin të këndonja përsëri të bukurin kalendar, i cili i ka dhënë dritën e mendjes kombit shqiptar" i shkruante Gaetano Pettrota Lumo Skëndos.[3]

Më 14 korrik 1908, Lumo Skëndo nisi botimin e gazetës *Lirija*, fillimisht në Sofje, mandej në Selanik, te shtypshkronja "Mbrothësia" e Kristo Luarasit. Krahas saj, Lumo Skëndo botoi në këtë shtypshkronjë libra shkollorë për nxënësit e shkollave dhe për lexuesit shqiptarë si *Këndimet*, *Dhetregonjë* (gjeografi, biologji, darvinizëm), metodat e gjuhës angleze dhe frenge, përkthime nga gjuhët e Perëndimit, si: *Bëje të mirën pa hidhe në det* të Hofmanit nga gjermanishtja, *Robinson* të Defoe-së nga frëngjishtja, *Shkurtabiqi i verdhë*, *Miu i vockël*, *Sorkadhja e bardhë* nga anglishtja, si edhe *Vilhelm Teli* të Lamartinit, duke rrëfyer kështu shpirtin liridashës të tij dhe grishjen, që shqiptarët të luftonin për lirinë. "Lirija, shkruante ai, është një mjet, është një derë nga e cila hyjmë në fushë të gjerë të përparimit e të qytetërimit".[4]

2. ASLLANI, Persida, "Diturija e Lumo Skëndos, shkëlqimi i një gostie', parathënie e botimit anastatik të revistës "Diturija", Tiranë, 2018

3. AQSH F.35 korespondenca, leter e Pettrotës dt. 17.01.1925

4. SKENDO, Lumo, *Vepra të zgjedhura 1*", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo",

Më 1 janar të vitit 1909, Lumo Skëndo nisi botimin e revistës kulturore *Diturija* në shtypshkronjën "Mbrothësia" në Selanik, e cila vijoi të shtypej në Bukuresht më 1916 dhe në Tiranë më 1926-1929. "Programi dhe qëllimi ynë është që ta bëjmë një revistë të dobishme, pak a shumë për të gjithë këndonjësit, për nxënësit, studentët, mësonjësit, si edhe për amatorët e këndimit dhe të nxanit, të japim një landë të këndshme për një ushqim moral për çdo intelektual", - kumtonte Lumo Skëndo për zotimet e revistës "Diturija".[5]

Kjo revistë, përveç *të nxanit e diturisë si një ushqim mentar e shpirtëror*, u kthye edhe në një tribunë e hulumtimeve studimeve shkencore, kryesisht gjuhësore, historike, kulturore dhe letrare, në një dëshmi të fuqishme të identitetit kulturor të shqiptarëve, por edhe në një mjet informimi publik për ngjarjet, personalitetet shqiptare apo të huaja, botimet etj.

Revista *Diturija* është një monument i kulturës sonë për të gjitha kohërat. Albanologu Norbert Jokl e vlerësonte atë. Në një letër që i dërgonte Lumo Skëndos nga Vjena, më 22 qershor 1926, e falenderonte për letrat që i ka dërguar, sidomos për *Kalendarin Kombiar* dhe *Diturin*ë: "Për me jua dëftye interesin që kam për sigurimin e të përkohëshmes *Diturija* shtoj sot pajtimin për një mot".[6] Joklit i interesonin studimet e Mid'hat Frashërit në fushë të shqipes, të cilat ai i boton në organe shkencore të Europës. "Përmbajtja e numrit 1 të Motit të Ri më ka interesue fort e fort, për shembull artikulli i parë "Për shkrime të harruarë" asht me randësi edhe për gjuhësinë e për atë shkak kam qëllim me botue një shkurtim të këtij artikulli te "Indogermanischer Jahrbuch" në Berlin.

Në një letër tjetër të Joklit drejtuar Lumo Skëndos më 1928, lexojmë vlerësimin e tij për Lumo Skëndon si shkencëtar: "Puna shkencëtore e lyp një përpjekje të pandame; shpërblimi i përjashtëm asht natyrisht i vockërr, por më imadh asht pëlqimi i punëtorit tue lexue fjalë të miratimit prej pendës së një përfaqësuesi në za të literaturës shqipe". [7]

Po ashtu, albanologu i shquar Gjerg Pekmezi, që e merrte rregullisht revistën *Diturija*, shkruante: "Pa dyshim *Diturija* është sot për sot, mjerisht, e vetmja gjë për mua, që shndrit në qiellin e diturisë së vrazhdtë të Shqipërisë.[8]

Tiranë, 2017

5. Revista "Diturija" nr.1 viti 1909

6. SKENDO, Lumo, *Vepra të zgjedhura 1*", letër e N. Joklit 1926

7. Letër e N. Jokli drejtuar Lumo Skëndos, 1928

8. SKENDO, Lumo, *Vepra të zgjedhura 1*"

Rol të madh në botimin dhe shpërndarjen e *Diturisë*, por edhe të veprave të tjera të Lumo Skëndos luajti Kristo Luarasi. Në gazetën *Liri e Shqipërisë* (1911-1915), një nga gazetat më të mira të shtypit shqiptar, botuar në Sofje, në të cilën Kristo Luarasi ishte edhe botues, edhe kryeredaktor, edhe editor, edhe publicist, edhe faqosës, edhe shpërndarës në të gjithë hapësirën shqiptare, Mid'hat Frashëri ka botuar gati në çdo numër me pseudonimin "Adriatiku" një sërë artikujsh të thukët problemorë për çështjen dhe kulturën shqiptare.

Në një letër drejtuar Kristo Luarasit në Sofje nga Vlora, më 10 dhjetor 1912, Mid'hat Frashëri përshkruante ngjarjet madhore të shpalljes së pavarësisë dhe të formimit të qeverisë së parë shqiptare. "Kongresi u çel më 28 të këtij muaji dhe ishim 47 delegatë nga çdo anë e Shqipërisë, vise të shkelura dhe të pashkelura. Sot janë 67, se kanë ardhur edhe nga vende të tjera. Atë ditë, pra më 28 nëntor, ora 11.30 allaturka (dy e tridhjetë allafrënga), me zë të përgjithshëm u proklamua Indipendenca e Shqipërisë dhe Flamuri u çel në portë të shtëpisë ku ishim mbledhur (shtëpi e Xhemil Beut).[9] Firmëtari i Pavarësisë, mëton që indipendencës t'i bashkohej etnia shqiptare, liria dhe demokracia".

Vitet 1915-1916 kanë qenë vitet e bashkëpunimit intensiv dhe tejet të frytshëm ndërmjet dy bashkudhëtarëve në Sofje dhe Bukuresht. Ajo që sendërtonte punën e tyre të përbashkët ishte shtypshkronja "Mbrothësia". Kështu doli në dritë libri i parë "Letra mbi një udhëtim në Zvicër", ku Lumo Skëndo jepte modelin, ashtu si ungji i tij, Sami Frashëri te *Shqipërija ç'ka qenë, ç"është dhe ç'do të bëhëtë* (botuar edhe kjo vepër në shtypshkronjën "Mbrothësia" të Kristo Luarasit"), sesi duhet të bëhej Shqipëria në të ardhmen.

Mid'hat Frashëri i përvishet punës, me ndihmesën e çmuar të Kristo Luarasit, për të botuar disa nga veprat e tij kryesore. Në librin me skica poetike, novela dhe kujtime *Hi dhe shpuzë*, botuar në Sofje në fillim të vitit 1915, Mid'hati mbledh krijimet letrare spontane, të pabotuara (dorëshkrim) dhe të botuara kryesisht te *Kalendari Kombiar*. "Këto gjërat e vogëla, që po i jap sot këndonjësit, nuk janë të reja. Shumë prej tyre janë botuar në *Kalendarin Kombiar* dhe të tjerat flinin gjysmë të harruara në mes të kartravet. Të mos ishte këshilla e disa miqve indulgjentë, padyshim që të gjitha do të mbeteshin varrosur, të harruara mbase dhe prej meje vetë, si çdo gjë që e than dhe vdjer koha, si gjithë këto gjurmë që i prish dhe i shuan moti..."

Ishte fjala edhe për mikun e tij të ngushtë, Kristo Luarasi.

Po në shtypshkronjën "Mbrothësia" të Kristo Luarasit dhe nën kujdesin e tij u botuan librat e tjerë të Lumo Skëndos, si: *Popullsia e Epirit* (Sofje 1915)

9. AQSH, Fondi 35Dosja 138

dhe *Pritmi i Shqipërisë* (Sofje. 1915). Në esenë *Popullsia e Epirit* ai i kundërvihet politikës ultranacionaliste të qarqeve të caktuara greke, të cilat identifikojnë qëllimisht kombësinë me fenë, për të justifikuar hipotezën absurde se të gjithë të krishterët e Shqipërisë janë grekë dhe se ku ka edhe ndonjë të tillë, është Greqi, si edhe pretendimet territoriale të tyre të mbështetura në këtë propagandë.

Tek *Pritmi i Shqipërisë* zbulon përpara lexuesit, veç të tjerash, resurset e mëdha njerëzore e natyrore të Shqipërisë, që, të bashkuara me ndërgjegjësimin e vullnetin e çdo shqiptari për të punuar, me shpresën e bekuar për të pritmin, do të sjellin përparimin e mirësimin e shqiptarëve e Shqipërisë. "Përparimi i një kombi varetë nga përmirësimi e naltësimi i çdo njeriu që e formon këtë komb", - shkruante Mid'hat Frashëri. Ringjalljen morale dhe ekonomike të shqiptarit ai e kushtëzon me vullnetin për punë, me punën e pareshtur, që pjell shpresën, që bie çdo të mirë, që zbukuron, lartëson e fuqizon atdheun dhe, si rrjedhojë, zbukuron, lartëson e pasuron shqiptarin. Mid'hati vëren me dhimbje të madhe mungesën e dëshirës për punë te shqiptari, të edukatës së punës – trashëguar nga periudha e sundimit osman dhe shpjegon dëmet që i ka sjellë dhe i sjell njeriut dhe vendit: "Puna pjell shpresën, dijen, përparimin, mirëshkuarjen, paqen, gëzimin, lumturinë, shmang përtacinë, vanitetin, smirën, varfërinë, mizerien, vjedhjen, trazimet, luftërat, puna është jeta e njeriut dhe e një kombi"[10] – na mëson Mid'hati.

Në këtë kohë Shqipëria ende ishte e pushtuar nga ushtritë e dy blloqeve ndërluftuese. Në mbarim të luftës fituesit do të ndanin trofetë. Përsëri Shqipëria do të vihej përpara gjykatores së madhe si në vitin 1913 dhe mund të humbiste pjesë të tjera nga trupi i saj, ose mund të zhbëhej fare. Prandaj Mid'hat Frashëri dhe Kristo Luarasi menduan që të botojnë një gazetë në gjuhën frënge, nëpërmjet të cilës t'i bëhej e njohur opinionit publik europian, si edhe Fuqive të Mëdha, e vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët, si dhe rrezikun që mund të sillnin për Shqipërinë e Ballkanin rivalitetet e Fuqive të Mëdha dhe synimet shoviniste të Italisë, Greqisë dhe Serbisë fqinje. Në bashkëpunim me shqiptarët patriotë të Sofjes u krijua një komitet (Këshill botues) nën drejtimin e Kristo Luarasit për botimin e gazetës *L'independance Albanaise*, me kryeredaktor Mid'hat Frashërin. Por pati dhe zëra kundërshtarë. Themistokli Gërmenji dhe Kristo Dako u shprehën publikisht kundër botimit të kësaj gazete në gjuhën frënge me këtë argument kryesor: "Nuk është koha sot dhe s'ka nevojë t'u tregojmë europianëve të këqiat që na kanë bërë armiqtë e huaj në Shqipëri, se ata e dinë më mirë nga ne dhe koha kur duheshin treguar, ishte atëherë kur u bënë..."[11]

10. SKENDO, Lumo, *Pritmi i Shqipërisë*, Shtypshkronja "Mbrothësia", Sofje 1915
11. *L'independence Albanaise*, 1915

Nikollë Stathi, në librin e tij "Zotërinjtë Kristo Luarasi dhe Mid'hat Frashëri" shkruante po ato ditë, bën sqarime për këtë incident të hidhur dhe qorton z. Germenji e Dako për akuza të pathemelta deleguar Kristo Luarasit dhe Mid'hat Frashërit. Ai rrëzon një nga një me fakte të gjitha akuzat që bëhen nga motive thjesht personale, meqënëse z. Luarasi e Frashëri as që denjojnë t'u përgjigjen atyre. Vetëm me insistimin e N. Stathit, Kristoja, tek punonte në shtypshkronjë "me duart e nxira nga mellani i shkronjave" e qartëson të interesuarin: "Kur erdhi Dakoja me Themistokliun, i prita, i mora për darkë si miq i pandehja. Sa më erdhi në dorë, bëra detyrën e miqësisë dhe të mëmëdhetarisë. Po ata, që në krye folën kështu: "Hiq dorë nga Mid'hat Frashëri se ai është egoist, nuk shkon mirë me njeri, kërkon që të bëhet e tij dhe s'pëlqen njeri". Unë u thashë: "Përkundrazi, Mid'hatin se di të ketë fare egoizmë, me gjithë botën shkon mirë dhe me sjellje të ëmbël. Kam afro njëzet vjet që e njoh dhe ai po shkruan, unë po i shtyp artikujt e tij". Kur nisëm gazetën frëngjisht, atëherë smira e Dakos dhe e Themistokliut zuri të dalë në shesh duke thënë se tani s'na duhej gazetë. Letra e parë e tyre qe kundër meje dhe letra e dytë kundër z.Mid'hat. Kjo sjellje më çudit se është një paturpësi. Po ata nuk u skuqën ku i çuan letrat e hapura të tyre edhe në gazeta të huaja".[12] - Këto janë fjalët e sinqerta të botuesit Kristo Luarasi.

Gazeta *L'Independance Albanaise*, ishte një nga të parat gazeta shqiptare në gjuhë të huaj që u mbajt me sakrifica nga Mid'hat Frashëri dhe Kristo Luarasi. Gazeta kishte një format mesatar, ishte e faqosur dhe e shtypur bukur si një revistë perëndimore. Merita për këto i takonte botuesit Kristo Luarasi. Mid'hati shkruante edhe editorialet, analizat, artikujt problemorë, ndërsa lajmet, komentet, korrespondencat i punonte Kristoja. Shkrimet e bashkëpunëtorëve Mid'hati i përkthente po vetë në gjuhën frënge. Gazeta zgjoi interes të madh dhe kërkohej jo vetëm në Sofje, por në të gjitha kryeqendrat e Evropës, sepse përveç informacionit, trajtonte me nivel të lartë profesional e kulturë çështje me interes ballkanik, evropian dhe ndërkombëtar.

Epilogu i shkëlqyer i bashkëpunimit Frashëri-Luarasi është ai i viteve 1926-1934, pasi Kristo Larasi u kthye në vitin 1921 në Tiranë me gjithë shtypshkronjën e tij "Mbrothësia" dhe u vu në shërbim të kulturës e botimeve të periudhës së Pavarësisë pas Kongresit të Lushnjës, dhe pasi Mid'hati u kthye nga Greqia, ku ishte për disa vjet ambasador i Shqipërisë në Greqi. Ata rifilluan botimin e ndërprerë të *Kalendarit Kombiar* dhe të revistës kulturore *Diturija*, në të cilat

12. STATHI, Nikollë, "Zotërinjtë Mid'hat Frashëri dhe Kristo Luarasi", Sofje 1915

tashmë bashkëpunuan penat më të mira të intelektualëve të vendit, por edhe albanalogë të huaj, si: N. Borgia, G. Weigand, N. Jokli, M. Shuflaj, H. Pedersen etj.

Bashkëpunimi i jashtëzakonshëm i Mid'hat Frashërit me Kristo Luarasin u ndërpre në korrik të vitit 1934, kur botuesi i madh ndërroi jetë në moshën 59 vjeçare, pas një pune të rëndë e të gjatë në vite, gjithë pasion dhe vetësakrificë, në kushte të vështira ekonomike dhe pune, duke "ngrënë me grushte" plumbin e shtypshkronjës, por edhe duke ndier gëzimin e papërshkrueshëm të botimeve të tij dritëdhënëse e ringjallëse për Shqipërinë dhe kombin.

Mid'hat Frashëri e ndjeu më tepër se kushdo tjetër humbjen e tij. Ai shkroi po ato ditë me krenari dhe dhimbje për Kristo Luarasin, që la pas një frymë dhe një vepër të pavdekur:

"Kështu, ata që punuan në ato kohë, kanë më të madhen vleftë për ne, duhet t'i nderojmë më shumë, duhet të respektojmë kujtimin dhe punën e tyre. Këtë detyrë e kemi edhe kundrejt Kristo Luarasit, që është një shembull për ne dhe një fuqi për karakterin tonë"[13]- i drejtohej L. Skëndo brezit të ri.

Ndërsa në nekrologjinë "Kristo Luarasi", shkruante:

"Edhe këtu, se duhet thënë çdo send, dua t'u jap një përgjigje direkte atyre, që i bëjnë një faj Kristos, pse mundi të sigurojë një situatë ekonomike indipendente dhe ja shohin të tepërt atë situatë modeste. Për mua, duhet të na vijë keq, që punimi i gjatë i tij nuk i siguroi dot një situatë edhe më të shkëlqyer akoma, një indipendencë ekonomike edhe më të madhe, aq më tepër që Kristoja në punën e tij patriotike s'ka ndjekur asnjë herë interesin e tij personal dhe s'është kursyer kurrë përpara çdo lidhjeje. Cilësia e tij si një uvrier – se me duart e tij ka radhitur dhe ka punuar, është lëvdata më e madhe që mund të bëjmë për të dhe shembulli më i bukur, që mund t'u japim të tjerëve.

Me këto mendime gjendemi përpara këtij varri. Po një varr nuk mbulon kurdoherë një njeri të vdekur. Shumë herë jeta e vërtetë, rrojtja shpirtërore fillon, kur mbaron fryma. Ç'ka të bëjë zhdukja e trupit, në qoftë se ideja rron, kur ajo ide ngjall një mijë shpresa dhe entuziazëm? Dhe bash këto janë jetë e vërtetë".[14]

Botimi anastatik i revistës *Diturija* nga Biblioteka Kombëtare dhe Instituti "Alsar" është pohimi i sotëm i një vepre monumentale të kulturës shqiptare, por edhe një homazh për krijuesit e saj, Mid'hat Frashërin dhe Kristo Luarasin.

13. SKENDO, Lumo, *Vepra të zgjedhura 3*", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo", Tiranë, 2018

14. Nekrologjia "Kristo Luarasi", 10 korrik 1934 në *Kalendari Kombiar*.

Prof. Assoc. Dr. Mark Marku

Revista *Diturija* në historinë e shtypit dhe shoqërisë shqiptare

Ndryshe nga kulturat dhe letërsitë e tjera evropiane, kultura dhe letërsia shqipe është zhvilluar për një kohë relativisht të gjatë në mungesë të disa institucioneve kulturore si teatri, oborri, salloni letrar, grupet dhe lëvizjet letrare, shkollat dhe universitetet, kritika, kanoni letrar etj. Në kontekstin socio-historik të lindjes së kulturës shqipe një pengesë e tillë është lehtësisht e kuptueshme pasi në rastin shqiptar është letërsia dhe kultura ajo që lind individin dhe kombin shqiptar dhe jo e kundërta.

"Nacionalizmi herë – herë e ka marrë kulturën ekzistuese dhe e ka shndërruar në komb, herë-herë e ka shpikur për këtë qëllim një kulturë, kurse në më të shumtën e rasteve i fshin kulturat ekzistuese"[1]- thotë Ernest Gellner në studimin e tij *Kombet dhe nacionalizmi*. Është e qartë pra se ka një përkim mes fazave të procesit të krijimit të kombit dhe atyre të krijimit të mitit të kombit dhe për këtë arsye elitat kulturore kanë një rol të dorës së parë në krijimin e kombeve.

Nga tri rastet që Gellner-i përmend më sipër, duket se për shqiptarët vlen rasti i dytë, domethënë rasti i shpikjes së një kulture në funksion të krijimit të mitit të kombit. Aty nga fundi i shekullit të 18-të, kur, si për shumicën e

1. GELLNER, Ernest, *Nation and nationalism*, Oxford, 1983, ff. 48-49.

popujve europianë procesi i formimit të shteteve kombëtare doli në plan të parë, panorama kulturore shqiptare ishte shumë dekurajuese. Shqiptarët, qartësisht të identifikueshëm nga pikëpamja etnike në konglomeratin e popujve të përfshirë në Perandorinë Osmane, ishin një popull me identitet të zbehtë kulturor. Gjithëçfarë kjo kulturë kishte arritur të krijonte që nga botimi i *Mesharit* të Buzukut ishin tekstet letraro-biblike të autorëve katolikë të veriut apo ortodoksë të jugut, të autorëve arbëreshë si dhe tekstet e bejtexhinjve.

Këto tekste ishin të pamjaftueshme për të krijuar identitetin kulturor të kombit. Si për ta përmbushur këtë zbrazëti, një elitë e re shfaqet dhe bashkë me të edhe një kulturë e re, kulturë e mbështetur kryesisht tek letërsia. Aty nga fillimi i shekullit të 19-të, shfaqen disa individë dhe grupe të vogla kulturore me njëfarë interesi për rigjallërimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqipe. Mes tyre bënin pjesë klerikë, intelektualë (kryesisht shkrimtarë) dhe përfaqësues të elitës politike otomane me origjinë shqiptare. Kjo elitë e vogël kulturore kombëtare u bë mjaft aktive aty nga fundi i shekullit të 19-të.

Për autorët shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit të 19-të dhe gjysmës së parë të shekullit të njëzetë shkrimi i letërsisë dhe ushtrimi publicistik nuk ka si qëllim parësor krijimin e vlerave estetike apo informimin e shoqërisë, por konceptualizimin monolitik të identitetit kombëtar, i cili na zbulohet nëpërmjet veprave të autorëve më të rëndësishëm që synojnë shpalosjen e një shpirti nacional të përbashkët. Ngjashëm me letërsinë dhe për të njëjtat qëllime, edhe shtypi shqiptar ka devijuar për një kohë të gjatë dhe ndjeshëm prej funksionit të tij parësor, funksionit informues, duke e zëvendësuar këtë me një funksion thelbësisht kulturor, domethënë letrar, domethënë formues, në kuptimin që synon të krijojë kulturalisht bashkësinë shoqërore që u referohen të njëjtave vlera, të njëjtave simbole dhe që i brendashkruhen të njëjtit projekt politik, gjë që vërtetohet edhe me rastin *Diturisë* së Mid'hat Frashërit ribotimin anastatik të së cilës e kemi sot në dorë. Fondacioni "Alsar" dhe Biblioteka Kombëtare që e mundësuan një botim kaq cilësor meritojnë gjithë mirënjohjen dhe përgëzimin për botimin e shkëlqyer që i krijon mundësinë shoqërisë shqiptare ta rijetojë edhe njëherë dukurinë kulturore *Diturija*, akt ky i ngjashëm me restaurimin e një prej institucioneve më të rëndësishme të kulturës, shtypit dhe dijes shqiptare.

Letërsia dhe kultura shqiptare e ka patur për një kohë të gjatë shtypin e shkruar si një instrument të dorës së parë në komunikimin me lexuesin ashtu sikurse shtypi shqiptar e ka patur lëndë të parë letërsinë, madje për një kohë të

gjatë shkrimi publicistik me shkrimin letrar kanë bashkëjetuar njëri me tjetrin.

Edhe me një shikim të thjeshtë nuk mund të mos vihen re përkimet e shumta mes letërsisë dhe shtypit përgjatë gjithë historisë së Shqipërisë nga momenti kur u krijua gazeta e parë shqiptare *L'Albanese d'Italia* në vitin 1848 e deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 1912.

Fakti që themeluesi i organit të parë të shtypit shqiptar është shkrimtari Jeronim De Rada nuk është një rastësi. De Rada dhe lëvizja kulturore e arbëreshëve të Italisë që ai udhëhoqi për gati 50 vjet, ishin përpjekja më e rëndësishme kulturore dhe politike për rilindjen kombëtare të shqiptarëve në gjysmën e parë të shekullit të 19-të.

Nuk është rastësi gjithashtu që dalja e revistës *Drita* në Stamboll në vitin 1883, lidhet me emrat e Naim Frashërit dhe Sami Frashërit, dy prej shkrimtarëve themelues të letërsisë kombëtar dhe të mendimit politik kombëtar. *Drita* (e cila më vonë u botua me emrin *Dituria*), bëhet organ promovues i letërsisë së Rilindjes (kam parasysh këtu faktin se disa prej poezive të Naimit u botuan pikërisht në këtë revistë), por edhe një institucion që zëvendësonte shkollën shqipe, pasi aty botoheshin materiale të tipit didaktik për nxënësit e shkollave.

Nuk është rastësi gjithashtu që themeluesi i *Albanisë* ishte Faik Konica, themeluesi i shkrimit modern dhe i mendimit krtik në letërsinë shqipe. *Albania* e Konicës, u bë për një periudhë kohe institucioni më i rëndësishëm i letërsisë dhe kulturës shqipe. *Albania* si institucion letrar dhe kulturor kishte një vizion global për letërsinë në kuptimin që aty botojnë shkrimtarët më përfaqësues të letërsisë shqipe nga Naim Frashëri, Konica e Fishta e deri tek Lumo Skendo. Ajo e shpreh synimin për t'u shndërruar në instancë kritike qysh me shkrimin "La Litterature Albanaise".

Nëse vazhdojmë në mënyrë kronologjike do të zbulojmë se i njëjti përkim shihet edhe me *Hyllin e Dritës* të drejtuar nga Fishta, edhe me *Diellin* e Nolit edhe me *Kalendarin Kombiar* të Lumo Skendos, edhe me *Përpjekjen Shqiptare* të Merxhanit, edhe me *Ilyrinë*.

Ky përkim tregon së pari atë që thamë më lart se letërsia e përdori për një kohë të gjatë shtypin si një instrument komunikimi të veprës letrare, ndonjëherë edhe si alternativë ndaj librit, madje mund të thuhet se shtypi për shumë kohë e konkurroi librin si mjet komunikimi në kulturën shqipe pasi ishte më i shpejtë në qarkullim, më i lirë nga pikëpamja ekonomike, më masiv dhe për rrjedhim edhe më efikas.

Së dyti: në shumë raste, dukuri kulturore institucionalizohen nëpërmjet shtypit. Kështu, rilindasit e Stambollit institucionalizohen përmes *Dritës*, lëvizja romantike arbëreshe përmes *Fjamurit të Arbërit*, shkrimtarët katolikë të veriut përmes *Hyllit të Dritës* dhe *Lekës*, shkrimtarët e rinj të viteve 30 përmes *Përpjekjes Shqiptare* dhe *Ilyrisë,* shkrimtarët e majtë përmes *Botë së Re* e kështu me radhë. Nëse duam t'i studiojmë këto dukuri natyrisht duhet të studiojmë edhe mënyrën se si është realizuar ky institucionalizim.

Së treti: shkrimi publicistik që ka si qëllimi komunikimin e drejtpërdrejtë dhe shkrimi letrar që ka si qëllim komunikimin përmes figurës kanë bashkëjetuar, ndikuar njëri-tjetrin, madje shpeshherë penguar njëri-tjetrin. Shkrimi gazetaresk e ka penguar për një kohë të gjatë letërsinë që të bëhet letërsi e mirëfilltë ashtu sikurse shkrimi letrar e ka penguar për një kohë të gjatë gazetarinë që të jetë e tillë, pra gazetari. Sidoqoftë ato kanë bashkëjetuar gjatë në kulturën shqipe dhe kjo është një dukuri që përcakton një karakteristikë të letërsisë shqipe.

Së katërti: shtypi ka shërbyer si një paraletërsi ose si një paratekst për të shkuar tek letërsia. Lexuesi shqiptar i letërsisë është krijuar fillimisht nëpërmjet tekstit gazetaresk. Kjo ka përcaktuar shijen e lexuesit dhe kompetencën kodifikuese të tij.

Edhe pse të orientuara deri vonë drejt studimit sociologjik të letërsisë dhe kulturës shqipe (por edhe sot e kësaj dite), studimet tona për letërsinë dhe kulturën e kanë anashkaluar çuditërisht rolin e organeve të shtypit shqiptar në institucionalizimin e letërsisë si djepi i *Volksgeist*-it (shpirtit kombëtar). Një anashkalim i tillë në rastin kulturës shqipe është i dëmshëm pasi për një periudhë të gjatë shtypi është një nga institucionet e rëndësishme të afirmimit dhe të komunikimit të letërsisë dhe kulturës shqipe, për të mos thënë më i rëndësishmi dhe rasti i *Diturisë* është në këtë kuptim më domethënësi.

Dituria nuk është thjesht një revistë, ajo është edhe klub kulturor, edhe bibliotekë kombëtare, edhe akademi, edhe muze i historisë kombëtare e botërore, institucion gjeo-politik dhe imazhologjik, albanologjik.

Diturija e Lumo Skëndos, përbën një dukuri unike në studimin për mediat dhe komunikimin, pasi nga revistat shqiptare është revista më me ndikim në fushën e studimeve imazhologjike. Me kontributin e drejtpërdrejtë të Mid'hat Frashërit në këtë revistë, që me numrin e parë fillon gjurmimi i shkrimeve për

Shqipërinë, shqiptarët, gjuhën dhe kulturën e tyre. Jo rastësisht shkrimi i parë, i numrit të parë të revistës "Istori e ckrimit cqip", fillon me një citim të konsullit austriak George Hahn për gjuhën shqipe. Më pas, në mënyrë sistematike, Mid'hat Frashëri, mbledh, përkthen dhe paraqet për lexuesin shqiptar, një numër të madh tekstesh studimore për Shqipërinë dhe shqiptarët, nga albanologë dhe udhëpërshkrues të huaj, të cilat në thelb përbëjnë një korpus të konsiderueshëm tekstesh imazhologjike. Ky korpus, tregon mënyrën se si shqiptarët janë parë nga të huajt, cili ishte imazhi i tyre përtej botës shqiptare.

Ky interes për më mënyrën se si të tjerët na shohin ne, shoqërohet me përpjekjet sistematike të Mid'hat Frashërit, për t'i ndërgjegjësuar shqiptarët për rëndësinë e asaj që në imazhologji quhet *autoimazh*. Në fakt imazhi i vërtetë i një vendi, kulture apo populli krijohet në një lojë force mes *imazhit* dhe *autoimazhit*. Kjo lojë është një ndërthurje e shumë elementëve kulturorë, ideologjikë dhe sidomos gjeopolitikë. Çdo popull dhe kulturë në mënyrë të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme e ka një strategji të krijimit të imazhit të vet ose të përmirësimit të tij. Për shqiptarët, kjo strategji fillon me autorët e Rilindjes dhe të romantizmit arbëresh. *"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhetë",* është punimi i parë sistematik në këtë fushë. De Rada më parë se ai, nëpërmjet veprës së tij letrare, kishte të njëjtën strategji të krijimit të autoimazhit, porse në ndryshim nga Sami Frashëri, ai e kërkon këtë me mjete letrare. Kjo fazë përkon me një fazë të rëndësishme historike: krijimin e kombit shqiptar. Nëse puna kryesore identifikuese e shqiptarëve deri në periudhën e Rilindjes ishte bërë nga të tjerët, në këtë fazë, me procesin e formimit të kombit, fillon edhe procesi i krijimit të autoimazhit.

I diktuar nga faktorë kryesisht politikë ky proces do të shoqërohet me përpjekjet e të tjerëve për ta mbajtur supremacinë e imazhit mbi autoimazhin. Pika kulmore e kësaj përpjekje është botimi i librit *Shqiptarët dhe fuqitë e mëdha* të historianit serb Vladan Gjerogjeviç në vitin 1913. Nga vetë data e botimit kuptohet cili është qëllimi i tij. Si model teksti imazhologjik ai është model i tekstit të ndërtuar mbi steriotipet negative. Në vitin 1919, Lumo Skëndo, pikërisht para një akti tjetër të rëndësishëm për historinë e shqiptarëve si Konferenca e Paqes që do të rikonfirmonte ekzistencën e shtetit shqiptar, boton një libër[2] si kundërpërgjigje të tij. Botimi i librit të Mid'hat Frashërit shënon edhe fazën e vetëdijësimit për nevojën e krijimit të autoimazhit. Më vonë, në vitet 20-30, kjo do të shndërrohet në një strategji ideologjiko-kulturore dhe shtetërore. Libri i Çabejt *"Për gjenezën e literaturës shqipe",* i botuar si fillim në vitin 1938-1939 tek

2. SKËNDO, Lumo, *Albanais et slaves*, Librairie Centrale des Nationalités, Lausane, 1919

Hylli i Dritës, libri *Raca Shqiptare* e Jakov Milajt i botuar në vitin 1940, apo libri *Të drejtat e Shqipnisë etnik*e botuar në vitin 1943 nga revista *Leka* janë edhe përpjekjet më të mëdha të krijimit të autoimazhit të shqiptarëve.

Por revista *Diturija*, mbetet insitucioni kulturor i botës shqiptare më këmbëngulës dhe më efikas në këtë drejtim. Për këto arsye dhe mjaft të tjera që nuk u përmendën në këtë studim,botimi i *Diturisë* dhe rikthimi i saj në skemën e komunikimit me lexuesin bashkëkohor është rikthim në jetë i një institucioni kulturor nga më të rëndësishmit e kulturës shqiptare.

Dr. Agron Gjekmarkaj

Revista *Diturija* - kryqëzime imagologjike nga Mid'hat Frashëri

Teksa e këqyr të ribotuar e të përmbledhur në dy vëllime të gjithë *Diturinë* e Lumo Skendos është e vështirë të mos pranosh që ke të bësh me një "dukuri komunikimi e cila ka të bëjë me zbulimin e tjetrit, me tjetrin si bartësi i një identiteti kulturor të ndryshëm nga i yti, me tjetrin si botë dhe si vete, si zbulim dhe si rikrijim",[1] por edhe të biesh në tentacionin e një përfytyrimi biblik!

Rilindas e bir i Rilindjes Kombëtare Mid'hat Frashëri, kur Shqipëria kërkonte mëvetësinë, pasi e fitoi dhe e humbi atë, pasi e rimori e prej së cilës krijoi një shtet, ai, biri i Abdylit, mbi supe gozhduar për të mban e tërheq kryqin e rëndë të të gjitha dijeve që mungojnë e pa të cilat një komb nuk mund të rrugëtojë!

Me *Diturinë*, si "shprehja më e plotë e profilit intelektual (…) duke pasqyruar hulumtimet dhe leximet e tij të thelluara nga më të larmishmet, ai zhvilloi linja të gjera studimore që i lejuan të ndërtonte e të sistemonte një korpus të mirëfilltë albanologjik në çështje të historisë, të udhëpërshkrimeve, të dëshmive, të gjuhësisë shqipe e drejtëshkrimit, të bibliografisë"[2], duke kumtuar se nga një zhguall i fortë shtresëzuar për 5 shekuj është mbështjellë gjithçka shqiptare gati në kufij asgjesimi!

1. MARKU, Mark, "Albanologjia në zanafillë ose imazhi i krijuar së jashtmi", *Studime Filologjike Shqiptare (Konferencë shkencore, 21-22 Nëntor 2007)*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 92

2. ASLLANI, Persida, "DITURIJA e Lumo Skendos, shkëlqimi i një gostie", parathënie në *Diturija*, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Fondacioni "Alsar", Tiranë 2018

Së pari prej tij duhet nxjerrë gjuha shqipe, e menjëherë nga dhëmbët e Kadmosit lënda për t'i shkruar alfabetin! Këto vijnë si rrëfim e si akt! Fill pas saj tenton ndërtimin e një sistemi me logjikë kombëtare për dokumentin historik, letërsinë dhe folklorin, për shkencat të cilat duhen themeluar, ligjet që duhen bërë e kanunet të cilat me domosdo duhen ruajtur, pasuritë që duhen jetësuar e përdorur!

Po kaq fort insiston mbi individin i cili duhet të dalë nga koraca e relievit malor e fisnor për t'u bërë pjesë e shoqërisë e cila vetë duhet ta pranojë qytetërimin e për më tepër të ndihet komb. Po kaq ky komb e ka jetike të kuptojë se kontekstualizimi me kontinentin europian është e vetmja frymëmarrje që shtetin e vogël me shumë armiq ngjitmas e mban në jetë!

Duke rishfletuar pas pothuaj njëqind vitesh revistën e tij kuptojmë që në çdo editorial apo artikull Lumo Skendo ka luftuar për të mësuar të vetët si duhet të bëhemi dhe të huajt se si jemi, në një kryqëzim të vazhdueshëm imazhesh që herë përputhen e në të tjera raste përjashtojnë njëra-tjetrën.

Diturija na bind që Lumo Skendo, ndoshta, është njëri prej themeluesve të strukturuës së Imazhologjisë ndër shqiptarë. Ndërtimi i imazhit shqiptar pas një leximi të kujdesshëm duket si mision parësor i punës së tij intelektuale, ku çdo imazh ndërtohet nëpërmjet një ballafaqimi të vazhdueshëm, i cili lëviz nga identiteti tek alteriteti.

Kronikat e udhëtarëve të huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX, të cilat mund të konsiderohen edhe letërsi udhëtimi, por edhe instrument informacioni, të sintonizuara me përshkrimet e tij për historinë, shkrimin, letërsinë, gjeografinë, etnografinë, antropologjinë, individin dhe krahinat i shërbejnë atij për t'u treguar bashkëkombasve si ata janë fotografuar tek të huajt dhe sa e njohin njëri-tjetrin. Kjo e fundit shfaqet dramatike, krahinat dhe trevat shqiptare funksionojnë si botë lokale të izoluara pa njohje të ndërsjella.

Për Lumo Skendon, letërsia, ajo e udhëtimit, e shkruar nga të huajt për ne, si: Arnold Von Harf-i, Eduard Brown-i, Lir Bajron-i, Dino e Nikolo Shefanopul-i e shumë të tjerë, por edhe ajo shqiptare, duke filluar me Pjetër Budin, troket e para në laboratorin e tij, sepse "studimi i imazheve, i paragjykimeve, klisheve, stereotipeve e në përgjithësi i opinioneve ndaj popujve dhe kulturave të tjera, atë që letërsia transmeton nisur nga bindja që këto imazhe vijnë e përcaktohen bashkërisht, kanë një rëndësi që shkon përtej aktit letrar, përtej atij të studimit të ideve dhe nuancave artistike të një autori të vetëm, interesi më i madh që u jep shpirt kërkimeve imazhologjike është të shkuarit tek vlera ideologjike e politike që një vepër mund të ketë".[3]

3. MOLL, Nora, "Immagini dell' altro. Imagologia e studi intercultural", *Introduzione alla letteratura comparata,* Mondadori, f. 213

Kur luftohet për gjithçka, për territorin, për pavarësinë, për shtetin, kufijtë, për vetë mbijetesën loja me imazhin është themelore për të patur sukses i cili në momente të caktuara është më i rëndësishëm se vetë cilësia.

Në shumë hulumtime të tijat Skendo nënvizon "etikën e takimit"[4] ndërmjet shqiptarëve dhe të huajve ose ndërmjet vetë shqiptarëve e cila përkufizohet si mikpritja, koncept ky me sponsorizim mitologjik si një "element themelor në gramatikën sociale të udhëtimit",[5] por edhe të tjera kategori sjelljeje e karakteri që mund të konsiderohen virtyte: krenaria, trimëria, shpirti luftarak etj. Përtej qëllimit funksional ai nuk shfaqet selektiv në botimet e këtyre kronikave e as kompleksohet prej tyre. Nuk i fsheh ato që përshkruajnë elementët e errët dhe negativë të botës shqiptare në sytë e të huajve.

Qafir Pukevilit, siç e thërriste Ali Pashai, në Përmet një banor i thotë që kjo racë barbare meriton të qeveriset nga tiranë, ndërsa një tjetër rrëfen sesi gratë dëshpërohen se nuk i duan burrat, pikërisht kur ata nuk i rrahin bien në këtë tip pohimi, zalisje e pikëllimi.

Një tjetër tregon për pleshtat që gëlojnë në rroba, për gjumin nën hije e në diell që ju këndet pa masë dainjve tanë, për këngët që i këndojnë në gërvallje të pakuptimtë, për zymtësinë tragjike të lebërve që e punojnë tokën pa optimizëm, të bindur se nuk do të mbijë asgjë, gratë që korrin pa kënduar, të sigurta se gëzimi s'ka vend në jetën e tyre, hajdutët që të grijnë në çdo kthesë rruge e shumëçka tjetër që ende rri këmbëkryq mes nesh sot e asaj kohe.

Me gjasë kjo përzgjedhje e thekur e letërsisë së udhëtimit nga Lumo Skendo vjen ngaqë është e vështirë për të dalluar "atë që tregon" me "atë që dëgjon". Letërsia e udhëtimit "di të ruajë këtë ambiguitet që është barazia hermeneutike mes shkrimtarit dhe lexuesit, bashkëpunëtorë të pandarë në tentativë për t'i dhënë një formë botës"[6], në këtë rast asaj shqiptare, që paraqitet anarkike, e rrezikuar, e pastabilizuar në kohë dhe hapësirë.

Mid'hat Frashëri është në përpjekje të vazhdueshme për të "tejkaluar kufijtë, për të parë çfarë ka përtej", në sfidë që "të ballafaqojë të brendshmen me të jashtmen, të këtushmen me të atjeshmen", për të treguar e për t'i dhënë formë atij komunikimi kaq të nevojshëm për shqiptarët, për të parë e njohur veten me sytë e tjetrit e për të hapur fort të vetët "duke përkthyer dhe interpretuar takimin me tjetrin" si një moment tepër të dëshiruar pas ngrirjes

4. NUCERA, Domenico, "I viaggi e la letteratura. Viaggi reali e imaginary", *Introduzione della letteratura comparata*, Mondadori, 2000, f. 139

5. Idem. f. 152

6. Idem. f. 144

së gjatë të qytetërimit shqiptar! Aty vihet re sesi e përkufizojnë etnografinë dhe antropologjinë tonë të huajt dhe si e dëshiron atë Mid'hat Frashëri.

Në këtë mënyrë ai kërkon të injektojë tek lexuesit e vet të kuptuarit e qëllimit të udhëtimit, motivin për të cilin ai kryhet si dhe motivin përse tregohet, duke konturuar një sociologji leximi për t'i mprehur shqisat dhe forcuar njohjen, krahasimin, e mbi të gjitha, ndryshimin e nevojshëm. Në çdo numër ai publikon kartolina me pamje të zgjedhura nga Shqipëria, nga qytetet e saj aso periudhe, si: Shkupi, Prishtina, Prizreni, Shkodra, Berati, Dodona, Janina, Paramithia, qytetet arbëreshe në Itali; monumente kulti, si teqe, kisha, xhami, ura antike; veshje grash e burrash si nga jugu, ashtu nga veriu, për të realizuar, aq sa ishte e mundur, një proces njohjeje mes vedi, një ndërgjegje të përbashkët kulturore e identitare. Po kështu investohet në një prezantim të gjeografisë duke përshkruar "liqenet, kënetat, lumenjtë e Shqipërisë", "zakonet e popullit të Tiranës", "çështje të Drinit dhe Shkodra", "industria e djathit në Gjirokastër", "udhët, pyjet, lumenjtë e Shqipërisë së sipërme", ku rrëfen sesi i duket Kosova: "Njeriu çuditet kur sheh mirësitë që i ka falur natyra keti vendi të bekuar;me një anë sheh në fushë të gjërë që e vaditin lumenj të pashterrur, me anë tjëtër ndodhen pyjet e medhenj me drurë të dreqtë e të fortë;me një vënd duken malet plot me metale. Nga të mos pasurit udhë njerzia në mes të ketyre të mirave dhe në mes të florinet, ndodhen të varfër e pa bukë; kan nevojë të largohen nga ky vënt i pasur e të venë përjashta për të fituar pakë të holla që të mbajnë shtepinë!"[7]

Ky kryqëzim imazhesh realizohet nga Mid'hat Frashëri pas një leximi pa romantizëm, ndryshe nga ungji i tij Naim, i kushteve "materiale dhe ideologjike të përkatësisë së tij kulturore, ose me reflektim eksplicit të "location" të tij.

Me këtë ndërgjegjësim në nivel teorik dhe aplikativ shfaqet një element i dashur që në origjinë për imazhologjinë, elementi etiko-politik e kulturor, si nevojë për ta bërë e mbrojtur Shqipërinë përgjatë shekullit që u konsumua duke e dëbuar Mid'hat benë nga trualli i tij, si shpërblim të fundit për imazhin që i dhuroi!

7. FRASHËRI, Mid'hat, "Udhëtim në Kosovë", *Diturija.* f. 234

Prof. Dr. Dhurata Shehri

BIBLIOGRAFITË e Lumo Skëndos

Bibliografinë si gjini shkrimi, por sidomos bibliografinë si premisë e veprim Mid'hat Frashëri e nis që 17 vjeç kur themeloi bibliotekën e vet personale me emrin "Lumo Skëndo". Duke themeluar bibliotekën, krijoi edhe alteregon e vet librore, Lumo Skëndon, emër me të cilin do të nënshkruajë të gjitha shkrimet bibliografike, duke nisur nga analizat e recensionet e rubrikës "Duke kënduar një libër" nga *Kalendari kombiar*, e *Hylli i dritës*, *Besa* apo *Edukata e Re*, te "Shtim në radhonj të Emile Legrandit" të botuar te *Diturija*, deri tek "Bibliografitë" që botohen te *Diturija* në vitet 1926 deri më 1929.

Katalogu i titujve të analizuar në rubrikën: "Duke kënduar një libër" përfshin analiza për botime nga viti 1919-1932, të botuara te *Hylli i dritës*, *Diturija*, *Edukata e re*, *Besa* etj. Nga pesëmbëdhjetë libra të analizuar në këtë rubrikë, vetëm një autor (përmbledhës) është shqiptar, Kristo A. Dako me librin *Liga e Prizrenit*, dhe gjithë çka Lumo Skëndo u paraqet lexuesve janë gati krejt botime të autorëve të literaturës botërore për Shqipërinë. Ndërsa në rubrikën e bibliografive, që ngërthejnë libra të botuar në periudhën kohore mes viteve 1925-1929, situata paraqitet pak më ndryshe. Një kategorizim provizor mund t'i ndante librat e shqyrtuar kështu:

1. Libra të shkruar nga të huajt dhe të botuar jashtë Shqipërisë: 58 tituj.
2. Libra të botuar brenda Shqipërisë: 81 tituj.

Por shifrat nuk thonë shumë në këtë analizë. Më shumë flasin autorët dhe titujt, historia dhe gjeografia e botimeve që përfshihen në këto bibliografi. Meqë jemi te gjeografia, mjafton t'u hedhësh një sy vendeve të botimit dhe gjuhëve të tyre për t'u ndeshur me një hartë që ndalet në: Paris, Romë, Milano, Vjenë, Bari, Athinë, Pragë, Laipcig, Venecia, Londër, Kaliforni, Shtutgard, Palermo etj; Ndërsa harta e gjuhëve ngërthen anglishten, gjermanishten, frengjishten, italishten, greqishten etj. Por kaleidoskopi shndrit edhe mes fushave të interesit e kompetencës: histori, gjuhësi, gjeografi, arkeologji, diplomaci, psikologji, pedagogji, por edhe shëndetësi, botanikë madje edhe kulinari, paradë që na shërben për të kuptuar thellësinë dhe gjerësinë e kërkimeve dhe analizave të Lumo Skëndos në bibliografitë e veta. Po t'i referohemi përkufizimeve të sotme në fushën e kërkimeve librore, pjesa më e madhe e bibliografive të Lumo Skëndos do të konsideroheshin *review articles*: "një tip literature më vete ku autori rreket të lexojë sistematikisht gjithë literaturën e rëndësishme mbi një subjekt, dhe më pas ta organizojë, ta sintetizojë dhe ta vlerësojë në mënyrë kritike informacionin dhe ndonjëherë duke treguar edhe ato hapësira ku ka nevojë për kërkime të mëtejshme[1]".

Një ekskursion i shkurtër nëpër rradhët e bibliografive të Lumo Skëndos të bën të ndalesh para vërejtjesh dhe analizash të tilla, si disa nga të mëposhtmet: "influenca mbi gjuhën e zakonit të malësorëve shqiptarë që kuvendojnë duke klithur breg më breg dhe duke përhapur lajmet ose duke dhënë kushtrimin: ky zakon ka shkaktuar shkurtimin e fjalëve dhe shumëzimin e njërrokjeve",[2] vërejtje që e ndeshim në analizën e librit të Milan Shuflait.

Konsideratat nga vëllimi *Naim Frashëri, vjershëtorit dhe edukatorit kombëtar* gjykojnë si produktin ashtu edhe qëllimin e fshehur të autorëve. Kjo duket ndërsa lexon: "Padyshim, djalëria, zelli dhe padurimi i bashkëpunëtorëve, i shfajëson prej dëshirës që kanë manifestuar disa herë për të shikuar përkujtimin e Naimit si një shkak, si një rast për të dëftyer diturinë e tyre për dëshirën të shënohen me ide që mbase ndryshe s'do të kishin rasje t'i rrëfejnë"[3].

Në paraqitjen që i bën më 1926 librit të P. Marin Sirdanit *Skanderbegu mbas gojëdhanash* Lumo Skëndo gjen rastin të shprehë "një dëshirë, një lutje: të përkthehet shqip një orë dhe më parë vepra e Barletit, e cila me tërë të metat dhe lajthimet e saj, ka më tepër se një vleftë për neve si e shkruar prej një bashkëkohësi shqiptar të fatosit tonë, si një burim ku kanë marrë lëndë

1. The Oxford Guide to Library Research 2005, f. 135
2. FRASHËRI, Mid'hat, *Vepra të zgjedhura 3*, Instituti i Studimeve "Lumo Skëndo", Tiranë 2018, f. 523
3. Po aty, f. 525

gjithë autorët e tjerë"[4], - konstatim që studimet e sotme historike e letrare e kanë vërtetuar tashmë.

Duke analizuar një revistë që sot duket krejt larg interesit të një bibliografi e veprimtari politik si M. Frashëri: Organin e gjurmësisë shqiptare - revista e bojskautve shqiptarë, ai shpjegon jo vetëm termin shqip gjejës për bojskautët, por edhe arsyet pse periodiku dhe veprimtaria e tij është e rëndësishme për shoqërinë shqiptare: "Gjurmuesia ka edhe një qok të posaçëm për neve; të na bëjë shqiptarë të vërtetë, të marrim ndërgjegje prej vetes sonë, të njohim veten, shokun, kombin."[5]

Ndërsa prezanton përkthimin e *Lahutës së Malcis* në gjermanisht nga Prof. Gustav Weigand**,** autori i bibliografisë së komentuar Lumo Skëndo jep këtë të dhënë bibliografike: "Me sa dimë ne, kjo është e para vepër shqip në vjershë që po përkthehet në gjuhë të huaj dhe nuk mund veçse të gëzohemi edhe një herë më tepër kur shohim se libri i përkthyer është një nga kryeveprat tona. Literatura jonë s'ka veçse të fitojë edhe nga pikëpamja filologjike edhe si studim thjesht literar duke u vënë në folje të tjera"[6]. – Mund të vërejmë që në këtë konstatim Frashëri nuk merr parasysh përkthimet që vetë autorët shqiptarë i kanë bërë veprave të tyre, si edhe shkrimet e tyre direkt në gjuhë të huaj, që do ta zbrisnin shumë më poshtë datën e "të parës vepër shqip në vjerrshë" të përkthyer në gjuhë të huaj.

Paraqitjen e revistës fetare *Zani i Naltë* (revista fetare) Nr. 4, Nandor 1926, z. Lumo Skëndo e shoqëron me një "Nji Lutje këndonjësvet për të mbledhur shkrime të vjetër fetarë në gjuhën shqipe të botuar në faqet e revistës"[7].

Ndërsa përshkruan *Southern Albania or Northern Epirus in european international affairs, 1912-1923*, përveç vërejtjeve dhe dialogut në distancë me autorin, Lumo Skëndo gjen mundësinë të na japë edhe këtë informatë: "jemi të lumtur të shohim se në mes më tepër se 200 titujve të radhitur, figurojnë edhe 16 numra për libra ose broshura të botuara prej vetë shqiptarëve mbi tezën e tyre.[8]" Përtej shifrave, ndjehet vetëdija e autorit për ta hetuar aksionin libror si aksion politik.

Pak dyshues në fillim për interesin mbi një botim si *Statistika e përgjithshme shëndetësore për vitin 1926*, zbulojmë të dhëna interesante për shtetin e shoqërinë shqiptare të kohës, si: "E tërë Shqipëria ka sot 103 mjekë, 50 farmaci, 21 dentistë, 8 mami.[9]" Autori na fton t'i lexojmë këto të dhëna të kryqëzuara me ato që japin

4. Po aty, f. 527
5. Po aty, f. 530
6. Po aty, f. 534
7. Po aty
8. Po aty, f. 552
9. Po aty, f. 554

të huajt për Shqipërinë, qoftë si përshkrime, qoftë si informacion shifror për të analizuar edhe vetë shqiptarët gjendjen e shtetit të vet.

Arsyen e vërtetë pse ka përzgjedhur të paraqesë mes veprave të vitit 1927 të botuara në Shqipëri jo veprën e Fishtës *Shna Ndou i Padues*, por poemën shqiptare legjendare *Leka i Madh* të Ilo M. Qafëzezit e zbulon ndërsa lexon: "Marrim shkak nga kjo vepër të rrëfejmë shpresën a do të dalë kush të na përkthejë librat e Plutarkut, jetëshkrimet dhe copat morale të tij, duke qenë se një përkthim i gjatë më një gjuhë mesatare tonën, me durim dhe kritikë do të bëjë tërë atë shërbim që i pruri frëngjishtes puna e eruditit Amiot me përkthenjësinë, thjeshtësinë, hollësinë dhe begatinë që i dha foljes.[10]" Por gjithsesi, mungesa e veprës së Fishtës shkëlqen.

Mungesa e mësipërme e njërës vepër të Fishtës, duket sikur justifikohet nga zëri pasardhës: *Sh.Luigji Gonzaga*, teatro me tre akte. "Shqipëria bashkë me festimin fetar, pati fatin të fitojë me këtë rast edhe një vepër literare, teatrin që kemi përpara, shkruar prej autorit që na ka mësuar kurdoherë të na japë vjersha të bukura dhe të nalta"[11], por edhe këtu të habit mungesa e emrit të autorit, Gjergj Fishtës, nga një bibliograf skrupuloz si Midhat Frashëri.

Në paraqitjen e dy botimeve mbi zbulimet dhe pasurinë arkeologjike në Shqipëri, vlen të ndalesh në përqëndrimin e autorit, sidomos mbi *Dy epizoda të historisë së Shqipërisë* prej Theodor Ippen dhe te "një katalog i plaçkave të koleksionuara prej z. At Shtjefën Gjeçovi (në Shkodër) dhe Syrja Vlorës që mbase pa këtë kujdes do të mbeteshin të panjohura prej nesh"[12].

Përfshirja në bibliografi e dramës së Oskar Wilde: *Erashja e Ladyt Windermere* duket se vlen për të parashtruar një kritikë të mirëfilltë përkthimi: "Që në fillim të saj libra e sotme na duket e njolluar me një të metë: A.-Përdorimi i një neologjizme të panjohur (erashje) për titull dhe kështu të bërët këtë titull të pakuptueshëm. B.-Përdorimi në mashkullor i fjalës angleze lady-zonjë, pra e ladysë dhe jo e ladyt.[13]" Por kjo vepër bëhet shtysë për të na parashtruar edhe një "kanon personal letrar" të autorit: "Nuk duam të analizojmë veprën e Oscar Wilde-it, e cila për neve s'ka as vleftë literare as rëndësi intelektuale as edhe ndonjë bukuri morale. Kur rrinë kryeveprat e Shakespearit, ose makar të Walter Scottit dhe të Fenimore Cooperit, shkrimet e Carlylit, pse të lodhemi kot me përkthimin e një libri të zbehtë?[14]"

Një tjetër titull i vitit 1927, *Lule Prendvere, vjersha dashtnore dhe ballada*, paraqitet përmes një dialogu fort kritik me shkrimin e autorit, Hilë Mosin: "Autori është

10. Po aty, f. 560
11. Po aty, f. 561
12. Po aty, f. 567
13. Po aty, f. 569
14. Po aty, f. 572

një diletant, një vjershëtor që vargon kur i do qejfi, mund të themi si shahirët popullorë, bardët e moçëm. Natyra e tij pak si përtace duket nga shkrimet, … e ndalon Hil Mosin të punojë, të lëmojë vjershat që bën, t'u japë forcë dhe shkëlqim. Dhe kjo padyshim është një humbje, një mëkat më tepër për ne sesa për autorin e tyre. Ky është shkaku që në mes të luleve të sotme janë disa që kanë mbetur të paçelura mirë, me hartim të pakujdesur.[15]" Por Lumo Skëndo shprehet krejt ndryshe kur komenton përkthimin e *Cubave* të Shilerit po nga Hilë Mosi për të karakterizuar edhe një herë marrëdhënien e nënshtrimit mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore: "si gjithë literaturat e tjera, edhe jona ka nevojë të marrë hua prej thesareve të tjerë të dheut, ide, mendime, ideale, forma. Na pëlqen të shpresojmë se favori i lexuesve do ta bëjë që *Cubat* të bëhen një shembull për prodhime të ngjashme të tjera në lëmë të përkthimeve të kryeveprave."

Me nota më pak kritike i qaset *Kryengritjes shqiptare* të Gramenos kur e përkufizon: "një roman i rrojtur, njëqind herë më tërheqës se nga krijimet e imagjinatës"[16], por përkufizimi i shkrimit më shumë dokumentar se fiksional i jep të drejtën e vërejtjes së mëposhtme: "Me të vërtetë lëvizjet kryengritëse në Shqipëri pas motit 1908, domethënë përpjekjet e shqiptarëve kundër Turqisë së Re pas konstitucionit, patën tri vatra të veçanta: Toskëri, Kosovë, Malësi e Shkodrës; Mihali rrëfehet se ngjarjet e këtyre dy skenave të fundit i injoron krejt: nuk di as psikologjinë e atyre që luftuan kundër xhonturqve, as shtytkat patriotike të tyre, as zhvillimin e buçimit, as edhe, mjerisht, intrigat që nuk munguan të veprojnë për dëmin e interesave kombiare tona....[17]"

Meqenëse "romanet mbi Shqipërinë në gjuhë të huaja janë të pakët: s'janë me tepër se katër"[18], Lumo Skëndo vendos të na paraqesë në bibliografinë e tij njërin prej tyre "Shqipëtarka dhe urrejtja e saj", duke u shtuar librave historikë e udhëpërshkrimeve të të huajve për Shqipërinë edhe një dimension tjetër, fiksionalin.

Ndërkohë që në bibliografitë e Lumo Skëndos nuk shfaqet asnjë nga veprat dramatike të E. Haxhiademit që i përkasin të njëtës periudhë, të njëjtave vite që ngërthen bibliografia, në rradhët e tyre gjejmë një shënim komentues për *Avokatin Patelin*, komedi në tri akte prej Brueys dhe Palaprat, përkthyer nga frëngjishtja prej Visko Babatasit. Arsyen e përzgjedhjes "së çuditshme" e gjejmë në një shënim kritik e vlerësues njëherësh nga ky autor që i ka të rralla "komplimentet për autorët vendas: "Po çdo komedi, çdo pjesë teatri sot janë të

15. Po aty, f. 576
16. Po aty, f. 578
17. Po aty
18. Po aty, f. 585

mirëpritura prej nesh. Arrin vetëm që të jenë të shqipëruara në gjuhë të kthjellët, të kuptohet pa studim dhe mund të vërejmë që zoti Babatasi ka pasur nevojë të shtojë një leksik 11 faqesh për të rrafshuar disa vështirësi. Kemi frikë se edhe disa kohë akoma përkthimi i Besës prej Abdyl Ypit do të mbetet i vetmi përkthim klasik në gjuhën tonë."[19]

Vlerësimi i kthehet në lutje kur paraqet veprën tjetër të përkthyer *Gjylistani a Trëndafilishta e Sadiut*, shqipëruar prej Hafiz Aliut dhe shprehet: "I lutemi Perëndisë që përkthimi shqip i sotëm të jetë besnik i origjinalit dhe që këndonjësi të gjejë gjithë atë shije dhe atë bukuri që ka vetë Gjylistani në persishte."[20]

Paraqitja e *Gramatikës dhe sintaksës së gjuhës shqipe* prej Ilia Dilo Sheperit, na lejon të përqendrohemi te dy vërejtje që hedhin dritë mbi parimet e filozofisë së gjuhës ku mbështetet Lumo Skëndo, kryetari i Kongresit të Manastirit, parime që ende nuk janë rrënjosur ndër gjuhëtarët firmëtarë të Kongresit të Drejtshkrimit të 1972-it, gati 100 vite më pas: "S'ka dyshim që rrehet kush beson se gjuhën e bëjnë akademikët ose gjuhëtarët: të folurit bëhet vetiu, zbukurohet dhe merr shkëlqim prej letrarëve, shkrimtarëve të mëdhenj. Por, populli, do edhe poetët, kanë nevojë që të ndjekin parimet e vërteta të gjuhës së tyre, t'i njohin mirë gjithë rregullat e saj që edhe shkrimet e tyre të dalin prej shpirtit të idiomit në të cilët shkruajnë, të rekëtijnë me atë frymë"[21] dhe "Nuk është kështu gramatika ajo që e ka zhvilluar gjuhën rregulluar të folurit dhe shkrimin e saj, por është të folurit dhe shkrimi i gjuhës që cakton rregullat, të cilat gramatika sa që i rreshton të shoshitura dhe i lidh në ligje gjuhësore të përgjithshme."[22]

Mbizotërimi i kritikës sociologjike, ose më mirë i përparësisë së të dobishmes ndaj të bukurës, besojmë se mund të na japë argumentin shpjegues pse ndër titujt që lidhen me emrin e Ndre Mjedjes, Lumo Skëndo përqendrohet më shumë te *Shën Luigj Gonzaga* sesa te *Juvenilja* ose *Lissus*: "Meqenëse bëjmë fjalë për një libër që e shkruan një famullitar dhe e boton shtypshkronja e Papërlyemes, do të dëftejmë edhe shpresën të shohim një ditë një seri biografish shenjtorësh: do të ishte për popullin tonë një shkollë moralizimi dhe një ushtrim karakteri, duke çelur një rrugë të re për ambicionin tonë, një udhë larg asaj kotësie të verbër që e shtyn popullin injorant të admirojë vetëm fuqinë brutale, të shohë madhërim dhe nderim vetëm tek ay që tremb botën, prej të cilit ka frikë bota dhe të shikojë si virtyt më të lartë pasurinë, argjendin dhe arin që sigurojnë pushtete brutale"[23]

19. Po aty, f. 591
20. Po aty
21. Po aty, f. 592
22. Po aty, f. 594
23. Po aty, f. 602

- komenton për *Shën Luigj Gonzaga*, ndërsa për *Lissus* mjaftohet me informatën: "Një broshurë me 12 sonete, epope e Lezhës, nga kohët e moçme gjer ne vdekja e Skënderbeut."[24] Ndoshta komentet estetike për sonetin e Mjedjes i ka dendësuar në paraqitjen e *Juveniljes* kur shkruan: "Dom Ndre Mjeda nuk shkruan shumë. Vepra e tij mblidhet në do vjersha, në do sonete; ndoshta në këtë pikë mund ta përngjajmë me poetin francez Jose-Maria de Heredia, autor i një të vetmi libër sonetesh nga me të bukurit shkruar gjer më sot në gjuhë të Francës."[25] Përmes këtyre shënimeve, Lumo Skëndo na jep në dukje një indicje kërkimi krahasues, por sërish thekson primatin e botërores ndaj kombëtares në fushë të letërsisë.

Një qëndrim i tillë është i pritshëm nga një autor që ndoshta është i vetmi në letrat shqipe që ka shkruar një paraqitje kritike të librit të vet duke u përpjekur të na shpjegojë dallimin mes unit krijues dhe unit kritik, Midhat Frashërit dhe Lumo Skëndos. E kam fjalën për kritikën e veprës *Gruaja, libër për gratë dhe për burrat, dedikuar trupit arsimor***.** Ja si e paraqet ai librin: "Cilësia e autorit (ai vetë) nuk duhet që të ndalojë kritikun (po ai) së gjykuari prodhimin e tij. Librëza që kemi në dorë ka një të metë të madhe: është fort e shkurtër kur subjekti është shumë i gjerë. Pa u trembur të akuzohemi se mejtojmë që rruzullimi zvirdhet prej një proze të jashtëzakonshme, do të themi se gjithë shkrimet tanë mbajnë më vete të metën e të qenit shumë të kondensuar, temat jo mjaft të shpjeguara, jo sa duhet të kthjelluara."[26]

Gjithsesi, bibliografitë e tij mbeten kryesisht bibliografi veprimi, apo bibliografi politike, ku Lumo Skëndo studiues i flet Mid'hat Frashërit politikan e diplomat. Të qenët e tyre më tepër bibliografi politike apo bibliografi veprimi, (sidomos pjesa e bibliografive albanologjike që lidhen pazgjidhshëm me librat dhe aktivitetin e tij diplomatik e politik në mbrojtje të çështjes kombëtare) e bëjnë aktin e tij libror një akt politik e atdhetar, duke iu përmbajtur motos "Shqipërinë e bëri poezia dhe e ruajnë librat". Këtë ndërthurje mes veprimtarit e librarit, diplomatit e lexuesit, politikanit e kritikut e gjejmë të ndërkëmbyer edhe në datat biografike të tij, kur periudhat e veprimtarisë diplomatike e politike ia lënë vendin datave të veprimtarisë albanologjike e bibliofilike, e sërish, kur veprimi politik e kërkon, kur Shqipërinë e pushtojnë sërish të huajt, si më 1939, apo kur vendoset diktatura komuniste në Shqipëri. Këto dy kahje të veprimit e mendimit të vet i ngjajnë dy figurave të tij të adhuruara edhe si intelektual: Naimit të *Bagëti e Bujqësi* që Shqipërinë e ëndërron dhe këndon dhe Abdylit të "Lidhjes së Prizrenit" që Shqipërinë e kërkon dhe ndërton.

24. Po aty, f. 623
25. Po aty
26. Po aty, f. 636

Në këtë ndërkëmbim, Mid'hat Frashëri, si përfaqësues i elitës shqiptare (kundërshtues i flaktë e teorisë politike të klasave) po t'i përmbahemi edhe përkufizimit që ai vetë na jep për elitën që: "jo vetëm përfaqëson pjesën më të vlefshme të një kombi, por edhe është udhëheqëse për ide, gjykim e ndryshim, për estetikë, jetë kolektive, jetë historike, filozofi dhe besim.[27]" - me jetën dhe veprën e vet ngjan fort me ato elita që pasi u rrëzuan prej politikës klasore në Shqipëri, arritën të mbijetojnë në Kosovë dhe kryen një veprimtari të afërt me atë të Lumos Skëndos, veprim e mendim që kulmoi me takimin debat mes përfaqësuesish të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës me ata të Serbisë, me temën bosht: "Serbët dhe Shqiptarët në Jugosllavi sot", që u mbajt në Beograd (më 26 e 27 prill 1988).

27. SKENDO, Lumo, "Elita shqiptare", *Përpjekja shqiptare*, Tiranë, 1936

Dr. David Hosaflook

Kristoforidhi dhe shkrimet e Mid'hat Frashërit për Shoqërinë Biblike

Kongresi i Parë i Manastirit, sipas vlerësimit të kryetarit të tij, Mid'hat Frashërit, arriti dy synime kryesore: *bashkimin e abëcëve* dhe *bashkimin e shqiptarëve*.[1] Bashkimi i alfabeteve ishte kusht i domosdoshëm për bashkimin përfundimtar të shqiptarëve, por bashkimi i shqiptarëve ishte kusht i domosdoshëm për bashkimin e alfabetit. Por, cili bashkim do të vinte i pari, për të nxitur të dytin? Thënë ndryshe (me një pyetje popullore filozofike): "Kush duhet të lindte e para: *pula* apo *veza*?". Në Manastir, nëpërmjet nismës së Klubit të miremërtuar "Bashkimi", ato lindën së bashku. Ky bashkim ishte vetëm një fillim – një fillim i mbarë dhe i shumëpritur.[2] Megjithatë, arritjet e këtij kuvendi u shoqëruan me një dështim: u vendos që të përdoreshin dy alfabete përkohësisht, jo vetëm një, siç deshën organizatorët. Megjithatë, edhe ky dështim shënoi një arritje të fshehtë, në formën e pragmatizmit dhe kompromisit, dy cilësi të cilat ishin të rëndësishme për një qeveri shqiptare autonome, apo për një shtet të pavarur në të ardhmen.

Sfida kryesore pas Kongresit nuk ishte si të kalonin shqiptarët nga përdorimi i *disa* alfabeteve në *dy*, as se si të bënin zgjedhjen përfundimtare nga *dy* alfabete në *një*, por një sfidë më praktike për shumicën e shqiptarëve: si të kalonin nga

1. SKENDO, Lumo, "Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit?", *Lirija*, 22 vjesht' e tretë 1908
2. Që nga 1905, Gjergj Qiriazi (me pseudonim Petro Llambi) paraqiste dëshirën e tij për një kuvend kombëtar. Shih: QIRIAZI, Gjergj (LAMBI, Petro), "Dy letra", *Albania*, viti 9, nr. 10 (1905), f. 201

asnjë alfabet në *një*. Domethënë, problemi i madh ishte analfabetizmi, apo edhe arsimimi i shqiptarëve në gjuhë të huaja. Zgjidhja e problemit ishte përhapja masive e shkrimit, botimit dhe leximit në gjuhën shqipe. Prandaj, vetëm një ditë pas mbylljes së Kongresit të Manastirit, dhjetë delegatë udhëtuan në Korçë (dy ditë rrugëtim[3]) për të vizituar Shkollën e Vashave, një shkollë protestante dhe kombëtare[4], asokohe nën drejtimin e Sevasti Qiriazit. Më 26 nëntor 1908, në një mbledhje të madhe në godinën e shkollës, Nyzhet Vrioni, Luigj Gurakuqi, Feim Beu dhe Petro Nini Luarasi mbajtën fjalime, duke shprehur mirënjohje për Shkollën e Vashave dhe duke theksuar nevojën e madhe për themelimin e shkollave të tilla në të gjitha trojet shqiptare.[5] Mirëpo, shkollat kishin nevojë për libra, dhe shqiptarët e arsimuar duhet të pajiseshin me materiale për të lexuar. Në këtë kontekst kohor e kulturor, Mid'hat Frashëri themeloi revistën e tij letrare, *Diturija*, e cila botohej në vitin 1909 dhe u shtyp me alfabetin e Stambollit.[6]

Në këtë punim, për konferencën shkencore "Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës *DITURIJA*", do të trajtohen shkrimet e Mid'hat Frashërit për Shoqërinë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (BFBS[7]). Gjithashtu, do të trajtohet edhe Konstandin Kristoforidhi, figura më e rëndësishme e BFBS-së për përhapjen e shkrimit shqip përpara vitit 1908. Ky trajtim nevojitet për shkak të rolit kryesor që ka luajtur Shoqëria Biblike në lëvrimin e gjuhës shqipe. M. Frashëri nuk kishte asnjë lidhje zyrtare me BFBS-në, as nuk ishte pjesëtar i kishës protestante-ungjillore, siç ishin shumica e përfaqësuesve të BFBS-së, prandaj fjalët e tij na japin një paraqitje të paanshme dhe një vlerësim bashkëkohor për Kristoforidhin dhe për këtë shoqëri, në kulmin e Rilindjes Kombëtare.

Meqë Kongresi i Parë i Manastirit kishte sjellë një epokë të re në historinë e shkrimit shqip, ishte e nevojshme që revista e re të fillohej me një pasqyrim të së kaluarës, për të interpretuar drejt kapitullin e ri letrar që sapo fillonte të shkruhej. Ndaj, në numrin e parë të revistës së tij, M. Frashëri botoi artikullin "Istori e shkrimit shqip"[8] Në këtë artikull, ai pranoi mungesën e shkrimeve të

3. QIRIAZI, Parashqevi, "Kujtimet e Parashqevi Qiriazit mbi Kongresin e Manastirit", AQSH F. 57 (Parashqevi Qiriazi), D. 1 (Veprimtare krijuese).

4. Fakti që Shkolla e Vashave ishte shkollë e krishterë u "harrua" pas vitit 1967, kur fama e saj u përhap vetëm si shkollë kombëtare dhe laike (p.sh., filmi "Mësonjëtorja", 1980), por ky fakt ishte i mirënjohur në kohën e Kongresit të Manastirit. Shih, p.sh.: "Kleri grek edhe Shkolla Protestante e Çupave në Korçë", *Albania*, viti 9, nr. 9, 1905: 179

5. KENNEDY, Violet, "Bulletin No. 5" (dorëshkrim), 3 dhjetor 1908. Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, Fondi Edvin Xhejks

6. Për çudi, M. Frashëri, kryetari i Kongresit të Parë të Manastirit, nuk përdori asnjërin nga dy alfabetet e vendosura në Kongres. Deri në vitin 1915, M. Frashëri vazhdoi të shtypte revistën me alfabetin e Stambollit

7. Emri i Shoqërisë Biblike në origjinal: British and Foreign Bible Society (BFBS).

8. SKËNDO, Lumo, "Istori e shkrimit shqip", *Diturija* , Nr. 1, 1909, ff. 1–6

hershme shqipe dhe pastaj përmendi veprat më të hershme që ai njihte – veprat e Pjetër Budit (1621)[9] dhe Frang Bardhit (1635), por ai cilësoi: "Megjithëkëtë, s'mund të themi se shkrimi i shqipes përdorej prej gjithë njerëzve si një shkrim praktik". Me këtë cilësim, autori zbuloi mendimin e tij se nevoja e popullit nuk ishte vetëm për libra të shtypura dhe të ruajtura në një manastir për një grup të vogël njerëzish, por për libra që do të përhapeshin gjerësisht dhe të lexoheshin nga sa më shumë shqiptarë. M. Frashëri vazhdoi artikullin e tij duke përmendur përkthimin e P. Budit të veprës *Dottrina Cristiana* (1664) dhe veprën e Pjetër Bogdanit, *Infallibile Verita*… (1696), duke konstatuar se "shqipja ishte e përdorur prej priftërisë katolike". Për shekullin pasues, M. Frashëri nuk dihej për ecurinë e gjuhës shqipe: "Sa për sot themi se i tërë shekull i 18-të mbetet i shuar për ne, se në të, s'gjejmë asnjë drudhe shkrimi shqip". Megjithatë, ai mbante shpresë se hulumtimet nëpër kishave të vjetra dhe manastirëve do të nxirrnin zbulime të reja.[10]

Me këto indikacione, M. Frashëri paraqet një histori mjaft të errët për shkrimin e shqipes deri në shek. XIX. Sigurisht, disa botime kishin dalë në dritë, por sipas tij, ato nuk kishin shërbyer për ta bërë gjuhën shqipe një "gjuhë të gjallë dhe të përdorur". "Qindra dhe mijëra vjet kishin shkuar, – shkroi ai, – pa u menduar që të përdornin gjuhën e vet për të vendosur mendimet e për të rrëfyer dëshirat". Pikërisht në këtë gjendje doli në skenë Shoqëria Biblike (BFBS), ose siç e quajti në këtë artikull, "Shoqëria Ungjillore". M. Frashëri i portretizoi botimet e para të kësaj shoqërie (*Ungjilli sipas Mateut,* më 1824 dhe e gjithë *Dhiata e Re,* më 1827)[11] si "udhëheqës për shkrimin e shqipes, se [atëherë] kjo gjuhë niste të përdorej për vepra të mëdha dhe të rënda".

Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja ishte themeluar më 1804 me moton "Bibla për botën".[12] Meqë parimi themelor i Lëvizjes Protestante është "Sola Scriptura" ("Vetëm Shkrimi i Shenjtë" është autoriteti për besimin), kjo lëvizje mund të përhapej ndër popujt vetëm me anë të librit të shenjtë në gjuhët amtare. Përkthyesit duhet të paraprinin predikuesit. Që nga themelimi i BFBS-së e deri në botimin e parë të revistës *Diturija* (pra, 1804–1909), BFBS-ja kishte përkthyer, botuar ose shpërndarë Shkrimet e Shenjta në 412 gjuhë

9.Datat e përmendura këtu në kllapat jepen sipas artikullit të L. Skëndos, pra, nuk tregojnë doemos datat e botimit të parë të këtyre veprave, por pasqyrojnë njohjen e kohës për këto botime.

10. Njëqind vjet më vonë, më 2010-n, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë botoi një bibliografi të librit shqip (nga Ramazan Vozga), në të cilën janë përmendur vetëm 13 botime nga shek. XVIII.

11. *Ungjilli sipas Matuet* u botua më 1824, si provë për projektin e plotë e të gjithë *Dhiatës së Re*.

12. Më 1905, në *Kalendari kombiar* u përmend 100-vjetori i BFBS-së (f. 154), duke shtuar: "Mos harrohet që kjo shoqëri është që vuri të ndjerin Kristoforidhë nga Elbasani dhe ktheu shkronjat shenjtë toskërisht e gegënisht".

të botës. Ndaj, me të drejtë, L. Skëndo do ta quante *Dhiatën e Re* në shqip një "vepër e madhe", jo vetëm për ndikimin e saj në kultivimin e jetës shpirtërore të popullit, por edhe për faktin që e kishte sjellë gjuhën e shkruar shqipe në një stad të ri. Pas këtij botimi, shqipja mund të studiohej gjerësisht nga filologët e huaj, si J. Ksilander dhe J. G. Fon Hani, të cilët po shkruanin për gjuhën shqipe në bazë të studimit të tyre të botimeve të BFBS-së.[13]

Shoqëria Biblike kishte sjellë *Dhiatën e Re* në trojet shqiptare, me synim për ta shpërndarë në mënyrë masive, por botimi pati të meta. M. Frashëri vërejti, me të drejtë, se botimet ishin të vështira për t'u lexuar, me fjalë turqishte dhe greqishte. Me të vërtetë, BFBS-ja deshi të zgjeronte punën, të studionte ndikimin e botimeve e t'i përmirësonte, por përkthyesi i *Dhiatës së Re*, Vangjel Meksi, vdiq më 1823 dhe redaktori i saj, Grigor Gjirokastriti, vdiq më 1828 apo 1829. Nëse ata do të kishin jetuar më gjatë, mund të shfrytëzonin lidhjet e tyre dhe mund të ndërmerrnin projekte të reja. Ndaj kur M. Frashëri vijoi "rrugëtimin e shkrimit shqip", e ka theksuar në mënyrë të veçantë veprimtarinë e Konstandin Kristoforidhit, i cili "ndenji afër 30 vjet në shërbim të Shoqërisë Ungjillore". M. Frashëri e lëvdoi K. Kristoforidhin për disa arsye:

1. Kishte shkruar bukur gjuhën shqipe dhe me thjeshtësi.
2. Kishte dituri të thellë, meqë shqipja deri në atë kohë ishte "një gjuhë e egër, pa shkronja, pa libra, pa literaturë… e që nuk përdorej përveçse për të kuvenduar dhe për ca këngë e vjersha, dhe për ca libra të rrallë".
3. Shkrimet e tij provuan se gjuha shqipe ishte "e volitshme për t'u përdorur si gjuhë e gjallë".
4. E përktheu *Dhiatën e Re* në toskërisht dhe në gegërisht.
5. Kishte udhëtuar në gjithë Shqipërinë për të begatuar fjalorin.
6. Shkrimet e tij "kishin gatuar gjuhën, kishin gatuar dhe mendjen e shqiptarëve… kishin çelur rrugën".

* * *

Vlerësimi i Mid'hat Frashërit për Shoqërinë Biblike nuk përfundoi me fjalët e artikullit të tij, në numrin e parë të revistës *Diturija*, por ai botoi dy artikuj në revistën e Shoqërisë Biblike, *The Bible in the World* (*Bibla në botë*). Artikulli i parë, i tetorit të vitit 1911, titullohej "The Development of Albania" ("Zhvillimi i

13. VON HAHN, Johann Georg (red. Robert ELSIE), *The Discovery of Albania: Travel Writing and Anthropology in the Nineteenth-Century Balkans*, I. B. Tauris, Londër, 2015, f. 7

Shqipërisë")[14], në parathënien e të cilit, BFBS-ja e prezantoi M. Frashërin si një mysliman të mirë, por si një mik të përhershëm dhe besnik i punës së Shoqërisë Biblike në Shqipëri. Artikulli trajton gjeografinë e Shqipërisë, popullsinë e saj, prejardhjen e termave "Albanian", "arbër" dhe "shqiptar", ndarjen e popullit gegë–toskë, përkatësinë fetare të shqiptarëve, dëshirën e tyre për liri, funksionimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit, lakminë territoriale të fqinjëve dhe propagandën e tyre fetare e politike, që synonte asimilimin e shqiptarëve. Artikulli përfshin edhe katër fotografi: një fshatar nga Hoti ne kostum popullor dhe me armë; pesë burra të Mirditës me pushkët e tyre; një bej shqiptar; dhe gjashtë burra që po kalonin lumin Drin me një varkë. Edhe pse ky artikull i M. Frashërit nuk e përmend Shoqërinë Biblike, u botua – sipas redaksisë – "sepse hedh dritë mbi dëshirën e zjarrtë të popullit shqiptar për të pasur Fjalën e Zotit në gjuhën e tyre".

Artikulli i dytë i M. Frashërit për Shoqërinë Biblike u botua në korrik të vitit 1912, me titullin "Albania and the Bible Society" ("Shqipëria dhe Shoqëria Biblike")[15] dhe u paraqit, gjithashtu, me një parathënie nga redaksia, në të cilën thuhet se M. Frashëri ishte shkrimtari dhe autoriteti letrar më i shquar shqiptar, dhe se artikulli i tij i mëparshëm u prit nga lexuesit e revistës *Bible in the World* me shumë kënaqësi. Artikulli i dytë ndryshon krejtësisht nga i pari, i ngjason më tepër artikullit të parë të revistës *Diturija*, ku përmendet Shoqëria Biblike. Me rëndësi është fjala falënderuese që M. Frashëri ia kushtoi BFBS-së, qysh në fillim të artikullit:

Pikësëpari, jam ndier i detyruar të bëj një nderim mirënjohjeje të merituar ndaj Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, për shërbimet që i ka bërë vendit dhe letërsisë sonë me anë të përkthimeve të Shkrimeve të Shenjta në gjuhën shqipe. Në të vërtetë, është e pamundur të flitet për gjuhë dhe letërsi të Shqipërisë pa sjellë ndërmend mundimin dhe përkushtimin e atyre që për kaq gjatë dhe përballë kaq shumë vështirësish, kanë vijuar me këtë vepër fisnike.

Pas kësaj, M. Frashëri e lëvdoi skocezin Aleksandër Tomson, agjentin përgjegjës të BFBS-së në Stamboll në vitet 1860–1895, i cili kishte pajtuar K. Kristoforidhin për punën e përkthimit të Shkrimeve të Shenjta. Botimet e tyre, shkroi M. Frashëri: "Për shumë vite përbënin gjithë korpusin e literaturës së botuar në Shqipëri". Për

14. SKENDO, Lumo, "The Development of Albania", *The Bible in the World*, London: British and Foreing Bible Society, tetor 1911, f. 295–299
15. SKENDO, Lumo, "Albania and the Bible Society", *The Bible in the World,* London: British and Foreing Bible Society, korrik 1912, f. 218–221

këtë arsye, BFBS-ja u nderua dhe u respektua "ndër gjithë shqiptarët patriotë, qoftë myslimanë apo të krishterë". Në këtë artikull, M. Frashëri vijon duke shpjeguar pse qyteti i Elbasanit, vendlindja e Kristoforidhit, ishte aq strategjik nga ana gjuhësore dhe gjeografike, dhe cila ishte gjendja aktuale e projektit të përkthimit të gjithë Biblës, meqë Kristoforidhi nuk e kishte përfunduar Dhiatën e Vjetër kur vdiq më 1894. Ai e mbyll artikullin e tij duke shprehur dëshirën e tij për përhapjen e shkollave kombëtare "me lirinë për të mësuar gjuhën shqipe", meqë tani, liria e Hyrietit të viteve 1908–1909 ishte veç kujtesë që i përkiste së shkuarës.

Si u lidh Mid'hat Frashëri me Shoqërinë Biblike, për të botuar këta dy artikuj në revistën *Bible in the World*? Nëpërmjet T.R. Hoxhson (T.R. Hodgson), agjentit të BFBS-së në Stamboll, i cili kishte zëvendësuar Aleksandër Tomsonin kur doli në pension. Sipas M. Frashërit, Hoxhsoni ishte "miku i tij" dhe merrej me përgatitjen e Biblës për shtyp me ndihmën e Thanas Sinës. Madje, T.R. Hoxhsoni qe i ftuar nga Klubi Bashkimi për të marrë pjesë në Kongresin e Parë të Manastirit, por nuk mund të vinte.[16] Kjo miqësi tregon se Shoqëria Biblike, ndonëse qëllimi i saj i vetëm ishte botimi dhe shpërndarja e Biblës, mbante lidhje shumë të ngushta me figurat kryesore letrare dhe me rilindasit kombëtarë. Shkrimi i shqipes dhe problemi i alfabetit kishin marrë shumë kthesa përgjatë viteve. Shoqëria Biblike kishte nevojë për të siguruar që librat e tyre do të mund të lexoheshin nga sa më shumë shqiptarë, ndaj ajo duhet të mbante lidhjet me ata që do të bënin ndryshime. Nga ana e tyre, figurat letrare si M. Frashëri kishin dëshirë që Shoqëria Biblike, si botuesi më i fuqishëm i librit shqip (me gjithë rrjetin e saj të librashitësve nëpër gjithë trojet shqiptare), të shtypnin librat me alfabetin e parapëlqyer të tyre, sepse kështu, sipas tyre, do të vinte mbrothësia e kombit.

Deri më tani kemi trajtuar një artikull që Mid'hat Frashëri botoi në revistën *Diturija* (1909) dhe dy artikuj që ka botuar në revistën e BFBS-së, *Bible in the World* (përkatësisht më 1911 dhe më 1912). Por do të përfundojmë këtë trajtim me një njoftim të M. Frashërit, shkruar pesëmbëdhjetë vjet më pas, lidhur me Shoqërinë Biblike. Në këto pesëmbëdhjetë vite, Shqipëria u shpall e pavarur, Princ Vidi u shpall mbret i Shqipërisë (për gjashtë muaj), pastaj plasi Lufta e Parë Botërore, u caktuan kufijtë e Shqipërisë dhe u ngrit në fuqi Ahmet Zogu. Pavarësisht gjithë këtyre ndryshimeve, nuk ndryshoi respekti i M. Frashërit për Shoqërinë Biblike. Në revistën e tij *Diturija*, më 1927, ai botoi një artikull të shkurtër me titullin: "Një Qintvjetore Që Ka Një Rëndësi Për Neve",[17] i cili

16. HODGSON, T. R., "The Albanian Alphabet", Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë (fondi i Shoqërisë Biblike), 22 janar 1909.
17. SKËNDO, Lumo, "Një Qintvjetore Që Ka Një Rëndësi Për Neve", *Diturija*, nr. 7, 1927, ff. 250–259.

ishte, njëkohësisht, një ftesë për një ekspozitë në librarinë e tij, kushtuar librave të BFBS-së:

Po bëhen njëqind vjet që u botua në Korfuz i pari përkthim shqip i shkronjave të shenjta. Ky përkthim, në një kohë kur ende shkrimi i gjuhës' sënë s'kishte zgjuarë ndonjë interes as ke neve, as, ne të huajtë, nukë mund që të mos shikohet si një ngjarje me një kuptim të madh për shqiptarët.

Shqipëronjësi i të katër Ungjive, i Punëve dhe i Letrave ngjan të ketë qënë edhe vetë Grigori, arhiepiskopi i Evviës, sadoqë në librat përdoret fjala "epistasia" d. m. th. kujdesi, këqyrja.

Tre vjet më parë editimit të plotë të shkronjave të shenjta, ishte botuar në Korfuz, në një format të vogël, vetëm Ungjilli i Mateut.

Për kujtim të qindvjetorës së përkthimit të parë të ungjive dhe të gjashtëdhjetvjetores së punimit të Kristoforidhit, "Diturija" do të organizojë një ekspozitë të vogël në librarinë Lumo Skendo, që më 15 gjer më 18 qershor, në të cilët do përpiqemi të radhitim ç'mund të gjejmë relatif me këta dy komemorime. Janë të lutur këndonjësit e "Diturisë" dhe miqt e tyre, të urdhërojnë në ekspozitët tanë.

Bibliografi e revistës *Diturija*

Përgatitur nga
Brunilda Tahiri & Eni Kaçi

PARATHËNIE

Botimi i revistës *Diturija* - "e përkohshme shqip literare dhe diturake" - themeluar nga Lumo Skendo (pseudonimi letrar i Mid'hat Frashërit), erdhi në një moment vendimtar për kulturën dhe botën shqiptare, pikërisht një muaj pas mbajtjes së "Kongresit të Manastirit", duke lënë gjurmën e saj të pashlyeshme në historinë e shtypit kulturor shqiptar. Bibliografia që po paraqesim synon të ndërtojë një njohje të thellë dhe shteruese bibliografike të kësaj reviste, e cila nuk iu nda asnjë çast qëllimit të saj "diturak kombiar".

Në komunikimin me këndonjësit në dy vjetorin e revistës, Lumo Skendo e ndiente për detyrë "rrëfimin" e qëllimit të botimit të saj: *Në shkrimet e saj revista jonë, nga më i gjati gjer ne më i shkurtrë artikull, ka për qok shërbimin e Shqipërisë dhe të shqiptarismësë. Ky program zhvillohet në tema historike, filologjike si dhe në shënimet e vegjël bibliografikë: T'i bëjmë këndonjësit tanë të shohin të shkuarën dhe të mejtohenë mbi pritmin, të kupëtojnë detyratë që i bienë kolektivitetit dhe çdo individi, të munt të marrë një formë të caktuarë përgjegjësija dhe aspitatat t'ona, të mësojmë çë duamë dhe çë lipset të duamë. Me këtë mënyrë përpiqemi që botimi ynë të jet aq'i dobishmë për njerinë privat, për nëpunësin si dhe për mësonjësin ose profesorin: kemi dashur t'u drejtohemi të gjithëve.*

Numri i parë i revistës *Diturija* u botua më 1 janar 1909 në Selanik, fillimisht si një e përkohshme e përmuajshme. Rrethanat historike, por edhe ato jetësore, ndikuan në periodicitetin e botimit. Pas një ndërprerje 7-vjeçare, në vitin 1916 ajo rinisi të botohet, këtë herë e zhvendosur në Bukuresht dhe vetëm 3 muaj, qershor-gusht. Botimi i revistës u ndërpre sërish për të rinisur pas 10 vitesh, në nëntor 1926 në Tiranë deri në mbylljen e saj në dhjetor të vitit 1929. Megjithëse me një jetë jo të gjatë, vetëm 42 numra dhe rreth 1135 faqe, *Diturija* ishte një

revistë që reflektonte erudicionin dhe kulturën e thellë të drejtuesit të saj, por edhe qëllimin dhe vizionin e qartë që Lumo Skendo kishte për të.

Shkrimet në vitin e saj të parë karakterizohen nga tema të lidhura me ngjarjen e rëndësishme të përcaktimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Shkrimi që çel revistën, "Istori e shkrimit shqip", nga pena e Lumo Skendos, vjen si një dëshmi e rëndësisë që kishte në ato vite çështja e gjuhës shqipe. Jo pa qëllim ai sjell përmes këtij artikulli historinë e alfabetit, tekstet e vjetra shqipe, Shoqërinë e Stambollit dhe Abetaren e Stambollit, kontributin e von Hahn, Budit, Bardhit, Bogdanit, Kristoforidhit, Kavaliotit, De Radës, Veqilharxhit e Naim Frashërit. Shkrimet e Lumo Skendos mbi këtë çështje vijojnë duke prekur edhe problematika të tjera thelbësore që lidhen me përdorimin e gjuhës shqipe, drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin, me domosdoshmërinë dhe nevojën e unifikimit të saj si në shkrimet: "A do të kemi një të vetëm gjuhë literare shqip?", "Të vëmë re kur shkrojmë" etj.

Imazhi është një element shumë i rëndësishëm i revistës. Përgjatë gjithë vitit të parë janë publikuar 27 fotografi, të cilat padyshim mbartin vlerë të jashtëzakonshme edhe si dëshmi historike e kulturore. Të tilla janë edhe fotografitë e Kongresit të Manastirit dhe të komisionit të alfabetit, por po kaq vlera mbartin edhe fotografitë me pamje të zgjedhura nga qytetet shqiptare të asaj periudhe si Berati, Shkodra, Elbasani, Shkupi, Tirana, Saranda, Gjirokastra, Dodona, Janina, Paramithia, apo qytetet arbëreshe në Itali, si Çivita apo Spezzano Albanese; monumente kulturore dhe kulti si teqe, kisha, xhami, ura të vjetra; fotografi të jetës social-kulturore në vend, kryesisht në Korçë dhe Vlorë, apo foto të veshjeve tradicionale shqiptare të krahinës së Shkodrës. Pjesë e tyre janë edhe faksimilet. Lumo Skendo ishte i vetëdijshëm për rëndësinë që ka historia dhe dokumentimi i saj. Jo pak herë në shkrimet e tij ai u drejtohet vazhdueshëm lexuesve të revistës dhe ngre shqetësimin për dokumentimin e historisë së kombit përmes dorëzimit dhe mbledhjes së dokumenteve të vjetra që lidhen me ngjarje të rëndësishme historike.

Në këtë vit të parë revista *Diturija* përngjason me një *enciklopedi* të vogël me informacion të pasur edhe mbi fenomenet natyrore, kuriozitete dhe dije mbi vende të ndryshme apo ngjarje historike, mbi shkencën, natyrën, botanikën, astronominë, këshilla, fjalë të urta etj. Ndërsa në vitet pasuese ajo nis të formësohet si një revistë me artikuj të fuqishëm e studime shkencore, të cilat pasqyrojnë edhe rritjen cilësore dhe pjekurinë e revistës. Pjesa kryesore e artikujve janë pa autor, por ai deduktohet nga shënimi në fund të Lëndës së

Volumit të Tretë të vitit 1928, sipas së cilit: "Artikujt pa nënëshkrim janë të drejtorit të revistësë". Për këtë arsye është zgjedhur kufizimi me kllapa katrore i emrit të autorit [Frashëri, Mid'hat], duke respektuar standardet e përshkrimit bibliografik dhe pasqyruar ndërhyrjen e bibliografit.

Lumo Skendo ishte pena kryesore e *Diturisë*, por me të bashkëpunuan edhe 57 personalitete të shquara, duke dhënë një kontributit të vyer në këtë revistë, si: Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Aleksandër Xhuvani, Hamdi Bushati, Karl Gurakuqi, Mehdi Frashëri, Eshref Frashëri, Kolë Kamsi, Mati Logoreci, Milo Duçi, Josif Haxhimima, Grigor Vavako, Mustafa Villa etj., apo albanologë e personalitete të shquara si Gustav Weigand, Theodor Ippen, Petar Skok, Fulvio Cordignano, Leon Rey, Luigi M. Ugolini etj. Rreth 31 regjistrime bibliografike, kryesisht poezi dhe të botuara përgjatë vitit të parë të revistës, mbajnë si nënshkrim pseudonime ose iniciale si: *Shqyptari* (pseud. i Ndre Mjedës), *Fushk n` Dushk* (Gjergj Fishta), *Lulo Malësori* (Milo Duçi), *Rras` e Bardhë* (Josif Haxhimima) apo *Sakoli* (Hilë Mosi). Vetë Mid'hat Frashëri, përveç pseudonimit të tij letrar *Lumo Skendo*, ka përdorur në disa shkrime pseudonimin *Teto Tule*.

Faqet e revistës përgjatë gjithë viteve të botimit të saj u bënë pasqyrë e problematikave të mprehta që po përjetonte kombi. Shkrimet shtrihen në fusha të ndryshme, që nga çështja kombëtare apo e kufijve të vendit te arsimi shqip dhe historiku i shkollës, besimi dhe folklori, etnogjeneza dhe prejardhja e gjuhës shqipe, misionet arkeologjike etj., duke përmbushur më së miri misionin e *Diturisë*.

Si një enciklopedi e vërtetë në faqet e revistës gjejmë rreth 475 figura të shquara të kulturës dhe historisë, jo vetëm shqiptare por edhe asaj botërore, të cilave u është kushtuar vëmendje përmes artikujve dhe shkrimeve, duke sjellë informacione mbi veprimtarinë e tyre historike, kulturore apo shoqërore, ose shënime e refleksione mbi veprat e tyre etj.

Kjo bibliografi rreket të pasqyrojë njëherazi edhe spektrin e gjerë të tematikave dhe çështjeve të trajtuara, përmes 335 "fjalëve kyçe", të cilat dëshmojnë se drejtuesi i kësaj reviste u "kujdes" të përfshinte në të informacione nga të gjitha fushat e dijes njerëzore. Gjejmë 181 qytete dhe shtete të përshkruara konkretisht ose pjesërisht në informacionet që japin artikujt. Pjesa më e madhe e tyre janë qytetet shqiptare, të lidhura me tematikën dhe çështjen kombëtare, por nuk mungojnë informacione shkencore e kulturore apo kuriozitete mbi ngjarje e vende të tjera, jo vetëm në Evropë por edhe më gjerë, si në Afrikë, Azi, Amerikë e Jugut, Groenlandë, Austri, Brazil, Rumani, Itali, Siberi etj.

Përgjatë gjithë botimit të saj, revista *Diturija* u karakterizua nga tematika e artikujve e organizuar në formë rubrikash, të cilat përfshijnë çështjet thelbësore të gramatikës dhe gjuhës shqipe, domosdoshmërinë e hartimit të një bibliografie shqipe, këshilla për lexime e njohje me botimet e reja, kuriozitete, veprimtarinë e gjerë të diasporës shqiptare apo njohjen me veprat që studiues dhe autorë të huaj kanë shkruar për Shqipërinë, kryesisht të udhëtarëve të huaj që kanë përshkuar vendin. Këta artikuj janë shoqëruar njëherazi edhe me refleksion apo vlerësime mbi to.

Këto shkrime janë organizuar në rubrikat : *Andej-Këtej*, *Bibliografi, Bibliografi Shqipëtare : shtim në radhoj i Bibliografi e Emile Legrand-it*, *Libra të marra*, *Pjesa shtëpiake*, *Tribunë gramatike dhe gjuhësije*, *Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në funt të shekëllit 19-të, Aktiviteti i shqiptarëve në Rumani dhe Shqiptarët në Greqi.*

Një vëmendje të madhe botuesi i kushton komunikimit me "Këndonjësit" e tij. Përmes shënimeve dhe njoftimeve të vazhdueshme që ai bënte në pjesën e brendshme të kopertinës së revistës, arrijmë sot të marrim një informacion të plotë mbi aktivitetin dhe jetën e revistës, problematikave me të cilat është përballur gjatë botimit apo shpërndarjes së revistës. Ky komunikimi i drejtpërdrejtë me lexuesin e tij, që reflekton qartazi vetëdijen e botuesit për rëndësinë e publikut, është i rrallë në historinë e shtypit shqiptar.

Gjatë hartimit të kësaj bibliografie, të gjitha këto komunikime, duke i konsideruar si të rëndësishme për studiuesit që mund të kenë interes për të njohur e shqyrtuar këtë aspekt të shtypit shqiptar dhe duke i vlerësuar si një 'rubrikë' të mëvetësishme, i kemi përfshirë në një zë të veçantë në Treguesin alfabetik të Rubrikave. Të gjithë zërat bibliografikë mbajnë numrin rendor në një rritje progresive. Artikujt janë të renditur kronologjikisht. Në të janë përfshirë si informacion edhe fotografitë apo njoftimet e ekspozitave dhe aktiviteteve kulturore të realizuara në librarinë "Lumo Skendo" me rastet e ngjarjeve të veçanta historike.

Bibliografia është e pajisur me Treguesin alfabetik të autorëve, tematik, të titujve, treguesin gjeografik, atë të fotografive si dhe të rubrikave të kësaj reviste. Në revistën *Diturija* të 1909-ës botuesi shkruan sipas variantit të "Alfabetit të Stambollit", për lehtësi përdorimi të bibliografisë, e kemi përshtatur me shkronjat e sotme. Shpresojmë që kjo bibliografi të jetë një ndihmesë e vlefshme për studiuesit dhe publikun në thellimin e njohjes së veprës së një prej personaliteteve më të vyera të kulturës shqiptare.

1909

Diturija : e përkohëshme shqip literare dhe diturake : del një herë në muaj / dreqtonjës Lumo Skendo. - Selanik : 1909. - Mot i parë.

1. Frashëri, Mid'hat. Istori e shkrimit shqip[1] / Lumo Skendo (pseud.). - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 1-6.
- Mbi historinë e alfabetit, tekstet e vjetra shqipe, Shoqërinë e Stambollit dhe Abetaren e Stambollit.
- Shën. në fund të f.
- Autori përmend kontributin e Johann Georg von Hahn, Leopold Geitler, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Kostandin Kistoforidhi, Theodor Anastas Kavalioti, Jeronim De Rada, Naum Veqilharxhi, Naim Frashëri.

2. Elbasani (Një cop` e pazarit) : [fotografi]. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 6.

3. Mjeda, Ndre. Andrë : [poezi] **/** Shqyptari (pseud.). - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 7.

4. Shkupi (Pazari që mbahet të martën perpara Hyqymetit) : [fotografi]. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 7.

5. Fishta, Gjergj. Tingllim : [poezi] / Fushk n` Dushk (pseud.). - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 8.

---

1. Autori në revistën "Diturija" të 1909-ës shkruan sipas variantit të "Alfabetit të Stambollit", të cilin ne e kemi përshtatur me shkronjat e sotme për lehtësi përdorimi të bibliografisë.

6. Këngë shqip (në të folë të Kalavrisë në Greqi). - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 9.
- Këngë e shqiptarëve të Moresë, nxjerrë prej "Notes Pelasgicae" të Reinhold-it, shtypur më 1855 n`Athinë, nga cop e tretë, faqe 16 (Shën. i bot.)

7. Tjatrë : [këngë popullore]. **-** Nr. 1, 1 janar 1909, f. 9.

8. Moti (këngë). - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 10.

9. Shkupi (Parë nga bregu i sëmurëtores): [fotografi]. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 10.

10. [Frashëri, Mid'hat][2]. Midhat Pasha : [biografi]. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 11-14.
- Portret.

11. Berati dhe lumi : [fotografi]. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 15.

12. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej-Këtej : [kuriozitete]. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 15.

13. [**Frashëri, Mid'hat].** Pjesa shtëpiake : njollatë. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 16.

14. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 1, 1 janar 1909, f. 16.
- Përmban: *Grammatik der albanesischen sprache* / D. Pekmezi. - Wien, 1908, volum 8, 429 f.
- Shënime mbi librin.

15. Frashëri, Mid'hat. Të vëmë re kur shkrojmë / Lumo Skendo. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 17-19.
- Bibliografi: Frashëri, Sami *"Shkronjëtore e gjuhësë shqip",* Bukuresht, 1888*;* Kristoforidhi, Kostandin *"Grammatiki tis alvanikis glossis",* Stamboll, 1882; Vasa, Pashko *"Grammaire Albanaise"* London, 1887*;* Meyer, Gustav *"Kurzgefasse albanesische Grammatik"* Leipzig, 1888; Pekmezi, Gjergj *"Grammatik der albanesischen Sprache : Laut-und Formenlehre",* Vjenë, 1908; De Rada, Giuseppe *"Grammatica della lingua albanese",* Firenze, 1871.

16. [**Frashëri, Mid'hat].** Fjalëtore e vogëlë. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 20-21.

2. Autori sipas shënimit të revistës "Diturija", në fund të Lëndës së Volumit të Tretë të vitit 1928, sipas së cilit: "Artikujt pa nënëshkrim janë të drejtorit të revistësë"

17. Grameno, Mihal. Maj : këngë / M. G. - Nr. 2, shkurt 1909, f. 21.

18. Saranda : [fotografi]. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 21.

19. **Frashëri, Mid'hat.** Pse bje tërmeti / L. S. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 22-23.

20. Shkupi dhe Vardari : [fotografi]. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 24.

21. [**Fishta, Gjergj].** Jaho begu e Palok Cuca : satir. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 24-26.
- Marrë nga "Anzat e Parnasit".
- Pajisur me shënime në fund të f.

22. Teqe e Bektashinjet në Kalkandelen : [fotografi]. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 26.

23. [**Frashëri, Mid'hat].** Ç`të hamë, ç`të pimë dhe qysh të flemë. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 27-29.

24. Tirana dhe pazari : [fotografi]. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 29.

25. Një rugë në Sarandë : [fotografi]. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 30

26. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej këtej : [kuriozitete]. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 30-31.

27. [**Frashëri, Mid'hat].** Pjesa shtëpiake : për të ruajturë vetë taze; për të gjeturë sa lesh, mëndafsh dhe pambuk ka një pëlhurë; për të shtënë nyejthët e këmbësë; monedh` e mirë dhe monedha kallp; për të larë vajet. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 31-32.

28. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 2, 1 shkurt 1909, f. 32.

- Përmban: *Reliquie e vestige dell` antico ceppo glottico Albanese* / Michele Marchiano. - Napoli, 1908*; Un autografo inedito di Girolamo De Rada* / Michele Marchiano. - Trani, 1909.

- Shënime mbi botimet.

29. **Frashëri, Mid'hat.** Shqipëtarët : gjer më tani dhe paskëtaj / Lumo Skendo. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 33-36.

30. [**Frashëri, Mid'hat].** Fjalëtore e vogëlë. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 36-37.

31. **Shirqi, Zef.** Tingëllim (G.P.F.) / Z. Sh. (inic.). - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 38.

32. **Tom.** Trimi shqipëtar (Pa bërë Konstitucioni) : [poezi] / Tom. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 39.

33. **F.** Qetësi e zemrës : [poezi] / F. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 39

34. [Vendim i Komisionit mbi çestjen e abecese, Manastir, 7-20 vjeste e trete 1908] : [faksimile]. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 40.
- Në faksimile mungojnë disa nënshkrime (Shën. i bot.)

35. Kongres` i Manastirit : [fotografi]. - Nr. 3, 1 mars 1909, fl. 1 pas f. 40.

36. Komision` i alfabetit : [fotografi]. - Nr. 3, 1 mars 1909, fl. 2 pas f. 40.

37. [**Frashëri, Mid'hat].** Kongres` i Manastirit. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 41.
- Aut. përmend emrat e delegatëve të Kongresit të Manastirit dhe të Komisionit të Alfabetit, ndër të cilët: *Mithat Frashëri* (kryetar), *Gjergj Fishta* (delegat i Shoqërisë "Bashkimi"), *emzot Kaçorri* (delegat i Durrësit), *Ndre Mjeda* (delegat i shoqërisë "Agimi"), *Luigj Gurakuqi* (delegat i Shkodrës), *Gjergj Qiriazi* (delegat i Manastirit), etj.[3]

38. **Frashëri, Mid'hat.** Qielli dhe yjtë / L.S. (pseud.). - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 42-44.

39. **Keller, Helen.** E shurdhër dh`e verbërë / Helen Keller. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 44-46.
- Marrë nga "The story of my life", Helen Keller, 1904.

40. [**Frashëri, Mid'hat].** Udhëtim i shpesëvet : lejleku dhë dellëndysheja. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 46.

3. Të gjithë emrat e delegatëve janë të pasqyruar në Treguesin e personave të bibliografisë.

41. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej Këtej : [kuriozitete]. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 46-47.

42. [**Frashëri, Mid'hat].** Pjesa shtëpiake : për të mos sheqerosur t`ëmbëlat; kundrë të djegurit; për të ruajtur vajët; kundrë të ngërhiturit. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 47-48.

43. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 3, 1 mars 1909, f. 48.
- Përmban: *Hidhërimet e zëmërës* / N. S. Delvina. - Selanik, 1909*; Valët e detit* / Spiro K. Dine. - Sofje, 1908.
- Shënime mbi botimet.

44. [**Frashëri, Mid'hat].** A do të kemi një të vetëm gjuhë literare shqip?. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 49-51.
- Mbi dialektet e shqipes, gegërishten, toskërishten dhe dialektin e Elbasanit dhe nevojën e unifikimit të gjuhës.

45. **Frashëri, Mid'hat.** Të vëmë re kur shkrojmë / Lumo Skendo. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 52-53.
- Mbi drejtshkrimin, drejtshqiptimin dhe kuptimin e fjalëve.

46. Shkodra dhe një cop` e Liqenit : [fotografi]. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 53.

47. [**Frashëri, Mid'hat].** Fjalëtore e vogolë. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 54.

48. **Frashëri, Mid'hat.** Fjalëtoretë shqip. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 55-56.
- Përmban: *Fjaluer i ri i shqypes* (Shoq. "Bashkimi"); *Fjaluer i vogel shqyp e latinist* (Jak Junku); *Leksikon tis alvanikis glossi* (*Fjalëtore e guhësë shqip*), Konstandin Hristoforidhi, Athinë, 1904; *Vocabolario Italiano-Epirotico dhe Epirotiko-Italiano* (Francesco Rossi); *Etymologischer wörtebuch der albanesischen sprache* (Gustav Meyer, 1891); *Albanesisch-deutschen lexicon* (*cop e tret` e librësë "Albanesische Studien"*, J. G. Hahn, 1854); *Vocabolaire albanais français* (cop e tret` e librësë "Manuel de la langue ckhipe ou albanaise", Auguste Dozon, 1879); *Dictionarium latino-epiroticum (fjalëtore latinish-shqip)*, Romë, 1635; *Fjalorth frëngisht-shqyp i fjalëve t`reja* (L. Gruda, Napoli 1906?)
- Shënime mbi fjalorët.

49. **Mosi, Hilë.** Djali e vjollca : [poezi] / Sakoli (pseud.). - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 57.

50. **Dine, Spiro.** Si mjer` ai që dërgon të birë të mësonjë ndë Athinë : [poezi] / Spiro Dine. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 58.
- Nga libra "Valët e detit".

51. **Frashëri, Mid'hat.** Dielli / L.S. (pseud.). - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 59-61.

52. [**Frashëri, Mid'hat].** Ata që hanë dhê. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 61.

53. [**Frashëri, Mid'hat].** Pol`i Jugësë. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 61-62.

54. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej Këtej : ujë t`ëmbël në det; ujët dhe vera. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 63.

55. [**Frashëri, Mid'hat].** Pjesa shtëpiake : për të pastruarë karafat dhe butilet; pomadë kundrë të plasurit e buzëvet; Kundrë muskonjavet. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 63.

56. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 4, 1 prill 1909, f. 64.
- Përmban: *Kalendari Kombiar, 1909; L`Albania dei due vilajet Adriatici* / Gaspare Gugga. - Venetik,1909*; Familia e martirve : tragjedi me pes hova* / Sh`Eustaki; shqip prej Kol Thacit. - Shkodre, 1909.

57. **Frashëri, Mid'hat.** Na duhenë libra / Lumo Skendo. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 65-66.

58. Gjirokastra : [fotografi]. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 66.

59. [**Frashëri, Mid'hat].** Mëmëdheu i ca bimëve : duhani; misër; kafe; çaj; qershi / Lumo Skendo (pseud.). - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 67-68.

60. **Shiroka, Filip.** Tingëllim (V.Ç.) : [poezi] / F. Sh. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 68.

61. **Paftali, C.** Në breg t`liqenit t`qet; Koha dhe ndryshimi : [poezi] / C. Paftali. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 69-70.

62. Kangë popullore. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 70.

63. **Heredia, José-Maria de.** Bujku : vjersha të huaja / Jose-Maria de Heredia. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 70.
- Marrë nga "Les Trophées".

64. [**Frashëri, Mid'hat].** Vëllezërit e dheut. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 71-73.
- Me ilustrim.

65. [**Frashëri, Mid'hat].** Baruti dhë armëtë. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 74-75.

66. [**Frashëri, Mid'hat].** Fjalëtore e vogëlë. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 76.

67. Mirditasit në kishë : [fotografi]. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 76.

68. [**Frashëri, Mid'hat].** Shkurtabiqët dhe gjatamanët. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 77-78.
- Foto ilustruese.

69. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej-Këtej : [kuriozitete]. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 79.

70. [**Frashëri, Mid'hat].** Pjesa shtëpiake : për të farosurë minjtë; morat e pulavet; kundër milingonjavet. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 80.

71. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 5, 1 maj 1909, f. 80.
- Përmban: *Canti popolari albanesi* / Michele Marchiano. – Foggia, 1908.
- Shënim edhe mbi botimin e të njëjtit autor "*La Rondinella, poesie sacre albanesi*".

72. **[Frashëri, Mid'hat].** Letrë s`ime mbese / Teto Tule (pseud.). - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 81-82.

73. [**Frashëri, Mid'hat].** Shqipëtarët` e Italisë. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 83-85.

74. Spezzano Albanese : [fotografi]. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 84.

75. Çivita : [fotografi]. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 85.

76. Kënga e Pal Golemit : këngë të shqipëtarëvet t`Italisë. Nër shqipëtarët e jashtme. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 85-86.
- Nga libra "*Canti popolari albanesi"* e Michele Marchianó.
- Shënime në fund të f.

77. Tjatrë këngë : Nër shqipëtarët e jashtme. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 86.
- Nga libra *"Canti popolari albanesi"* e Michele Marchianó.
- Pajisur me shënime në fund të f.

78. [**Frashëri, Mid'hat].** Eklipsetë. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 87.

79. [**Frashëri, Mid'hat].** Si është bërë bota. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 88-91.

80. [**Frashëri, Mid'hat].** Nga istori e kafshëvet; karavidha dhe hardhjeshka; krimbat e dheut; lopët e milingonjavet. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 91-92.

81. [**Frashëri, Mid'hat].** Vetëtima; gjëmimi, rrufeja. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 92-95.

82. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej Këtej. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 95-96.

83. [**Frashëri, Mid'hat].** Pjesa shtëpiake : qelqe dhe qelibar; diamant dhe qelqe; për të ruajturë mishin. - Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 96.

84. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi.- Nr. 6, 1 qershor 1909, f. 96.
- Përmban: *Kalendari Kombiar*, 1909.
- Shënime mbi botimin.

85. **Frashëri, Eshref.** Udhët, pyjet, lumenjt` e Shqipëris` së Sipërme / Eshref Frashëri (dhematës). - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 97-99.

86. Ur` e Tepelenës : [fotografi]. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 99.

87. [**Frashëri, Mid'hat].** Të vëmë re kur shkrojmë : shuanjëza dhe pjekjeza. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 100-101.

88. Paramithija : [fotografi]. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 101.

89. **[Frashëri, Mid'hat].** Letrë s`ime mbese : [Kaçe-s] / Teto Tule (pseud.). - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 102-103.

90. **Mosi, Hilë.** Së largtes (Mbas Goethe-s) ; Largim i mallshëm : [poezi] / Sakoli (pseud.). - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 104.

91. Madhëri e tij Sulltan Mehmed i Pestë : [fotografi]. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 105.

92. **Shirqi, Zef.** Nâna e atdheu : [poezi] / Z. Sh. (inic.). - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 106.

93. **Heredia, José-Maria de.** Lutj`e e të vdekurit : vjersha të huaja / Jose-Maria Heredia. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 106.
- Marrë nga 'Les Trophées ".

94. **Shirqi, Zef.** Tingëllim : Shqypes Sh. : [poezi] / Z. Sh. (inic.). - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 107.

95. **Duçi, Milo.** Hap gjinë nënë : [poezi] / Lulo Malësori (pseud.). - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 108.

96. **Paftali, C.** Ndër vorre : [poezi] / C. Paftali. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 108-109.

97. **Haxhimima, Josif.** Tingëllim (Kushtumun z. Sh. L.) : [poezi] / Rras` e Bardhë (pseud.). - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 109.

98. [**Frashëri, Mid'hat].** Muaji korrik dhe istorija. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 110-111.

99. [**Frashëri, Mid'hat].** Dituri e lumtërisë. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 111.

100. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej këtej : [histori botërore]. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 111-112.

101. [**Frashëri, Mid'hat].** Pjesa shtëpiake : vaj për armët; të pastruarët e stolivet. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 112.

102. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 7, 1 korrik 1909, f. 112.
- Përmban: *Dashurija e mëmëdheut* / Namik S. Delvina. – Selanik, 1909.

103. [**Frashëri, Mid'hat].** Nevojat e Shqipërisë për bujqësi. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 113.

104. **Haxhimima, Josif.** Banj` e Elbasanit / Rras` e Bardhë (pseud.). - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 115-116.

105. Djemt` e Shpatit kur mbajtnë provimet shqip simvjet n`Elbasan : [fotografi]. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 116.

106. **[Frashëri, Mid'hat].** Letrë s`ime mbese " [Kaçe-s] / Teto Tule (pseud.). - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 117-118.

107. Dodona : [fotografi]. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 119.

108. [**Frashëri, Mid'hat].** Dodona. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 119-120.
- Carapanos: *Dodone et ses ruines, avec des etudes de M. M. Foucart, Egger, de Witte, Heuzey*, Paris, 1878 (shënim në fund të f.)

109. Orkestër shqip në Vlorë : [fotografi]. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 121.

110. **Kolenda, Ernest.** Të dashunës : [poezi] / E. Kolendha. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 122.

111. **Duçi, Milo.** Dhe mjafton : [poezi] / Lulo Malësori (pseud.). - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 123.

112. **Sh. F.** Kângë popullore / Sh. F. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 124.

113. [**Frashëri, Mid'hat].** Drita dhe gjyrratë. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 125-126.

114. [**Frashëri, Mid'hat].** Nga istori e kafshëvet : qumësht zogu; qyqeja; mjaltë q`e prish njerinë. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 126-127.

115. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej Këtej : harakiri; të përtypsurit. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 127-128.

116. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 8, 1 gusht 1909, f. 128.
- Përmban: *Libr` e shërbesavet të shenjta të kishes orthodhokse* / kdhyerë nga gerqishtja F. S. Noli. - Boston Mass, 1909; *Turcia pe Marginen Prapastiei de H. M. : në guhë rumanisht.* - Bukuresht, 1909*; Oxaku : roman dramatik* / Mihal Grameno. – Selanik, 1909.

117. [**Frashëri, Mid'hat].** Duhet të punojmë. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 129-131.
- Mbi zhvillimin e bujqësisë dhe mjeshtërive të ndryshme.

118. [**Frashëri, Mid'hat].** Letrë s`ime mbese : [Kaçe-s] / Teto Tule (pseud.). - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 132-133.

119. Trup i "Bandës së Lirisë" në Korçë : [fotografi]. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 133.

120. [**Frashëri, Mid'hat].** Pse është më ngrohtë kur bje shi?. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 134.

121. **Paftali, C.** Nji teqe e harrume : [poezi] / C. Paftali. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 134-137.

122. Një rrugë në Korçë dhe ëmbëltoreja "Manushaqe" : [fotografi]. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 137.

123. **Haxhimima, Josif.** E vërteta! : [poezi] / Rras` e Bardhe (pseud.). - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 138.

124. **Duçi, Milo.** Do t`e mbesonje (se dashurës time së vluar); Mos pyet : [poezi] / Lulo Malësori (pseud.). - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 139.

125. **Përmeti, Mahmut.** Endër` e tmeruar : [poezi] / Mahmut Përmeti. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 140.

126. **Lukaj, L.** Dishiri s`maron; Bleta e pllumbi (E marun prej germanve); Dora e Zotit : [poezi] / L. Lukaj. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 140-141.

127. [**Frashëri, Mid'hat].** Nat`e kthjelltë pse ësht` ftohtë?. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 141-142.

128. [**Frashëri, Mid'hat].** Avulli, ujët akulli. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 142-143.

129. [**Frashëri, Mid'hat].** Andej këtej : të puthurët; ëndërat : [kuriozitete]. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, f. 143-144.

130. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 9 dhe 10, Vjesht` e I dhe II, 1909, 144.
- Përmban: *Var` i pagëzimit, roman dramatik* / Mihal Grameno. - Korçë, 1909*; E puthura, roman dramatik* / Mihal Grameno. - Korçë, 1909*; Këngatë shqipe* / përmbledhurë prej Sakol (Hilë Mosi). - Korçë, 1909.

131. [**Frashëri, Mid'hat].** Të mësojmë gjuhënë. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 145-146.

132. [**Frashëri, Mid'hat].** Të dimë të sillemi. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 147-149.

133. Shkodrankë dhe mveshj` e vëndit : [fotografi]. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 149.

134. Fjalë të urta. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 150.
- Përmban thënie të: Pascal, Delille, La Bruyere, La Rochefoucauld, Florian, Boileau, Danton, Legouve, P. Corneille, La Fontaine.

135. **Haxhimima, Josif.** Atje tej : [poezi] / Rras` e Bardhë (pseud.). - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 151.

136. **Duçi, Milo.** Buk` e mallëkuar : [poezi] / Lulo Malësori (pseud.). - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f.152.

137. Shkodran dhe mveshj` e tij : [fotografi]. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 153.

138. **Përmeti, Mahmut.** Lija në Izmir : [poezi] / Mahmut Përmeti. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 154.

139. **Duçi, Milo.** Trëndafili dhe vâri : pas Victor Hugo : [poezi] / Lulo Malësori (pseud.). - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f.154.

140. [**Frashëri, Mid'hat].** Ç`janë yjtë me bisht dhe yjtë që këputenë. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 155-157.

141. [**Frashëri, Mid'hat].** Karta. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 158-159.

142. Leskoviku dhe Mali Melesin : [fotografi]. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 159.

143. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 11 dhe 12, Vjesht` e III dhe Shënëndre, 1909, f. 160.
- Përmban: *Mëmëdheu* / Namik Qemali (autor turk), përkth. Sabri Qyteza. - Selanik, 1909; *Aus den Nordalbanischen Hochgebirge (në Malësi të Shqipëris` së Veriut)* / Erich Liebert. - Sarajevo*; Lulet e verësë* / Naim be Frashëri. - Selanik, 1909; *Gazetë Shqip (Bashkim i Kombit, Manastir); Альанско възраждаинје (Përlindje shqipëtare,* Sofia, 1909*).* - *Mevlud* / Hafiz Ali, hatib i Korçësë. - Korçë, 1909; *Istorishronj` e Plikatit* / Papa Kristo Negovani. - Selanik, 1909; *Pika voeset* / P. Gjerg Fishta. - Zader, 1909.
- Shënime mbi botimet.

1916

Diturija : del ne krye te çdo muaji / director Lumo Skendo. - Bukuresht, 1916

144. **Frashëri, Mid'hat.** Shpresa dhe puna / Lumo Skendo. - Nr. 1, Vol. II, qershor, 1916, f. 1-3.

145. [**Frashëri, Mid'hat].** Mê të vjetrët shkrime shqip. - Nr. 1, Vol. II, qershor, 1916, f. 4-6.
- Mbi tekstet e vjetra shqipe të Gjon Buzukut, Frang Bardhit, Lukë Matrëngës, Pal Skiroit, Dhimitër Beratit, Pal Engjëllit si dhe disa fjalë nga fjalori i Arnold von Harfit.

146. [**Frashëri, Mid'hat].** Dora D`Istria : [biografi]. - Nr. 1, Vol. II, qershor, 1916, f. 6-9.
- Jeta dhe vepra e Dora D`Istrias.
- Përmenden veprat: *La Suisse allemande;La vie monastique dans l`eglise orientale; Les femmes en Orient.*
- Mbi librin *"Gli albanesi in Rumenia (1873)"* të Bartolomeo Cecchettit, ku jepet një bibliografi e Dora D`Istrias në parathënien e librit.
- Citohen artikuj të Dora D`Istrias në shtypin e huaj.

147. [**Frashëri, Mid'hat].** Shqipëtarët në Greqi. - Nr. 1, Vol. II, qershor, 1916, f. 10-12.
- Mbi emigrimin e hershëm të shqiptarëve dhe dokumentet.
- Autori përmend *Jacob Philipp Fallmerayerin* me librin e tij "Geschichte der Halbinsel, Morca wahrend des mittelalter", *Johann Georg von Hahni-n* me "Albanesische Studien", kërkimet e *George Finlay-t* në "Histori e Greqisë", historianin grek *Konstantinos N. Sathas.*

148. [**Frashëri, Mid'hat].** Aktiviteti i shqipëtarëvet në Rumani. - Nr. 1, Vol. II, qershor, 1916, f. 13-14.
- Mbi themelimin e Shoqërisë "Drita" (1884) si dhe të revistës "Drita-Dituria" (1884).

149. [**Frashëri, Mid'hat].** Gjendja në Shqipëri. - Nr. 1, Vol. II, qershor, 1916, f. 15-16.

150. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 1, Vol. II, qershor, 1916, f. 16.
- Përmban: *"Illyria", e përkohëshme,* botonjës Kostë Çekrezi (Nr. 1-3, Boston Mass.)
- Shënime mbi botimin.

151. **Frashëri, Mid'hat.** Miqtë dhe armiqt` e Shqipërisë / L. S. (pseud.). - Nr. 2, Vol. II, korrik, 1916, f. 17-20.

152. [**Frashëri, Mid'hat].** Për shkrime të haruarë dhe të paditurë. - Nr. 2, Vol. II, korrik, 1916, f. 20-23.
- Mbi domosdoshmërinë e hartimit të një bibliografie shqipe.
- Mbi bibliografinë e Emile Legrand (Paris 1912,); Gustav Meyer-i "Fjalori etimologjik i shqipes" (Strassburg, 1881) dhe veprën e Frang Bardhit e Pjetër Bogdanit.
- Përmenden emrat e atyre që kanë pasur dorëshkrime shqip si *Lef Nosi* (katekizmë e fundshekullit të 18-të); *Dot Biba* (defter tregëtije); *Tushi Pina* (dorëshkrime e përkthime); *Sulo Resuli* (vjersha të beratasit *Sylejman Ramazan*); Sipas *Gjergj Fishtës* gjenden në duar të disa priftërinjve disa dorëshkrime dhe vjersha të priftit të Mirditës *Zarish-it*; Dorëshkrime të *Hasan Zyko Kamberit*, libra fetarë të *Shahin bej dhe Dalip bej në Frashër*; Fjalori i *Marko Boçarit*, vendosur në Paris prej *Pouqueville* më 1819; Sipas *Jani Vretos*, *Stefan Postenani* ka lënë një shkronjëtore të gjuhës greqishte në shqip; *Panajot Meksi* nga Labova ka mbledhur këngë e vajtime.

153. [**Frashëri, Mid'hat].** Shqipëtarët në Greqi II. - Nr. 2, Vol. II, korrik, 1916, f. 24-27.
- Duke u bazuar në dokumente dhe studime të *Laonic Chalcocondil*, *Konstantinos N. Sathas*, *J. W. Zinkeissen* etj., autori shkruan mbi: Ngjashmëritë të dialektit të Cakonisë me shqipen; Cilësi të ngjashme të shqiptarëve dhe të maniotëve (Manjë); Mbi origjinën e Rali-t të Peloponezit.

154. [**Frashëri, Mid'hat].** Peshkupija dhe Kollegi i Shqipëtarëvet në Kalabri. - Nr. 2, Vol. II, korrik, 1916, f. 27-29.
- Titulli i një artikulli të Luigji Alberti, në No. 63-64, mot VI, mars-prill, 1916 të "Roma e l`oriente", f. 122-123, mbi Ipeshkvi të ritit orthodhoks të quajtur italo-greco, në Kalabri. - Mbi kolegjet teologjike dhe ruajtjen e ortodoksisë së shqiptarëve në Itali.

155. [**Frashëri, Mid'hat].** Aktivitet i Shqipëtarëvet në Rumani II (pasonjë nga numuri që shkoi, faqe 13). - Nr. 2, Vol. II, korrik, 1916, f. 29-32.
- Mbi Shoqërinë Drita- Dituria, aktivitetet dhe botimet e tyre. - Mbi botimin e teksteve (këndime, shkronjëtore) për shkollën shqipe në Korçë dhe shkollat në fshatrat e Kolonjës dhe të botimit të librave: *"Skënderbeu", "Qerbeleja"*, *"Metoda"*.

156. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 2, Vol. II, korrik, 1916, f. 32.
- Përmban: *L`Albania e gli albanesi* / Pashko Vasa, trad. Milo Shini, avv. T. Tocci. - Corigliano, Calabro, 1916*; La Population de l`Epire* / Lumo Skendo. – Sofje, 1915; *Pritmi i Shqipërisë* / Lumo Skendo. - Sofje, 1915.
- Shënime mbi botimet.

157. [**Frashëri, Mid'hat].** Kufit e Shqiptarëvet. - Nr. 3, Vol. II, gusht, 1916, f. 33-36.

158. [**Frashëri, Mid'hat].** Fundoretë në emrat shqipe. - Nr. 3, Vol. II, gusht, 1916, f.36-40.
- Fjalorth me fundoret (prapashtesat) e emrave.

159. [**Frashëri, Mid'hat].** Shqipëtarët në Greqi III (Pasonjë nga numuri që shkoj, f. 10 dhe 24). - Nr. 3, Vol. II, gusht, 1916, f. 40-41.
- Mbi udhëtarët e huaj si Simeon Simeons (cituar nga historian grek, Sathas), William Martin Leake si dhe studimet të Johann Georg von Hahn-it, Jacob Philipp Fallmerayer-it, George Finlay-t, që vërtetojnë hershmërinë e emigrimit të shqiptarëve në Greqi.

160. [**Frashëri, Mid'hat].** Aktivitet i Shqipëtarëvet në Rumani III (Pasonjë nga numuri që shkoj, f. 13 dhe 29). - Nr. 3, Vol. II, gusht, 1916, f. 42-44.
- Mbi themelimin e Shoqërisë "Bashkimi", 7 dhjetor 1906.

161. [**Frashëri, Mid'hat].** Letrë s`ime mbese (E dashurë Kaçe) / Teto Tule. - Nr. 3, Vol. II, gusht, 1916, f. 44-46.

162. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi : Gjykime dhe kritikë. - Nr. 3, Vol. II, gusht, 1916, f. 47-48.
- Përmban: "*Fe-rrfejsi (ilmi=-hal*) / Hoxha Said, effendi Shkupjanit. - Sofje, 1916; *Kalendari "Populli Nacionalist*" / Thoma Theodos Katundi. - Amerikë, 1916.

1926

Diturija : e përkohëshme shqipëtare : del një herë në muaj / drejtonjës Lumo Skendo. - Volum i dytë, Numur 1, 1 Nantor 1926.

163. [**Frashëri, Mid'hat].** Për shkrime të haruarë dhe të pa-diturë. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 1-6.
- Mbi domosdoshmërinë e hartimit të një bibliografie shqipe.
- Mbi gjurmët e gjuhës shqipe dhe librave shqip dhe nevojën për një bibliografi shqiptare.
- Shën. në fund të f. mbi dorëshkrimet shqipe.
- Mbi bibliografinë e Emile Legrand (Paris, 1912); Gustav Meyer-i "Fjalori etimologjik i shqipes" (Strassburg, 1881) dhe veprën e Frang Bardhit e Pjetër Bogdanit.
- Përmenden emrat e atyre që kanë pasur dorëshkrime shqip si *Lef Nosi* (katekizmë e fundshekullit të 18-të); *Dot Biba* (defter tregëtije); *Tushi Pina* (dorëshkrime e përkthime); *Sulo Resuli* (vjersha të beratasit *Sylejman Ramazan*); Sipas *Gjergj Fishtës* gjenden në duar të disa priftërinjve disa dorëshkrime dhe vjersha të priftit të Mirditës *Zarish-it*; Dorëshkrime të *Hasan Zyko Kamberit*, libra fetarë të *Shahin bej dhe Dalip bej në Frashër*; Dy dorëshkrime dhe Fjalor shqip tyrqisht i *Hafëz Ali Ylqyni*; Sipas *Jani Vretos*, *Stefan Postenani* ka lënë një shkronjëtore të gjuhës greqishte në shqip; *Panajot Meksi* nga Labova ka mbledhur këngë e vajtime.

164. [**Frashëri, Mid'hat].** Shqipëtarët në Greqi. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 6-14.
- Mbi emigrimin e hershëm të shqiptarëve dhe dokumentet.
- Autori përmend *Jacob Philipp Fallmerayerin* me librin e tij "Geschichte der

Halbinsel, Morca wahrend des mittelalter", *Johann Georg von Hahni-n* me "Albanesische Studien", kërkimet e *George Finlay-t* në "Histori e Greqisë", historianin grek *Konstantinos N. Sathas*.
- Duke u bazuar në dokumente dhe studime të *Laonic Chalcocondil* dhe *J. W. Zinkeissen* etj. autori flet mbi ngjashmëritë të dialektit të Cakonisë me shqipen; cilësitë e ngjashme të shqiptarëve dhe të maniotëve.

165. [**Frashëri, Mid'hat].** Dora d`Istria. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 15-19.
- Jeta dhe vepra e Dora D`Istrias.
- Përmenden veprat: *La Suisse allemande; La vie monastique dans l`eglise orientale; Les femmes en Orient.*
- Mbi librin "*Gli albanesi in Rumenia (1873)"* të Bartolomeo Cecchettit, ku jepet një bibliografi e Dora D`Istrias në parathënien e librit.
- Citohen artikuj të Dora D`Istrias në shtypin e huaj.

166. [**Frashëri, Mid'hat].** Një pike historije : Ali pashë Janina dhe Zonja Frosini. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 19-22.
- Aut. bazohet në kujtimet e François Pouqueville, Ibrahim Manzour, librin e Guillaume de Vaudoncourt "*Memoirs on the Ioninan Islands including the life and character Of Ali Pasha" (London 1816),* gojëdhëna të bashkëkohësve të Ali Pashës, bibliografinë e Emile Legrand-it.

167. [**Frashëri, Mid'hat].** Aktiviteti i Shqipëtarëvet në Rumani : Shoqëri e shqipëtarëvet. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 22-29.
- Mbi Shoqërinë Drita-Dituria, aktivitetet dhe botimet e tyre. - Mbi botimin e teksteve (këndime, shkronjëtore) për shkollën shqipe në Korçë dhe shkollat në fshatrat e Kolonjës, librave: (Skënderbeu, Qerbeleja, Metoda (Ahn))
- Mbi shoqërinë "Bashkimi".

168. **Rey, Leon.** Rëmihjet e misionit arkeologjik francës në Apolloni / Leon Rey. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 30-33.
- Shënim nga redaksia e revistës "Diturija" mbi punën e Leon Rey-t dhe kujdesin që duhet të tregojnë shqiptarët për trashëgiminë kulturore.

169. [**Frashëri, Mid'hat].** Shtëpija dhe qetësi e saj. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 33-34.

170. [**Frashëri, Mid'hat].** Kuriozitete filologjije. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 35.

171. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi Shqipëtare : shtim në Bibliografi e Emile Legrand-it.- Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 35-37.
- Veprat e përmendura në këtë bibliografi janë të bibliotekës "Lumo Skendo" (Shën. i aut.)

172. [**Frashëri, Mid'hat].** Bibliografi. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 37-39.
- Përmban: *Albania, për motin 1925*. - Romë, Milano, Paris; *Kalendari Kombiar, 1926*; *Fjalori i Marko Boçarit*. - Tiranë, 1926; *Sërbët dhe Shqiptarët* / Milan Suflay, përkth. Zef Fekeçi, Karl Gurakuqi. - Tiranë, 1926.
- Shënime mbi botimet.

173. [**Frashëri, Mid'hat].** Këndonjësvet. - Nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 40.
- Mbi revistën "Diturija", botimin e parë të saj, vijimësinë dhe përmbajtjen.
- Autori sqaron mbi përsëritjen e artikujve "Për shkrime të haruarë dhe të paditurë", "Shqipëtarët në Greqi", "Dora D`Istria", "Aktiviteti i Shqipëtarëvet në Rumani", për faktin që kishin mbetur pa mbaruar si artikuj.

